

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7780 E premte 1 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Një kryeministër i shpërfytyruar në vulgaritetin më genuin, nën efektin e lexueshëm të substancave të paligjshme, u shfaq dje në Kuvend. "T'hyftë vedi ...
Vijon në faqen 20

Nga BARDH SPAHIA

Grahamat e një kryeministri



Opinion i Ditës

Pas 20 vjet emigrimi, diç kam mësuar për dhimbjet e shpirtit nga vetmia dhe çrrënjosja. Shqiptarët ëndërojnë Amerikën, pa ditur çmimin ...
Vijon në faqen 21

Nga ANETA MIHALI XHIKU

Dhimbjet e shpirtit pas 20 vitesh emigrimi në SHBA



Përgjimet/ Alibeaj: Vangjushi në burg
'Çudit' Dako: 'Zëri i Amerikës' degradoi. Rama: 'Kazan'. PD: Keni vjedhur vota

Reagon Vangjush Dako: Lidhja me Avdylajt e Shijakut? Takoj shumë njerëz në fushatë

Kryetari i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako ka konfirmuar përmbajtjen e përgjimeve të publikuara nga VOA sa i përket drekës me Avdylajt, por ka deklaruar se ka qenë i ftuar dhe se në tryezë ishin mbi 10 persona. Duke folur në emisionin "Open", Gjushi tha se ai në punën e përditshme ulet në dreka dhe kafe me çdo person dhe se nuk ...
Në faqen 3

TOKAT E ZENA NGA NDERTIMET PA LEJE, 8 DOKUMENTE DOREZOHEN NE ATP EMRAT, 270 PRONARET QE PERFITOJNE KOMPENSIMIN

Familjet që marrin paratë në Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Vlorë. Pronarët duhet të plotësojnë formularin dhe të dorëzojnë dëshminë e trashëgimisë



(Në foto) Ndërtime pa leje

HAPAT NE VAZHDIM

Lotaria Amerikane, hapat si mund të shihni nëse jeni ose jo fitues

Në faqen 10

INTERVISTA NE NEWS 24

Thaçi: Nuk e japim veriun e Mitrovicës dhe Trepçën

Në faqen 14

KRIMI NE FIER

E masakroi shoku me çekiç, i vëllai: Kemi dyshime të tjera, të bëhet ADN

Në faqen 11

REGJISORI I NJOHUR

Kujtimet e Leka Bungos: Luftova dhëmb për dhëmb me armiqtë e vendit

Në faqen 18

KRYEMINISTRI: TI NUK KALON DOT ATLANTIKUN



Rrëfimi, Rama: Ja ç'foli me Boltonin në SHBA. Sherri i plotë me Berishën

Në faqen 2

Kryetari i Pajtitimit të Gjaqeve: S'bëjmë dot gjë, nuk identifikohen autorët

Gjin Marku: Familja Bilali kërkoj ndihmë te ne

Ish-efektivi i policisë u qëllua me silenciator. E ndiqnin prej ditësh

NGA REZARTA DELISULA

Në janarin e vitit 2019 janë kryer 7 vrasje për shkak të gjakmarrjes. Kreu i Komitetit Shqiptar të Pajtitimit, Gjin Marku, rrëfen për "Gazeta Shqiptare", nisur nga vrasja e ish-policit mesditën e së mërkurës në Selitë,



që familja e tij kishte shprehur këtë shqetësim, ndërsa autorët e vrasjeve të vëllezërve të Arben Bilalit nuk u identifikuan nga policia. Sipas tij, zonat më tipike me mbartje familjesh në gjakmarrje janë Kombinati, Yzberishti, Selita dhe Kanza. Z.Marku, ju jeni ...

Në faqet 6-7

**KUVENDI
DEBATET**

Kryeministri aludoi se ish-kreut të PD-së i është refuzuar viza për të hyrë në SHBA

Rama: Familjes time i ha ato ... Berisha: Ke marrë gruan e shokut

"Nuk udhëtoj për qëllime zyrtare askurrkund"

Mazhoranca dhe opozita nuk ia kanë kursyer dje fjalorin e rëndë njëra-tjetrës në Kuvendin e Shqipërisë. E gjithë seanca është shoqëruar me tensione, ku nuk ka munguar nga fjalori banal deri tek akuzat e rënda, duke përfshirë edhe familjarët. Zanafillë e këtij debati të ashpër ishte pikërisht investigimi i publikuar nga "Zëri i Amerikës", ku denoncohej mekanizimi i blerjes së votës nga kryebashkiaku i Durresit Vangjush Dako. Nga foltorja e Kuvendit, kryeministri Edi Rama i është përgjigjur akuzave të opozitës dhe investigimit të VOA duke theksuar edhe një herë se Zëri i Amerikës është shndërruar në zëdhënës të "kazanit" të Tiranës. Kreu i qeverisë deklaroi se komunikimin zyrtar e ka me Uashingtonin dhe Shtëpinë e Bardhë, ndërsa duket se ka provokuar një debat të ashpër kur ka pyetur ish-kryeministrin nëse mund të shkonte më në Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo jo, duke aluduar kështu se atij i është refuzuar hyrja në SHBA. "Ti Sali e kapërcen dot oqeanin me dash? Hajde përgjigju", - tha kryeministri. Në përgjigjen e tij Berisha nuk e ka bërë të qartë nëse aludimi i Ramës ishte i saktë apo jo, por ka theksuar se ai nuk bënte më vizita zyrtare që nga koha kur ishte larguar nga angazhimi i tij në krye të PD-së dhe qeverisë. "Çdo muaj marr ftesa dhe marr, por e kam të vendosur se nuk udhëtoj për qëllime zyrtare askurrkund", - u shpreh Berisha, ndërsa iu kundërpërgjigj kryeministri me një pyetje po ashtu të drejtpërdrejtë në lidhje me faktin nëse bashkëshortja e tij kishite aksione në ABIBank apo jo. "Edi, Edwin, na thuaj zonzja Basha ka opsione ose aksione në Bankë, offshor", - pyeti Berisha. Rama nga ana e tij mohoi që kjo të ishte e vërtetë, ndërsa kaloi nga debati politik në një fjalor të rëndë kundër Berishës. "Po ta përsëris të je njeri që je marrë me gratë dhe me mbesat. Ti je njeri që s'ke kanun dhe s'ke moral... Por t'i gruas time dhe familjes time i ha ato që nuk thuhet", - u shpreh Rama. Kaq ka mjaftuar që edhe ish-kryeministri Berisha të shpërthejë me një batore fjalës dhe akuzash të rënda kundër vet Ramës, por edhe duke prekur familjarët e tij. "Ti je fundërrinë që u merr shokëve gratë. Ti shet çdo moral mor

horr: Ti je njeri që mohon djalin tënd", u shpreh Berisha. Pas kësaj situata ka dalë thuasje jashtë kontrollit, ndërsa kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi i ka ndërprerë fjalën Berishës. Kjo ka

bërë që deputetët e opozitës të bllokojnë foltoren dhe të kërkojnë nga Ruçi që t'i japë sërish fjalën ish-kryeministri Berisha. Për të qetësuar situatën, kryeparlamentari, Gramoz Ruçi ka ndër-

prerë për disa minuta seancën, e cila rinisi me një fjalë të kreut të opozitës Lulzim Basha. Pas kësaj opozita u largua nga salla, ndërsa vetë Berisha duke folur për mediat hodhi posh-

të si të pavërtetë që atij t'i ishte mohuar e drejta për të hyrë në SHBA. "Jo, kurrë. Në mënyrë absolute kurrë. Është një trillim fund e krye. Por unë udhëtoj shumë rrallë", - tha Berisha.



Ish-kryeministri Sali Berisha, dje në Kuvend

FAMILJA

"Po ta përsëris ti je njeri që je marrë me gratë dhe me mbesat. Ti je njeri që s'ke kanun dhe s'ke moral... Por t'i gruas time dhe familjes time i ha ato që nuk thuhet", - u shpreh Rama. Kaq ka mjaftuar që edhe ish-kryeministri Berisha të shpërthejë me një batore fjalës dhe akuzash të rënda kundër vet Ramës, por edhe duke prekur familjarët e tij

DEGJENERON DEBATI, RAMA DHE BERISHA NUK KURSEJNË NJËRI-TJETRIN

Edi Rama: ABI Bank është një bankë, e cila monitorohet drejtpërdrejt nga Enti Rregullator i Bankave në SHBA dhe nëse bashkëshortja ime do të ishte akcionere, të jesh i sigurt që mua nuk do më lejonin të kapërceja oqeanin. Ti Sali e kapërcen dot oqeanin me dash? Hajde përgjigju. Ta dhashë përgjigjen e drejtpërdrejt, mu përgjigj drejtpërdrejt. Nëse unë do të isha ai që më përshkruani ju, të jeni i sigurt se s'do ta kapërceja oqeanin dhe jo të komunikojta me Shtëpinë e Bardhë me kërkesë të Shtëpisë së Bardhë. Ndaj dhe një herë po të pyes ti Sali me dash të kapërcen dot oqeanin?
Sali Berisha: Edi, Edwin, na thuaj zonzja Basha ka opsione ose aksione në Bankë, off shore. Na thuaj si shokove me bish në shalë në Berlin dhe s'të dhanë asnjë takim... E treta, kur unë u largova nga aktiviteti, nuk kam bërë dhe kam refuzuar çdo lloj ftese nga kushdo që më ka ardhur për arsye që më së shumti përfaqëson zgjedhës në parlament, por më së shumti është person privat. Kam marrë ftesa nga përtej oqeanit më shumë ftesa se askush tjetër, marr ftesa thuasje çdo dy muaj. Por iu jam përgjigjur që në krye të herës se nuk mundem pasi nuk jam person që përfaqësoj një forcë politike, por veten time. Çdo muaj marr ftesa dhe marr, por e kam të vendosur se nuk udhëtoj për qëllime zyrtare askurrkund. Të më tekton kur të më tekton, Edi Rama me SHBA-të kam arritur atë që s'mund ta arrish dot ti kurrë. Kanë qenë republikanë, kanë qenë demokratë nuk ia kam thënë turp i qytetërimin, siç i kam thënë ti Trump dhe pastaj jep 20 mln dollarë për ta takuar. Kam qëndruar në pozicionin me dirjitet të çdo shqiptari.
Rama: Dole fole këtu, por e bëre një gabim. The që nuk del jashtë shtetit, por t'i shkon në Bundestag me Fatmir Mediu dhe nuk lë gjë pa thënë për vendin. Unë të dija, ti me dash të kalon dot oqeanin apo jo? Ki kujdes, sepse e mbylle fjalën me një çështje që s'kishite lidhje fare me pyetjen time dhe me shqetësimin tënd. The që unë i kam hyrë një lojë të rrezikshme. Është Luli që ka paguar para nëpërmjet rusëve për një fotot me Trump. Akuzo jote se kam paguar 20 mln dollarë për të paguar

presidentin Amerikës rëndon atë jo mua, sepse ai është i ndaluar të bëjë një gjë të tillë. Po ta përsëris ti je njeri që je marrë me gratë dhe me mbesat. Ti je njeri që s'ke kanun dhe s'ke moral... Por t'i gruas time dhe familjes time i ha ato që nuk thuhet.
Berisha: Ti je fundërrinë që u merr shokëve gratë. Ti shet çdo moral mor horr. Ti je njeri që mohon djalin tënd. Ti je fundërrinë njerëzore. Njeriu që mohon djalin tënd, që ke akuzuar babën për përdhunues, inçest, fundërrinë njerëzore.
Rama: Vetëm ilustrova atë që të thashë, që nuk ke lidhje me asnjë libër të vjetër a të ri të rregullave të bashkëjetesës shqiptare. Në vitin 2000 ti bashkë me disa rreth teje ke fabrikuar një dokument fals, sipas të cilit unë kam bërë gjyq dhe unë kam mohuar atësinë e djalit tim. Je ti që e ke bërë këtë gjë, e ke ushqyer, ke shkakuar dhimbje e lot në familjen time, por e ndolle Sali, vizat e mallit, të bardhë, të bardha, e ndolle, unë nuk kam lidhje as me vizat e mallit as me vizat e bardha, ti shiko vizën e kuqe që të ndan ty me anën tjetër të oqeanit.
Berisha: Çfarë i tha Besnik Mustafaj, tri gjera i tha: nuk vjedh, nuk vras dhe nuk marr gruan e shokut, ja the o i pafytyrë, ja ke thënë apo jo, fol këtu. Ka dokument i ka botuar Ymer Baze që të mban peng me dosjen e djalit, të gjyqit. I ke të botuar dhe nesër do i shohësh të ribotuar, ja ku është, nuk është këtu Ilir Meta se është president, ai të ka detyruar për të njohur djalin se nuk do të votonte për kryetar bashkie. Edhe kafshën, edhe derrin, lopën, gomarin, qenin po ta shohësh që nuk kujdeset për këlyshin do ta heqësh qafe, ky ishte për ta heq qafe, një njeri që i bën fëmijës së vet nuk meriton të jetë njeri, ai që ia bëri rri në zyrën e tij. Se ai ka origjinalin, ka kartelën klinike, dosjen gjyqësore e dinë mirë të gjithë.
Ruçi: Zoti Berisha ulu e mbarovet kohën.
Flamur Noka: Jepi fjalën...
Ruçi: Jo, jo nuk e jap, as me urdhër as me presion dhe as me intimidim. Uluni. Si zakonisht do dalësh përjashta ti (i drejtohet Flamur Nokës). Zoti Berisha të paralajmëroj për bllokim të foltores.



Seanca e djeshme parlamentare



Edi Rama: Fola me John Bolton në telefon; më falënderoi për qëndrimet

Kryeministri Edi Rama njofton nëpërmjet një postimi në "Twitter" se ka zhvilluar një bisedë telefonike me John Bolton, këshilltar i presidentit amerikan, Donald Trump. Sipas Ramës në fokus të bisedës ka qenë Shqipëria dhe arritja e një marrëveshje paqje midis Kosovës dhe Serbisë. Bolton e ka falënderuar Ramën për qëndrimet e vazhdueshme të Shqipërisë. "Bisedë me Shtëpinë e Bardhë. Në fokus Shqipëria, rajoni dhe objektivi strategjik për një marrëveshje paqje me Kosovës e Serbisë, që të mbyllë konfliktin historik. Këshilltari për Sigurinë J. Bolton, më falënderoi në emër të Presidentit për qëndrimet konsekuente të Shqipërisë", shkruan Rama. Ndërkohë, në debatin e zhvilluar sot në Kuvend, Rama tha se nuk i duhet ndërmjetës për të komunikuar me SHBA-në, si dhe "Zërin e Amerikës" e quajti "zëdhënës të kazanit shqiptar".



VOA faktoi se gjysma e parlamentit është e zgjedhur nga një grusht kriminelësh

PD: 'Zëri i Amerikës' kryqëzoi Dakon. Rama: Përsëri 'kazan'

"Zëdhënës i kazonit të Tiranës, investigimi sallatë fjalësh"

Investigimi i publikuar të mërkurën nga 'Zëri i Amerikës' që denonconte mekanizmin e blerjes së votave nga kryebashkiaku i Durrësit, Vangjush Dako, ka qenë kryefjala e seancës së djeshme plenare. Opozita akuzoi qeverinë dhe mazhorancën për lidhje me krimin, ndërsa tha se ky investigim vërtetoi edhe një herë akuzat që ka ngritur opozita në vazhdimësi për vjedhjen e zgjedhjeve.

BASHA

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha duke marrë fjalën në këtë seancë u shpreh se 'Zëri i Amerikës' faktoi se gjysma e parlamentit është e zgjedhur nga një grusht kriminelësh me të cilët mazhoranca ka lidhur fatin e saj. "Gjysma prej jush janë këtu, jo për shkak të votave të socialistëve shqiptarë, kundërshtarëve tanë politikë, për të cilët, ndasitë ideologjike për mënyrën se si duhet qeverisur vendi ndajne dashurinë për këtë vend, por jeni këtu për shkak të një grushti kriminelësh me të cilët keni lidhur fatin tuaj, që ju kanë kapur prej tirandash dhe ju kanë sjellë këtu për t'i shërbyer interesave të tyre", tha Basha. Më tej ai u shpreh se socialistët kanë zhytur vendin në krizë dhe se nuk u bëhet më vonë për qytetarët e thjeshtë. "E di gjithë bota si e morët pushtetin në 2017. Siç u thamë prej ditës së parë e morët me pazaret që keni bërë me krimin. Kur e lidh fatin me Ymer Lalën nuk të çahet koka për dibranët e thjeshtë. Kur e lidh fatin me Emiljan Shkullazin e me Dritan Dajtin nuk të bëhet vonë as për banorët e Tiranës, as për pensionistët", - shtoi më tej Basha duke theksuar se mazhoranca flet me kod mafioz. Ndaj evidentoi ai zgjidhja e vetme që imbetet qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama është që të pranohet krijimin e një qeverie tranzitore që do përgatisë zgjedhjet e lira dhe të ndershme. "O do të bëhet kjo përmes një zgjidhje politike, siç po ua propozon opozita ose rrugë tjetër për ta fshirë këtë parlament me forcën e sovranit, se nuk është i juaji, nuk është as i kriminelëve me të cilët bëni pazaret. Është i popullit ky parlament. Thirrini mendjes! Tik-tak po afron ora! Thirrini mendjes!", - u shpreh Basha duke deklaruar se Rama është padroni i Dakos.



Kryetari i PD-së, Lulzim Basha

PROPOZIMI

"O do të bëhet kjo përmes një zgjidhje politike, siç po ua propozon opozita, ose rrugë tjetër për ta fshirë këtë parlament me forcën e sovranit, se nuk është i juaji, nuk është as i kriminelëve me të cilët bëni pazaret. Është i popullit ky parlament. Thirrini mendjes! Tik-tak po afron ora! Thirrini mendjes!"

ALIBEAJ: VOA FAKTOI DENONCIMET TONA

Deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj i ftuar në rubrikën "Opinion" në News 24 tha se blerja e votave është denoncuar prej 5 vitesh nga PD, ndërsa 'Zëri i Amerikës' thjesht e 'celebroi' si të vërtetë. Alibeaj tha se pas përgjimeve të publikuara dje nga VOA në lidhje me telefonat e kreu të bashkisë së Durrësit me bandën e Avdyllajve, sot sipas tij, Dako duhet të ishte në burg.



Gjushi: Nuk faktohet shitblerja e votave, dua të rikandidoj

Kryetari i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako ka konfirmuar përmbytjen e përgjimeve të publikuara nga VOA sa i përket drekës me Avdyllaj, por ka deklaruar se ka qenë i ftuar dhe se në tryezë ishin mbi 10 persona. Duke folur në emisionin "Open", Gjushi tha se ai në punën e përditshme ulet në dreka dhe kafë me çdo person dhe se nuk i shikon atyre as diplomën dhe as dëshminë e penaltetit. "Dreka e Shkalla unë ha përditë me njerëz në nevojë, grupe interesi, ata që kanë nevojë të takohen me mua. Në rastin konkret kam qenë i ftuar nga vëllezërit pronarë të atij hoteli, së bashku edhe me disa të tjerë. Fati im i keq, që të ftuar kanë qenë edhe këta emra që përmendni ju, në një ngjarje të vitit 2017. Unë s'mbaj përgjegjësi për çfarë thonë ata, dikush mund edhe të mashtrorë për të ftuar besueshmëri. Unë nuk mbaj mend që të ketë qenë i ulur në tavolinë Altin Avdyli. Nuk mbaj unë përgjegjësi nëse kanë precedentë penale të ftuarit e tjerë apo jo. Unë zhvilloj takime me të gjithë personat që i shoh si votues, pa parë as diplomën, as patentën dhe as nëse kanë apo jo precedentë penale", u shpreh Vangjush Dako. Ai shtoi se vëllezërit Avdyllaj janë votues të PS-së dhe se ai flet në telefon me këdo që kontribuon dhe voton për të. "Për mua ata janë votues të Partisë Socialiste, të paktën këtë radhë, pasi në zgjedhjet e ardhshme ndoshta mund të përkrahin të tjera palë", - u shpreh Dako, duke theksuar se s'ka fakte për implikim në shit-blerje votash. Pavarësisht përgjimeve të publikuara ai nuk ka hequr dorë nga kandidimi për një tjetër mandat për kryetar bashkie. "Janë strukturat e PS-së ato që do të vendosin.", - tha Dako.

PËRGJIMET

Në gjurmët e kryeministrit Edi Rama edhe Vangjush Dako ka sulmuar sot 'Zërin e Amerikës'. Kanali zyrtar i DASH është sulmuar nga kryebashkiaku i Durrësit. "Ka degradim të Zërit të Amerikës", ulje të atij televizioni, ka qenë një inspirues në vitet '80", - tha Dako dje në emisionin "Open".

Ndërsa erdhi me vonesë në sallë, kryeministri, Rama nuk i është shmangur de-

Kuvendi voton hetimin e "Gent Cakajt", hedh poshtë Bahri Shaqirin

Procedura e ndjekur nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për dhënien e certifikatës së sigurisë për zëvendësministrin e Jashtëm, Gent Cakaj, do të hetohet nga Kuvendi. Seanca plenare ka votuar me votat e mazhorancës dhe 4 vota të opozitës, kërkesën e Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim për ngritjen e një komisionit të posaçëm hetimor që do të hetojë gjithë procedurën e ndjekur nga DSIK në rastin e Gent Cakajt, ndërsa ka hedhur poshtë dekreten e presidentit Ilir Meta për të emëruar në krye të KLSH-së, Bahri Shaqirin. Varianti i miratuar nga seanca sa i përket komisionit hetimor, nuk është i njëjtë me atë që paraqitën dy forcat politike PD dhe LSI, por një variant i



dakordësuar edhe me mazhorancën. Ky vendim morri 78 vota, ndërmjet të cilave edhe 4 nga opozita, ndërkohe që dy deputetë abstenuan. Komisioni do të drejtohet nga deputeti Enkelejd Alibeaj në pozicionin e kryetarit dhe deputetja Ermonela Felaj në pozicionin e nënkryetarit dhe përfaqësueses së shumicës qeverisëse. Ndërkohë që anëtarë do të jenë Ervin Salianji, Luan Rama dhe

KOMISIONI HETIMOR

- Enkelejd Alibeaj
- Ermonela Felaj
- Ervin Salianji
- Luan Rama
- Xhemal Gjunkshi
- Xhemal Qefalia
- Alket Hyseni
- Spartak Braho
- Klotilda Bushka

Xhemal Gjunkshin nga opozita dhe Xhemal Qefalia, Alket Hyseni, Spartak Braho dhe Klotilda Bushka nga mazhoranca. Ndërkohë që gjatë seancës së djeshme mazhoranca rrëzoi edhe kandidaturnën e dytë të presidentit Ilir Meta për kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Me 77 vota kundër, seanca hodhi poshtë kandidaturnën e ish-kreu të SHISH, Bahri Shaqiri.

batit për investigimin e 'Zërit të Amerikës', ndërsa nuk ka ngruar ta cilësojë edhe një herë atë kazon. "Fatkeqësisht, është e dyta herë në një periudhë kohe të shkurtër që Zëri i Amerikës bëhet zëdhënës i kazonit të Tiranës. Këtë herë mund të them vetëm kaq, asgjë e re nga fronti juaj. Një sallatë fjalësh, e cila nuk ka asnjë shans të çorodisë asnjë shqiptar të vetëm, zero", - tha kryeministri. Për të 'Zëri i Amerikës' nuk është në të vërtetë zëri i SHBA-ve, duke theksuar se me qeverinë amerikane ai komunikon në

mënyrë të drejtpërdrejtë. "Me Amerikën, ne kjo qeveri dhe unë personalisht, komunikojmë drejtpërdrejtë", - tha Rama duke paralajmëruar telefonatën me Sekretarin Amerikan. Duke iu përgjigjur thirrjes së opozitës për të krijuar një qeveri tranzitore, Rama është shprehur se Basha është mësuar me "qofte tek daja", duke lënë të kuptohet se nuk do të ketë asnjë lëshim në këtë drejtim. "Është mësuar me 'qofte tek daja' dhe kujton se me 'qofte tek daja' do të vazhdojë. Lulëzim, unë të kam thënë vazhdimisht, se ti e di që ne komu-

nikojmë dhe ti bën sikur nuk komunikon dhe sikur nuk dëgjon, por ti duhet ta mësosh, "qofte tek daja" nuk ka. Dakord?", - tha Rama. Ndaj ai e ka ftuar opozitën të bëhet pjesë e reformës zgjedhore, ndërsa ka paralajmëruar se ajo në qershor do humbasë dhe Bashkinë e Kukësit". Kukësit i latë shkopin, këtu sollët flamurin. Me këtë do ta sjellësh Partinë Demokratike në pushtet ti? Apo me këtë lala Gjomin këtu? Hajde Lul, një mundësi ke ti që të vish në pushtet, ta kam treguar, reflekto, këtu jemi", - tha kryeministri.

AKSIONI I OPOZITËS

INTERVISTA

Nënkryetari i PD: Me LSI në zgjedhje, po evidentojmë zonat ku jemi më të fortë

Spaho: Rama vodhi 3 palë zgjedhje, si do të jetë qeveria transitore

"Protestat pa afat, qëndresë deri sa të ikë Rama"

Valentina Madani

Opozita përmes protestave lokale që nisën më 4 shkurt dhe asaj që kulmojnë më 16 shkurt në Tiranë, synon largimin e Edi Ramës nga pushteti dhe krijimin e një qeverie transitore, e cila të mund të garantojë zgjedhje të lira. Nënkryetari i PD-së, Edmond Spaho, thotë për "Gazeta Shqiptare" se opozita nuk po lufton për pushtetin e saj, por sipas tij, vendi është zhytur në krizë ekonomike dhe sociale. Ai akuzon se qeveria "Rama" ka asgjësuar çdo liri, ndaj tregon se si duhet të funksionojë qeveria transitore që sipas tij nuk ka rëndësi se çfarë ngjyre politike do të ketë, e majtë apo e djathtë. Funkzionari i lartë i PD-së flet për përgatitjet e zgjedhjeve lokale, bashkëpunimin me LSI-në dhe rrugët që rikthejnë PD-në në pushtet.

Z.Spaho, opozita ka ftuar qytetarët në një protestë të madhe kundër qeverisë më 16 shkurt. Çfarë do ndodhë atë ditë?

Opozita ka ftuar qytetarët të protestojnë për krizën politike, ekonomike dhe sociale me të cilën po përballen prej shumë kohësh si dhe për indiferencën e qeverisë. Mazhoranca e sotme është ilegjitime, sikurse del edhe nga publikimet e "Zërit të Amerikës" për zgjedhjet e vitit 2017. Mjafton ky fakt për t'i dhënë kauzë çdo lëvizjeje qytetare. Ne kemi jo vetëm një qeveri të dalë nga lidhjet me krimin dhe drogën, por edhe një qeveri të pangopur, e cila po u zhat njerëzve taksat që mblihen në buxhet. Mjaft t'i referohesh skandalit për tenderin e Unazës së Re, ku një kompani mashtruese fiton me kosto 20 milionë euro/km. Se sa thellë kanë hyrë në këtë skemë vjedhjeje, e tregon edhe anulimi së fundmi i tenderit të dytë, pasi një kompani e paparashikuar paraqiti një çmim rreth 6 milionë euro më të ulët për një km. Pavarë-



Nënkryetari i PD-së, Edmond Spaho

sisht se janë kapur me presh në duar, qeveria nuk heq dorë nga vjedhja e këtyre fondeve, pasi me sa duket, edhe haraçi është paguar. Qytetarët shqiptarë nuk gjejnë punë në vendin e tyre dhe i janë drejtuar masivisht emigracionit. Rreth 400 mijë shqiptarë janë larguar gjatë 6 viteve të sundimit të Edi Ramës, duke qenë vendi me emigracionin më të lartë në Europë. Skandalët dhe korrupsioni nuk kanë të sosur. Para disa ditësh një OJQ slovene publikoi të dhëna që familja e kryeministrit është e përfshirë në dallavere me shitjen e energjisë elektrike. Prej dhjetëra ditësh protestojnë studentët për kushtet e vështira mësimore dhe tarifën e larta, po kështu protestohet në Unazë, nga artistët, minatorët, nftetarët dhe në qytete të tjera të vendit. Në këto kushte nuk do ishte logjike që opozita të mos u drejtohej qytetarëve që ata të vijin e protestojnë për të shprehur pakënaqësinë e madhe dhe zemërimin që kanë me këtë qeveri.

Çfarë udhëzimesh po u jepni qytetarëve gjatë takimeve që po zhvillojnë deputetët dhe zyrtarët e lartë të PD-së? Sa i mundur është rrëzimi i Edi Ramës nga pushteti?

Qëllimi i takimeve me qytetarët në të gjitha bashkitë e vendit është të mobilizojmë çdo forcë të mundshme për të marrë pjesë në pro-

testat vendore që do organizohen deri në 10 shkurt në të gjithë vendin, por veçanërisht të sigurohet pjesëmarrje masive në protestën e datës 16 shkurt në Tiranë. Pjesëmarrja masive dhe qëndresa deri sa të arrihet objektivi do jenë dëshmi e krizës së thellë që ka kapur vendin dhe nevojës për të gjetur një zgjidhje.

Opozita kërkon zgjedhje pa Edi Ramën kryeministër dhe krijimin e një qeverie

ZGJEDHJET

"Në asnjë vend të botës nuk do mundte një qeveri të mbijetonte, nëse me prova tregohet se ka manipuluar dhe vjedhur jo një, por tri palë zgjedhje nga viti 2013", tha nënkryetari i PD-së.

transitore. Por, a duket kjo paksa si e përcaktueshme?

Nëse njerëzit janë të vendosur, gjithçka është e mundshme. Prandaj po u drejtohem qytetarëve për të marrë fatin e tyre në dorë. Në asnjë vend të botës nuk do mundte një qeveri të mbijetonte nëse me prova tregohet se ka manipuluar dhe vjedhur jo një, por tri palë zgjedhje nga viti 2013. Pas fakteve të publikuara mbrëmjen e së mërkurës, nuk besoj se ka dyshim për atë që opozita ka pretenduar prej 6 vitesh se Edi

QEVERIA TRANSITORE

"Qeveri transitore do të thotë qeveri me njerëz të përgjegjshëm, të cilët të bëjnë të mundur plotësimin e të gjitha kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve të lira. Nuk ka rëndësi ngjyra që do ketë ajo, e rëndësishme është që të largohet Edi Rama, i cili është armiku numër një i zgjedhjeve të lira dhe demokracisë në Shqipëri", tha Z.Spaho.

Rama ka ardhur në pushtet me krimin e organizuar dhe mbahet në pushtet nga ta dhe financimet e drogës.

Çfarë nënkupton PD-ja me qeveri transitore? Si është menduar që të jetë kjo qeveri e re?

Qeveri transitore do të thotë qeveri me njerëz të përgjegjshëm, të cilët të bëjnë të mundur plotësimin e të gjitha kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve të lira e të ndershme. Nuk ka rëndësi ngjyra

Në 17 maj 2017 u krijua një qeverisje disi e përbashkët për zgjedhje të lira dhe të ndershme, por sipas opozitës, zgjedhjet u manipuluan dhe nuk pasqyruan realitetin në Shqipëri. A mund të përsëritet sërish e njëjta situatë?

Ne nuk mund të lejojmë që të përsëritet e njëjta situatë. Në vitin 2017 i dhëmë besimin Edi Ramës dhe ai abuzoi në mënyrën më të turpshme. Rama e ka humbur besimin e opozitës dhe zgjedhje me të nuk do të ketë, pasi ai i vjedh dhe manipulon zgjedhjet për të mbetur me çdo kusht në pushtet.

A mund të jetë e PS-së,

Shoqeria "Rojen 03" shpk

ka importuar Cigaren me te nga Spanja Desert Blue and Desert Red me çmim 250 LEK"



Protesta e fundit e PD-së

PËR LSI

"Ne në zgjedhje do të dalim së bashku. Çdo forcë politike po bën bilancin dhe po evidenton mundësitë se ku është më e fortë. Mbi këto baza do përcaktojmë zonat ku do përfaqësohet çdo parti, duke u mbështetur nga të gjitha partitë e tjera".

qeveria kalimtare, e cila pritet të çojë vendin drejt zgjedhjeve të lira?

Asnjë problem nuk kemi me këtë. Ne nuk duam pushtet në tavolinë. Ne kërkojmë garanci që zgjedhjet do të jenë të lira e të ndershme, jo nën presionin e grupeve kriminale, vota të mos shitet e blihet, administrata dhe policia të shikojnë punët e tyre dhe të mos merren me zgjedhjet, që kutitë të mos mbushen nga të fortët, që mos falsifikohen procesverbalet, që të mos blihen komisionerët dhe një sërë fenomesh negative, të cilat i dhanë Ramës në qershor 2017 pushtet të pamërituar.

Në 17 maj 2017 u krijua një qeverisje disi e përbashkët për zgjedhje të lira dhe të ndershme, por sipas opozitës, zgjedhjet u manipuluan dhe nuk pasqyruan realitetin në Shqipëri. A mund të përsëritet sërish e njëjta situatë?

Ne nuk mund të lejojmë që të përsëritet e njëjta situatë. Në vitin 2017 i dhëmë besimin Edi Ramës dhe ai abuzoi në mënyrën më të turpshme. Rama e ka humbur besimin e opozitës dhe zgjedhje me të nuk do të ketë, pasi ai i vjedh dhe manipulon zgjedhjet për të mbetur me çdo kusht në pushtet.

Si do të alternohet aksioni opozitar përmes protestave, me rrugën parlamentare?

Aksioni opozitar i protestave do të kombinohet me luftën në parlament. Parlamenti është një mundësi shumë e mirë për të komunikuar me njerëzit, ku me fakte do të vazhdojmë të tregojmë kalbësinë dhe korrupsionin e Rilindjes dhe nevojën për një ndryshim politik dhe shoqëror.

Çfarë po bëni për përgatitjet e zgjedhjeve të 30 qershorit, a kanë nisur propozimet e kandidatëve për kryetar të bashki?

Sikur thashë me sipër, ne do të vijmë në pushtet vetëm me zgjedhje. Për rrjedhojë, po punojmë për ngritjen e shtabeve elektorale në të gjitha nivelet drejtuese të PD-së. Paralelisht po testojmë opinionin publik për të zgjedhur kandidaturat me përfaqësues dhe që mund të fitojnë përkrahjen e sa më shumë segmenteve të votuesve. Shpejt do të njiheni me emrat e atyre që do përfaqësojnë opozitën në të gjitha njësitë vendore.

A janë të duhurit për opozitën, që premtorinë fitore me 30 qershor, Jorida Tabaku në Tiranë dhe Gazmend Oketa në Durrës?

Nuk mund të flas për emra të përveçëm, sepse ende nuk jemi në këtë fazë dhe vendimet për të merren nga kryesia e Partisë Demokratike.

A ka nisur PD diskutimet me aleatët, në mënyrë të veçantë me LSI-në për zgjedhjeve e kandid...



Kreu i PD-së, thirrje shqiptarëve: Më 16 shkurt të shtrijmë përdhe qeverinë

'Unaza', Basha: U prish pazari, Rama e Veliaj do shkojnë te 313-ta

"Prokuroria të çojë në burg vjedhësit e votave"

Valentina Madani

Nga Unaza e Re, ku rezistenca e banorëve të "Astirit" është shndërruar në simbol të protestës përgjatë 89 ditëve, kreu i opozitës, Lulzim Basha, ftoi dje qytetarët të dalin masivisht në protestën e 16 shkurtit për të shtrirë përdhe, siç tha ai, këtë qeverisje të korruptuar dhe të inkriminuar. "Ju bëj thirrje të ngriheni dhe të protestoni për xhepat tuaj, për të ardhurat tuaja, për të ardhmen tuaj dhe fëmijët tuaj. Bashkohuni masivisht më 16 shkurt. Këtyj mali të abuzimit, të korrupsionit, këtyj mali të vjedhjes, nëpërkëmbjes, poshtërimit dhe arrogancës. T'i japim një grusht mu në zemër pushtetit korruptiv të Edi Ramës dhe ta shtrijmë përdhe. Ju keni të drejtën, ju keni forcën dhe kurajën, jepini dorën dhe besën njëri-tjetrit t'ua kthejmë Shqipërinë shqiptarëve, më 16 shkurt të gjithë së bashku dhe të ndalim qeverinë më të korruptuar dhe inkriminuar në 29 vite pluralizëm. Të ndalim këtë bandë hajdutësh. Nuk ka forcë tjetër që mund ta ndalë përvëç qytetarëve të bashkuar. Nuk ka shembull më inkurajues sesa ky i Unazës së Re. Nga ky shesh i qëndresës, sot në këtë ditë të 89, u bëj thirrje të gjithë qytetarëve të Tiranës të jemi bashkë si një familje e mad-



Kreu i opozitës, Lulzim Basha, dje me banorët e Unazës së Re

AKUZA

"Siç është prishur pazari tek Unaza, e morët vesh apo jo. Është futur një fatkeq dhe ka ofruar 5 milionë euro më pak se ai që do fitonte tenderin. Ishtë përcaktuar që do ta merrte Gjoka dhe kapari është paguar", tha kreu i PD-së.

datëve? A ka dakordësi mes palëve për zonat apo për emra të veçantë për garën e 30 qershorit?

Ne në zgjedhje do të dalim së bashku. Çdo forcë politike po bën bilancin dhe po evidenton mundësitë se ku është më e fortë. Mbi këto baza do përcaktojmë zonat ku do përfaqësohet çdo parti, duke u mbështetur nga të gjitha partitë e tjera.

Si do të vijë PD-ja në pushtet dhe a është ajo gati të qeverisë ndryshe shqiptarët?

PD është forca me formimin më modern në shoqërinë tonë. Ne jemi forca politike që zhvillojmë zgjedhje të rregullta brenda nesh dhe forcën për të zgjedhur ia kemi kaluar anëtarësisë. Në këtë mënyrë ne garantojmë që jemi forcë institucionale, e cila kur të jetë në pushtet, do të respektojë institucionet dhe ndarjen e tyre. Së

dyti, PD ka bërë rinovim të ekipit drejtues. Askush nuk mund të akuzojë askënd në Partinë Demokratike për lidhje me krimin e organizuar apo se është i korruptuar dhe ka abuzuar me fonde publike. Këto janë garanci që ata të cilët do të drejtojnë nesër, do të kenë në qendër të punës së tyre interesin publik. Së treti, Partia Demokratike u ka paraqitur qytetarëve shqiptarë një program, i cili synon të adresojë problemet me të cilat ndeshet Shqipëria, të zhvillojë ekonominë, të hapë vende pune, të sigurojë të ardhura për çdo individ që të ardhmen ta shikojnë këtu dhe jo në emigracion. Politikat tona për taksë të sheshtë 9%, mbështetje të bujqësisë, arsimit, dhënies fund të PPP janë realiste dhe garantojnë zhvillim ekonomik e social afatgjatë.

PARALAJMERIMI

"As Edi Rama as Erion Veliaj nuk kanë për të shkuar në asnjë vend tjetër përveçse në burgun 313, aty ku quan me të padrejtë fëmijë 13-vjeçarë dhe nëna shtatzënë, sepse mbronin prapun e shtëpive të tyre. Nuk do t'i lejojmë të arratisen nga Shqipëria, por do të japin përgjegjësi para drejtësisë", tha z.Basha.

he dhe të marrim fatin tonë, fatin e familjeve tona, fatin e qytetit tonë në duart tona më 16 shkurt".

AKUZA

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, paralajmëroi se kryeministri Edi Rama dhe kryebashkiaku i Tiranës, Erjon Veliaj do të shkojnë në burg për afera korruptive. Para banorëve të "Astirit", Lulzim Basha garanoi se Edi Rama dhe Erion Veliaj do të japin llogari përpara drejtësisë për afetar kriminale. Gjatë fjalës së tij me banorë protestues të zonës së "Astirit" në kryeqytet, Basha u shpreh se vendi i kryeministrit dhe kryebashkiakut është në qelinë 313 dhe nuk do t'i lejojë që të arratisen nga vendi. Dhe sipas Bashës, kjo do të ndodhë duke filluar nga 16 shkurti, datë kur është paralajmëruar se do të nisnin protestat e opozitës. "Prokuroria që fle gjumë mbi dosjet e krimin duhet të nisë sot hetimin edhe për shumt e mëdha të parave të krimin, që sipas burimeve të sigurta media-tike, Erion Veliaj do të shpenzojë për të blerë vota në këshillin bashkiak për të vjedhur pasuritë e qytetarëve shqiptarë, për të vjedhur pasuritë publike të Tiranës dhe për të dhënë të tjera skema korruptive, siç është zhvendosja e lumit të Lanës tani me policinë bashkiake. Por i garantoj, as in filtrimi sistemit të drejtësisë me bashkëpunëtorë të Sigurim-

it të Shtetit, as shantazhimi i organeve të reja të drejtësisë nuk ka për t'i shpëtuar këta njerëz që janë bërë urë dhe mburojë për Edi Ramën, për Erion Veliajin dhe politikanë të tjerë të korruptuar e të lidhur me krimin do të ikin me turp dhe me vrap nga bashkimi dhe mllëfi popullor i 16 shkurtit", deklaroi z.Basha. Kreu i PD-së garatoi se: "Drejtësia do të pastrohet dhe rinia e 'Astirit' mbani vesh, as Edi Rama dhe as

Erion Veliaj nuk kanë për të shkuar në asnjë vend tjetër, përveç se në burgun 313, aty ku quan me të padrejtë fëmijë 13-vjeçarë dhe nëna shtatzëna. Nuk do t'i lejojmë të arratisen nga Shqipëria, por do të japin përgjegjësi përpara drejtësisë. Kjo është rruga europiane, ky është modeli evropian". Akuzat kryedemokratit hodhi edhe ndaj organit të akuzës. "Po asistojmë në një farsë totale. Prokuroria duhet të çojë në burg politikanët e kapur në flagrancë, nuk do blerë e shitur vota. Me aktin e sotëm ku ajo shqetësohet për nxjerrjen e sekretit nga Zeri i Amerikës", prokuroria meriton grushtin më të fuqishëm më 16 shkurt, njësoj si Edi Rama dhe Erion Veliaj". Nga Unaza, Basha u bëri thirrje qytetarëve të Tiranës për pjesëmarrje në protestën e 16 shkurtit.

United Nations Development Programme

VACANCY ANNOUNCEMENT

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancy.

1- Post Title:	Outcome Coordinator on Employment
Deadline for Application:	February 5, 2019
2- Post Title:	Outcome Coordinator on Institutional Capacity Building
Deadline for Application:	February 9, 2019
3- Post Title:	Programme Coordinator
Deadline for Application:	February 9, 2019

Type of Contract: Service Contract
Project: Skills Development for Employment Programme
Duty Station: Tirana, Albania
Duration of Assignment: 1 year with possibility of extension

Job Description: <http://al.undp.org>
 Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>. Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.

Borchardt: Keqardhje që korrupsioni u përkeqësua nga 2017-ta

Duke marrë shkas nga raporti i "Transparency International", i cili përkeqëson situatën e korrupsionit në Shqipërisë, ambasadori i OSBE-së në Tiranë, Bernd Borchardt, deklaroi dje se mungesa e progresit kundër këtij fenomeni mbetet një nga problemet e mëdha. Për vitin 2018, Shqipëria renditet në vendin e 99-të në botë nga 180 vende, duke u përkeqësuar me dy pikë krahasuar me vitin paraardhës dhe tri pikë krahasuar me vitin 2016. "Mungesa e progresit në luftën kundër korrupsionit mbetet një nga problemet më serioze që ndeshet në shumë vende të botës, duke dobësuar sistemet demokratike dhe duke dobësuar kështu besimin e qytetarëve në proceset demokratike. Prirja negative në rastin e Shqipërisë është edhe më shqetësuese, pasi përmbys përmirësimin e dukshëm në perceptimin e korrupsionit mes viteve 2013 dhe 2016. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri shpreh keqardhjen që prirja pozitive që ekzistonte prej vitit 2013 e më tej u përmbys në 2017-ën dhe u përkeqësua më tej në vitin 2018. Ne mbetemi të përkushtuar që ta mbështesim Shqipërinë në luftën e saj kundër korrupsionit", tha z. Borchardt. Ambasadori i OSBE deklaroi se reformat e ndërmarra, përfshirë këtu vetëgjinjen në sistemin e drejtësisë, duhen realizuar si dhe të ngrihen institucionet e reja kundër korrupsionit.

GJAKMARRJA SITUATA

INTERVISTE/ Kreu i Komitetit Shqiptar të Pajtitimit: Si duhet të veprohet

Gjin Marku: Si takova familjen Bilali, kërkuam ndihmë për gjakmarrjen

"Zonat tipike të hakmarrjes, Kombinati, Yzberishti, Selita..."

Rezarta Delisula

Në janarin e vitit 2019 janë kryer 7 vrasje për shkak të gjakmarrjes. Kreu i Komitetit Shqiptar të Pajtitimit, Gjin Marku, rrëfen për "Gazeta Shqiptare", nisur nga vrasja e ish-policit mesditën e së mërkurës në Selitë, që familja e tij kishte shprehur këtë shqetësim, ndërsa autorët e vrasjeve të vëllezërve të Arben Bilalit nuk u identifikuan nga policia. Sipas tij, zonat më tipike me mbartje familjesh në gjakmarrje janë Kombinati, Yzberishti, Selita dhe Kamza.

Z.Marku, ju jeni kryetar i Komitetit Shqiptar të Pajtitimit, si e gjykoni situatën e fundit të gjakmarrjeve në vend?

Edhe pse numri i vrasjeve për muajin janar të këtij viti është 7 e nuk kalon mesataren e vrasjeve para vitit 2012, ato janë tregues serioz i gjendjes së rëndë të situatës së hakmarrjes e gjakmarrjes në Shqipëri. Nëse nuk do kishin emigruar mijëra familje që janë në hasmëri dhe kërkojnë azil jashtë shtetit, sot situata do ishte dhjetë herë më tragjike. Hasmëritë që kanë sjellë e vazhdojnë të sjellin gjakmarrje në Shqipëri, sipas mentalitetit të deformuar kanonor gjatë tranzicionit postkomunist janë thuajse në çdo derë shqiptari. Shumë pak familje të thonë se jemi të qetë e pa konflikte si brenda dhe jashtë shtetësisë. Kjo është e konfirmuar nga grupet e punës së pajtitimit që kemi në 2800 fshatra, nga 3200 që kishim më parë, sepse 400 fshatra janë braktisur dhe nuk ka asnjë shenjë jete në to. Për lugin 7500 mbi tokën në fshat, për ngatërresa e probleme të castit, për konfliktet në trafikimin e femrave apo të drogës, për konfliktet bashkëshortore e divorcet për shkaqe të ndryshme që prekin njerin e dinjitetin e familjes apo personit, nga konfliktet e trashëguara e ato të lindura gjatë 29 viteve të tranzicionit kemi rreth 15 000 të vrarë, që nga viti 1990. Po të mos ishte zakoni i mirë e pajtitimit e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve pa shkuar në gjykatë dhe largimet jashtë Shqipërisë për shkak të hasmërisë, mund të themi pa lëkundje se sot do të kishim jo 15000 viktima, por 150 000 të vrarë. Organizata e Kombeve të Bashkuara ka të regjistruara për çdo vit numrin e familjeve që kërkojnë azil për shkak të rrezikut ndaj jetës nga çdo vend i botës, përfshirë edhe Shqipërinë. Janë rreth 250 000 familje shqiptare që kanë kërkuar mbrojtjen e jetës jashtë Shqipërisë gjatë këtyre 29 viteve tranzicioni.

Të mërkurës ndodhi një tjetër vrasje, ajo e Arben Bilalit, ku autor dyshohet gjaksi. E njohit si rast? Mund të na thoni ndonjë detaj?

E njoh këtë familje fatkeqe dhe e di se ata janë përfshirë në disa raste tragjike, ku policia nuk ka mundur të



Kreu i Komitetit Shqiptar të Pajtitimit, Gjin Marku

identifikojë autorët. Ishpreh keqardhjen e ngushtëllimet më të thella familjes Bilali, e cila ka ngritur shqetësimin edhe para zyrës sonë, por pa identifikuar autorët. Pa identifikimin e autorëve, për ne ka qenë e vështirë të bëjmë hapa për pajtim e sqarim në vrasje vëllezërve Bilali. Kemi shumë raste të tilla. Ka edhe raste të tjera ekstreme vrasjesh, që autorët fshihen mbas vendimeve të gjykatave. Janë rreth 700 familje shqiptare që jetojnë në terrorin e një babai kriminel që ka bërë vrasjen dhe prokuroria e gjykata kanë dërguar në burg gruan e tij si vrasëse, duke e kamufaluar vrasjen si çështje nderi në një kohë që rrethi shoqëror e vetë gjykatësit e prokurorët e dinë që vrasjen e ka bërë burri, por ka detyruar gruan, qoftë edhe me kërcënim, që të thotë se e ka bërë ajo vrasjen me qëllim fshehjen e autorit dhe të motivit të kriminit. Organizatat e grave në Shqipëri janë krenarësisht të paafat të marrin në mbrojtje gratë e vajzat shqiptare, që janë jashtëzakonisht të dhunuara brenda familjes bashkëshortore.

Kenë bashkëpunuar me policinë për evidentimin e shmagjien e gjakmarrjeve?

Raportet vjetore, rezolutat dhe Memot e Komitetit të Pajtitimit Mbarëkombëtar japin të dhënat ekzakte të familjeve të përfshira në gjakmarrje e hasmëri, të konfirmuar edhe nga studimet e fundit të policisë së gjeneratës së re të shtetit në bashkëpunim me OSHEE-në. Policia e gjeneratës së re të shtetit bën përpjekje maksimale për ndalimin e kriminit, por e ka krejtësisht të pamundur ndalimin e vrasjeve për gjakmarrje si dhe marrjen në mbrojtje të familjeve në hasmëri. Në vitet 2016-2017 dhe 2018 qeveria Sh-

qiptare ka krijuar lidhje të drejtpërdrejta me Komitetin e Pajtitimit Mbarëkombëtar në procesin e parandalimit të vrasjeve për hakmarrje e gjakmarrje, duke bashkëpunuar në 2800 fshatra dhe në 60 bashki nëpërmjet nëpunësve bashkëkëmbëtorë dhe oficerëve të policisë me misionarët e pajtitimit. Është bërë e mundur që në sajë të këtij bashkëpunimi të ulët numri i vrasjeve me mbi 50% në krahasim me vitet e mëparshme. Policia e gjeneratës së re në bashkëpunim me Komitetin e Pajtitimit Mbarëkombëtar dhe OSHEE bënë një studim mbi familjet në hasmëri në 6 qarqet e veriut të Shqipërisë dhe hartoi një plan bashkëpunimi në procesin e pajtitimit. Për rastet e veçanta kur procesi i pajtitimit nuk bërë i mundur dhe familjet në hasmëri detyrohen të largohen nga Shqipëria për t'iu shmangur vrasjes është zbatuar Rekomandimi i Qeverisë Shqiptare nr. 1716, dt. 29. 9. 2009, lënë në fuqi nga gjykatat dhe prokuroria shqiptare, që u kërkon institucioneve vendore dhe ndërkombëtare t'i referohen Komitetit të Pajtitimit Mbarëkombëtar për vërtetimin dhe mbrojtjen e së drejtës së jetës së këtyre familjeve, me qëllim që të eliminohet çdo paqartësi dhe burim fiktiv të dhënash. Bazuar në këtë rekomandim, prokurorët dhe gjykatat kanë dënuar të gjithë përfaqësuesit e shtetit dhe të OJQ-ve që kanë lëshuar vërtetime hasmërie pa e arkivuar çështjen për shqyrtim e ndjekje në Komitetin e Pajtitimit Mbarëkombëtar, i cili udhëheq në shkallë kombëtare procesin e pajtitimit dhe organizon bashkërendimin profesional e ligjor me policinë e shtetit, gjykatat dhe prokurorinë si dhe zyrat e azilit për

mbrojtjen e emigrantëve që rrezikohen nga gjakmarrja. Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar është institucioni kompetent që udhëheq dhe bashkërendon punën në terren si dhe në praktikën ndërinstancionale brenda dhe jashtë Shqipërisë për procesin e pajtitimit dhe mbrojtjen e familjeve të përfshira në gjakmarrje. Me rekomandimin e qeverisë shqiptare, Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar ka pasur mbështetjen dhe bashkëpunimin e UNFPA-së, UNHCR, Këshillit të Evropës, Selisë së Shenjtë, si dhe të qeverive perëndimore si SHBA, Gjermania, Kanada, Franca, Anglia, Austria, Holanda, Zvicra, Norvegjia, Suedia, Finlanda, Danimarka, Italia, Greqia, Luksemburgu, Australia, Irlanda, Islanda, Zelanda e Re etj., për mbrojtjen e të drejtës së jetës së familjeve që emigrojnë për shkak të gjakmarrjes. Reportet e OKB-së dhe të Këshillit të Evropës bëjnë takime të përvitshme dhe konfirmojnë mbështetjen raportive të Komitetit të Pajtitimit Mbarëkombëtar në procesin e pajtitimit në Shqipëri si dhe mbrojtjes së të drejtës së jetës së emigrantëve shqiptarë në Evropë. Qeveria shqiptare ka bashkëpunuar me Komitetin e Pajtitimit Mbarëkombëtar edhe për të marrë një reformë të thellë në sistemin e drejtësisë, pasi shkaku kryesor i vrasjeve për hakmarrje e gjakmarrje janë

rjes, por disa nga këto vende kanë bërë refuzime të padrejta bazuar në lajmet e re me media se Shqipëria është vend i sigurt dhe se shqiptarët kërkojnë padrejtësisht azil për shkak të gjakmarrjes. Fatkeqësisht më 10 prill 2018, mbas refuzimit të azilit në Suedi dhe deportimit të tij në Shqipëri, vritet nga hasmi Marjo Majollari, i ati i të cilit ndodhet në burgim të përjetshëm për vrasje. Në fillim të janarit 2018, mbas refuzimit e deportimit në Shqipëri, i zihet pritë 23-vjeçarit Marenglen Mema, i cili ekzekutohet nga hasmit në makinën e tij, edhe pse lëvizte i maskuar. Të tilla vrasje kanë kulmuar më 10 shkurt 2016 kur u vra për gjakmarrje Xhevahir Brasha, emigrant nga rrethi i Hasit, pak ditë mbas kthimit nga Anglia. Vrasësit kishin marrë informacion që ai ishte kthyer në Shqipëri në një kohë të shkurtër. Në vitin 2016 Juglënd Kapllanaj vetëvritet sapo hyn në aeroportin e Rinasit mbas deportimit të tij nga Gjermania. Rastet e këtyre vrasjeve mbas refuzimit të kërkesës për azil dhe deportimit në Shqipëri kanë ardhur si pasojë e mosrespektimit nga zyrat e emigracionit të rekomandimit të qeverisë nr. 1716 dt. 29 shtator 2009 për ta verifikuar çështjen në zyrat e Komitetit të Pajtitimit Mbarëkombëtar. Në disa raste ka pasur vrasje për gjakmarrje edhe ndaj punonjësve

SHKAQET

Gjakmarrja ka kurba të ndryshme të zhvillimit të saj. Shkaqet kryesore të gjakmarrjes në tranzicion janë mungesa e drejtësisë dhe e zgjidhja institucionale e problemeve konfliktuale.

bërë vendimet e padrejta të gjykatave. Nga 600 000 vendime të gjykatave shtetërore palët kanë shkuar në hasmëri e gjakmarrjeje, duke sjellë pasojë tragjike me vrasjen e 4000 personave në 29 vite të tranzicionit, vetëvrasjen e 4200 vetave dhe kalimin në depresion të 22 000 qytetarëve. Shumica e vendeve perëndimore në zbatim të Konventës së OKB-së kundër torturës dhe dënimeve apo trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese kanë marrë në mbrojtje të drejtën e azilit të familjeve shqiptare që emigrojnë për shkak të gjakmar-

res dhe emigrantëve që rrezikohen nga gjakmarrja. Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar është institucioni kompetent që udhëheq dhe bashkërendon punën në terren si dhe në praktikën ndërinstancionale brenda dhe jashtë Shqipërisë për procesin e pajtitimit dhe mbrojtjen e familjeve të përfshira në gjakmarrje. Me rekomandimin e qeverisë shqiptare, Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar ka pasur mbështetjen dhe bashkëpunimin e UNFPA-së, UNHCR, Këshillit të Evropës, Selisë së Shenjtë, si dhe të qeverive perëndimore si SHBA, Gjermania, Kanada, Franca, Anglia, Austria, Holanda, Zvicra, Norvegjia, Suedia, Finlanda, Danimarka, Italia, Greqia, Luksemburgu, Australia, Irlanda, Islanda, Zelanda e Re etj., për mbrojtjen e të drejtës së jetës së familjeve që emigrojnë për shkak të gjakmarrjes. Reportet e OKB-së dhe të Këshillit të Evropës bëjnë takime të përvitshme dhe konfirmojnë mbështetjen raportive të Komitetit të Pajtitimit Mbarëkombëtar në procesin e pajtitimit në Shqipëri si dhe mbrojtjes së të drejtës së jetës së emigrantëve shqiptarë në Evropë. Qeveria shqiptare ka bashkëpunuar me Komitetin e Pajtitimit Mbarëkombëtar edhe për të marrë një reformë të thellë në sistemin e drejtësisë, pasi shkaku kryesor i vrasjeve për hakmarrje e gjakmarrje janë



hasmëri për konfliktet për pronën në qytet, 9875 hasmëri për konfliktet mbi tokën në fshat, 10654 hasmëri për fyerje të personit, 2431 hasmëri për borxhe të pakthyera, 1230 hasmëri për trafik të femrave, 87 hasmëri të krijuara brenda familjes për shkak të shfaqjes së prirjeve homoseksuale, 5674 hasmëri për tradhti bashkëshortore, 1254 hasmëri për lidhje dashurie midis personave me fe të kundërt në kundërshtim me traditën e familjes dhe të fisit si dhe 2067 hasmëri të bërë zgjidhje me mirëkuptim për 15490 mosmarrëveshjeve për probleme të ndryshme ekonomike, politike e ngatërresash të castit, që në shumtësinë e rasteve kalojnë në hasmëri e gjakmarrje, nëse nuk zgjidhen me mirëkuptim. Mbeten pa u realizuar pajtimet tek hasmëri problematike në Shqipëri kanë ardhur si pasojë e mosrespektimit nga zyrat e emigracionit të rekomandimit të qeverisë nr. 1716 dt. 29 shtator 2009 për ta verifikuar çështjen në zyrat e Komitetit të Pajtitimit Mbarëkombëtar. Në disa raste ka pasur vrasje për gjakmarrje edhe ndaj punonjësve

Sipas jush, cilat janë shkaqet e shtimit të gjakmarrjes?

Gjakmarrja ka kurba të ndryshme të zhvillimit të saj. Shkaqet kryesore të gjakmarrjes në tranzicion janë mungesa e drejtësisë dhe e zgjidhja institucionale e problemeve konfliktuale. Mosbesimi ndaj shtetit dhe organeve të drejtësisë ka qenë e mbetet shkaku kryesor i vrasjeve për gjakmarrje e hakmarrje që realisht janë me vetëgjyqësi dhe jashtë çdo kriteri zakonor, procedure apo natyre të gjakmarrjes së quajtur kanunore. Keqinformimi e keqinterpretimi i Kanunit kanë sjellë krime e



← vrasje me vetëgjyqësi që pasohen nga të tjera vrasje zinxhir.

Mund të na tregoni raste konkrete të ndërhyrjeve tuja deri në pajtim?

Procesi i pajtimit është punë e përditshme dhe nevojë e shoqërisë në çdo vend, ku ka jetë dhe aktivitet njerëzor. Komiteti organizon në shkallë kombëtare e më gjerë këtë proces. Kohët e fundit personalisht jam përfshirë në procesin e pajtimit mes familje Muslia e Ademi në Tropojë. Kam qenë mbi 14 herë. Familjet janë të dyja fisnike dhe shpresojmë ta mbyllim, sepse edhe familja e viktimës na ka pritur e përcjellë me shumë respekt, pavarësisht nga moskurorëzimi i ceremonisë mes palëve. Po ndjekim dhe kemi pasur rezultat shumë pozitiv me familjen Visha dhe të familjen e viktimës, familjes Beluli e Laska etj.

Cila është zona më tipike me të ngjuar në Tiranë për shkak të gjakmarrjes?

Zonat më tipike me mbartje familjesh në gjakmarrje janë Kombinati, Yzberish, Selita dhe Kamza. Problemet e tokave dhe krimi i organizuar në këto zona janë më të dukshëm për të sjellë pajtimet e vrasjeve e hasmëritë.

Sa është numri total i familjeve në gjakmarrje?

Në 2018-ën, siç e thashë më lartë, kemi 7 vrasje si pasojë e hakmarrjes e gjakmarrjes. Viti që shkoi ka pasur 70 vrasje ndër të cilat 17 brenda familjes, të tjerat nën mentalitetin e hakmarrjes e gjakmarrjes.

Çfarë masash duhet të marr shteti për shmangjen e fenomenit apo reduktimin? Sugjerime konkrete?

Shteti së pari duhet të mirorganizojë funksionimin e institucioneve dhe të drejtësisë. Reforma në drejtësi do jetë e pa efektshme nëse nuk zbaton fuqjen e jurisë së qytetarëve në proceset gjyqësore dhe bashkëpunimin e gjykatave shtetërore me pleqësitë e gjykatat kanonore. Pleqësitë (Gjykata Kanonore) të 2800 fshatrave të Shqipërisë dhe 60 bashkiqe që gjatë periudhës 29-vjeçare të transicionit post-komunist kanë zgjidhur me

marrëveshje e pajtim mbi 900 000 konflikte e hasmëri për: ndarjen e tokave, ujërat, pyjet, kullotat, për rrugët brenda fshatit, kalimet në pyje e lumenj, gardhet, dëmet e bagëtive, prerjet e lëndëve drusore, shfrytëzimin e rërave dhe gurorëve, vendvarrimet dhe kalimet në tokat e të tjerëve, fejesat me shkuesi dhe prishjet e tyre, martesat dhe divorcet, lidhjet e fshehta të dashurisë, grindjet e castit dhe fyerjet, borxhet, dëmet në pronat, uzurpimi i tokave në qytete nga lshvizja e pakontrolluar demografike, konfliktet mbi dyqanet dhe rrugët para tyre, konfliktet për shkaqe mosbindjesh ndaj prindërve, konfliktet për vjedhjet, përdëmtimet e pronave, nga rivaliteti në biznes, konfliktet për varret në qytete, konfliktet mbi shpronësimet, hasmëritë për vendimet e gjykatave, hasmëritë për vrasjet e trashëguara para dhe gjatë sistemit komunist, hasmëritë për vrasjet e reja, hasmëritë e vrasjet për nderin, hasmëritë për vrasjet për grabitje, hasmëritë për vrasjet aksidentale, hasmëritë për ndarjen e padrejtë të pronave, hasmëritë për dhunën e konfliktet brenda familjes, për grabitjet e shtëpive e të kopshteve, për grabitjet e dyqaneve, hasmëritë mbi trafikimin e femrave dhe të lëndëve narcotike, hasmëritë mbi borxhet e paslyera dhe humbjen e pasurisë në kazino etj. Vendimet e pleqësive "gjykatave kanonore" nuk janë kundërshtuar asnjëherë dhe palët jetojnë në paqe e vëllazëri ndërsa vendimet e gjykatave shtetërore në të gjitha rastet kanë thelluar konfliktin e hasmërinë mes palëve. Nga 600 000 vendime të gjykatave shtetërore palët kanë shkuar në hasmëri e gjakmarrje, duke sjellë pasojat tragjike me vrasjen e 3500 personave, vetëvrasjen e 4200 vetëve dhe kalimin në depresion të 22000 qytetarëve. Për shkak të vendimeve të padrejta e korrupsionit në të gjitha shkallët e prokurorive dhe gjykatave qytetarë ndjehen të terrorizuar e urrënjë sistemin e drejtësisë shtetërore dhe nuk kanë shpresë në përmirësimin e tij.

U kthye nga Anglia në Shqipëri, prokuroria merr në pyetje A. Xhabaftin

Atentati mafioz, zbardhet dinamika e vrasjes së ish-efektivit të policisë, Arben Bilali

50-vjeçari u qëllua me kallashnikov me silenciator, identifikohet automjeti i ekzekutorit që shkrepri 15 plumba

TIRANË

Një ditë pas ekzekutimit mafioz të ish-efektivit të policisë, Arben Bilali, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me këtë ngjarje të rëndë që ndodhi në zonën e Selitës dhe që tronditi banorët e kryeqytetit. Burime pranë grupit hetimor dje bënë me dije se dyshohet që atentatorët e kanë mbajtur nën vëzhgim prej kohësh 50-vjeçarin, i cili dilte shumë rrallë nga shtëpia, derisa gjetën momentin për ta eliminuar. Sipas hetuesve të çështjes, ish-policist kishte dalë nga banesa e tij trekatëshe disa orë para se ta qëllonin. Ai po kthehej në shtëpi me një automjet tip "Golf 4", ku po udhëtonin si pasagjer: Makina e tij është vënë në ndjekje nga dy atentatorët që udhëtonin me një automjet tip "Benz". Pas verifikimit të pamjeve filmike të kamerave të sigurisë, është konstatuar se viktima është ndjekur për afro 9 km që prej kryeqendrit të "Vasil Shantos" deri në rrugën "Daniel Ndreka", ku kishte shtëpinë. Ndërkaq, burime për "Top channel" kanë bërë me dije se është identifikuar automjeti i ekzekutorit dhe se është marrë në pyetje A. Xhabafti, i kthyer në Shqipëri së fundmi, sepse jeton në Angli.

DINAMIKA E VRASJES

Sipas burimeve të mësipërme, rruga drejt banesës së Arben Bilalit është njëkalimshme, çka iu ka mundësuar atentatorëve ta ndjekin atë pa rënë në sy. Rreth 50 m larg shtëpisë së tij, mjeti "Golf 4" i drejtuar nga djali i një shoku të Arbenit ka ndaluar që ky i fundit të zbrishte. Teksa makina është drejtuar në rrugën dytësore të autostradës Tiranë-Elbasan, një prej personave që ndodhej në automjetin tip "Benz" dhe që dyshohet se është vrasës me pagesë, ka hapur zjarr nga një distancë prej rreth 5 m drejt Arben Bilalit, i cili ka mbetur i plagosur rëndë dhe humbi jetën në spital për shkak të plagëve të marra në trup dhe në kokë. Po sipas burimeve policore, vrasja e 50-vjeçarit është kryer me një armë automatike (kallashnikov) e modifikuar me silenciator. Ndërkaq, mësohet se drejt ish-policist



50-vjeçari i vrasë, Arben Bilali



Vendi ku ndodhi atentati

DËSHMIA E XHABAFTIT

Prokuroria ka marrë në pyetje të enjten edhe A. Xhabaftin, i kthyer në Shqipëri së fundi sepse jeton në Angli. Shërbimi i Provës i ka kërkuar atij të paraqitet më 23 janar, sepse është i dënuar me punë në interes publik, për veprën e kundërshtimit të policisë. "Erdha në Shqipëri për këtë dënim, - ka thënë A. Xhabafti. - Nuk kam probleme dhe të ndjerin e kam parë vetëm një herë në vitin 1992. Ditën që ndodhi krimi isha për drekë me miqtë", raportohet të ketë thënë ai për hetuesit.

VRASJA E 3 VËLLEZËRVE BILALI

Seriali i vrasjeve në familjen Bilali ka nisur 22 vite më parë. Fillimisht ka qenë Bujar Bilali, i cili u ekzekutua në një atentat në vitin 1997. 13 vite më pas u plagos në një atentat, në një lokal pranë stadiumit "Selman Stërmasi" ish-policist Arben Bilali, i cili u mbijetoi plumbave. Pak muaj më pas, më 10 gusht të vitit 2010, u vra në një tjetër atentat Leonard Bilali, më i vogli i vëllezërve. Ky i fundit kishte vetëm pak ditë që ishte kthyer nga Italia ku qëndronte si emigrant, kur u qëllua për vdekje me 4 plumba në një nga lokalat, në rrugën "Irfan Tomini" në Tiranë.

HETIMET

Nga informacionet e siguruar nga "Top Channel", mësohet se automjeti tip "Benz", ngjyrë blu, kishte targa false AA 757 RV, të cilat në fakt rezultojnë t'i përkasin një mjeti "Fiat Punto", i vjedhur në Vlorë në vitin 2017. Hetuesit kanë mundur të sigurojnë dy dëshmi me interes për hetimin deri më tani. Njëri prej dëshmitarëve ka thënë se përpara disa ditëve i ka ndjekur një makinë, e atë ditë ishte duke udhëtuar me viktimitë. Gjithashtu, një tjetër shok i viktimitë ka thënë se një makinë i ka ndjekur ditët e fundit. Nga hetimet mësohet se viktima ka pasur një pistoletë me vete, por shokët e

tij ia kanë hequr në momentin që e larguan trupin e tij për në spital, për t'ia dorëzuar më pas policisë. Prokuroria ka marrë në pyetje të enjten edhe A. Xhabaftin, i kthyer në Shqipëri së fundi sepse jeton në Angli. Shërbimi i Provës i ka kërkuar atij të paraqitet më 23 janar, sepse është i dënuar me punë në interes publik, për veprën e kundërshtimit të policisë. "Erdha në Shqipëri për këtë dënim, - ka thënë A. Xhabafti. - Nuk kam probleme dhe të ndjerin e kam parë vetëm një herë në vitin 1992. Ditën që ndodhi krimi isha për drekë me miqtë", raportohet të ketë thënë ai për hetuesit. Madje, ai ka thënë para hetuesve se, edhe ku i ranë vëllanë i kishte dërguar lajm Bilalit se nuk e kishte nga ata, lajm të cilin e kishte dërguar me anë të shtetësit G.C.. Megjithatë, për krimin e një dite më parë, kamerat e sekuestruara në vendin e ngjarjes tregojnë të gjithë dinamikën. Viktima ishte duke zbritur nga makina, pasi kishte qenë me një shokun e tij për kafe, pranë Unazës së Re. Shkak për ngjarjen dyshohet të jetë hakmarrja e gjatë që ka familja Bilali me një organizatë kriminale në zonë. Fillimet e këtij konflikti datojnë në vitin 1997, kur u vra vëllai i Arbenit, Bujar Bilali. Vite më vonë, më 10 gusht të 2010-ës u vra edhe vëllai tjetër, Leonard Bilali (ish-mundës i ekipit Dinamo. Për vrasjen e Bilalëve nuk ka asnjë të dënuar, por zyrtarisht as Bilalët nuk janë fajësuar për ndonjë vrasje.

Përfituesit duhet të dorëzojnë në Agjencinë Trajtimit të Pronave tetë dokumente

Rreth 270 pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje do të përfitojnë kompensimin për pronën. Pronarët duhet të plotësojnë formularin-tip dhe ta dorëzojnë atë në Agjencinë e Trajtimit të Pronave. Subjekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së Tiranë kërkesën-tip, që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë ATP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit të përfutës, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka publikuar kartelën informative, ku të gjithë personat që presimin kompensimin mund të marrin informacion në lidhje me dokumentet që duhet të

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, 270 pronarët që marrin paratë

Përfituesit në Tiranë, Durrës, Vlorë e Elbasan

dorëzojnë, afatet dhe vlerën e kompensimit.

PRANIMI I KËRKESAVE

Procesi i regjistrimit apo pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së njoftimit publik. Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pran-

imin dhe shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës. Grupi i punës brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës kryen

verifikimet e duhura. Drejtori i përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës, nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi dhe urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen. Gjith-

ashtu, ai njofton edhe aplikantët që nuk përfshihen në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes.

DOKUMENTET

Subjekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së, Tiranë, kërkesën-tip që i vihet

në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit të përfutës, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Sipas ligjit, për dëshmitë e trashëgimitive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt notarial të sille certifikatë familjare e personit të cilin është lëshuar kjo dëshmi. Një tjetër dokument është prokurura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që fitojnë kompensim. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 lekë, paravarsisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

PRONARËT QË MARRIN PARATË

FLUTURA	RAMAZAN	PASKO	TIRANE	LILIANA	JETON	LIKU	TIRANE	INDRIT	RIFAT	MECJA	DURRES
AGRON	SHYQYRI	PEZA	ELBASAN	FATMIR	ABDULLA	BAUSHI	TIRANE	AGIM RUSHIT	TONUZI	DURRES	TIRANE
LUMTUR	RAMAZAN	MALAJ	TIRANE	LIJAN SULEJMAN	STRINGA	BAUSHI	ELBASAN	ABDYLL	HYSEN	KARROÇI	TIRANE
ARBEN	XHUVEL	RUKAJ	VLORE	FATMIRE	ALI	DOLLAKU	DURRES	LILJANA	LIJAN	AGAJ	TIRANE
LILIANA	JETON	LIKU	TIRANE	AISHE	HYSEN	PULLEJA	TIRANE	ARTAN	SHEFKI	KARROÇI	TIRANE
ALBERT	KUJTIM	MALO	VLORE	GEZIM	SEIT	CULLHAJ	TIRANE	RUKIJE	RASIM	DRIZA	TIRANE
HYSEN	IBRAHIM	NEZIRI	ELBASAN	YLLI MUHARREM	FERHAT	ELBASAN	TIRANE	KASTRIOT	FERIDUN	XHAFFERI	VLORE
NEVRRIJE	ALI	ZHUR	TIRANE	SHPRESA	REXHEP	REKICANI	TIRANE	RUKIJE	RASIM	DRIZA	TIRANE
MAJLINDA	LIJAN	DURO	VLORE	SHPRESA	REXHEP	KERCANI	TIRANE	ARTAN	SHEFKI	KARROÇI	TIRANE
EDMOND	CAKERRI	FATMIRA	VLORE	ZGJANI	ZIA	ZGJANI	VLORE	NAIM HAXHI	NDRUQI	TIRANE	TIRANE
LULJETA	NURI	IRMA ZIA	VLORE	LINKA	MEHMET	VLORE	ELBASAN	AFERDITA	HAMID	BERLIJU	TIRANE
ROZA ALUSH	RUZDIA	MEHMET	VLORE	HASKIJE	ZGJANI	GRADA	ELBASAN	NAIM HAXHI	YMERQI	TIRANE	TIRANE
MAMICA	XHUVEL	KARTERI	VLORE	ZGJANI	VLORE	ZGJANI	VLORE	AGIM QEREM	SEFERI	DURRES	DURRES
ALEKSANDER	XHUVEL	RUKAJ	VLORE	MUSTAFA	KAMER	BOGDANI	ELBASAN	ISMAIL	HYSEN	XHURA	TIRANE
KRENAR	HAJDAR	CAKERRI	VLORE	KAMER	KAMER	MERKO	ELBASAN	ISMAIL	HYSEN	XHURA	TIRANE
LULJETA	NURI	KARAFILI	VLORE	KAMER	KAMER	MERKO	ELBASAN	MIRAND	AGIM	FUGU	TIRANE
IKEN XHUVEL	LIJAN	IRMA ZIA	ELBASAN	KAMER	KAMER	MERKO	ELBASAN	SELMAN	SELMAN	ELEZI	TIRANE
ENDRI	RUZDIA	IRMA ZIA	ELBASAN	LINKA	LINKA	VLORE	VLORE	EQEREM	QAZIM	TUGU	TIRANE
BLERTA	NAIM	VASIL	ELBASAN	HARALLAMB	HARALLAMB	MARTOPULLO	DURRES	NJAZI	QAZIM	TUGU	TIRANE
DASHAMIR	MEHMET	QAMIL	ELBASAN	LULJA	LULJA	TIRANE	TIRANE	MYSTEHAK	FERIDUN	XHAFFERI	VLORE
MERRITA	MEHMET	NEVILA	ELBASAN	MULLAJ	MULLAJ	TIRANE	TIRANE	BASHKIM	ABDYLL	KARROÇI	TIRANE
REBI XHAVIT	TUTA	SEJDIN	ELBASAN	SEJDIN	SEJDIN	ELBASAN	ELBASAN	BESHNIK	FERIDUN	XHAFFERI	VLORE
XHAFFER	JASHAR	ASTRIT	TIRANE	ASTRIT	ASTRIT	SANXHAKTARI	ELBASAN	SAIMIR	KADRI	BIBA	TIRANE
LUKMAN	SHABAN	ASTRIT	TIRANE	ASTRIT	ASTRIT	SANXHAKTARI	ELBASAN	ABDYLL	ABDYLL	KARROÇI	TIRANE
BESHNIK	FATMIR	SEJDINI	TIRANE	SEJDINI	SEJDINI	ELBASAN	ELBASAN	HASHIR	SHAQIR	BLETA	DURRES
TAJAJ	ISMAIL	SEJDINI	TIRANE	SEJDINI	SEJDINI	ELBASAN	ELBASAN	DASHAMIR	ASLLAN	QELI	DURRES
FATJON	IRFAN	ASTRIT	TIRANE	ASTRIT	ASTRIT	SANXHAKTARI	ELBASAN	GJIROKASTER	BEQIR	FUGA	TIRANE
ADMIR	IDAJET	ASTRIT	TIRANE	ASTRIT	ASTRIT	SANXHAKTARI	ELBASAN	BEQIR	SHYQYRI	FUGA	TIRANE
BENAR	FATMIR	ASTRIT	TIRANE	ASTRIT	ASTRIT	SANXHAKTARI	ELBASAN	VELI SHABAN	LAMI	TIRANE	TIRANE
BESHNIK	HYSHI	ASTRIT	TIRANE	ASTRIT	ASTRIT	SANXHAKTARI	ELBASAN	MIRANDA	ZYBER	SHEKU	TIRANE
ABDULLA	ABDULLA	ASTRIT	TIRANE	ASTRIT	ASTRIT	SANXHAKTARI	ELBASAN	KADRRI	SHKURRI	DEBIRI	TIRANE
HYRIJE	ABDULLA	MAHMUDIE	TIRANE	MAHMUDIE	MAHMUDIE	DINGA	TIRANE	SERVETE	SEID	SHIMA	TIRANE
EVA MIT-HAT	METANI	VIOLICA	ELBASAN	MYZMIR	MYZMIR	SADA	TIRANE	LEDRI	GANI	KARROÇI	TIRANE
ARTUR	ANDON	ZADRINA	DURRES	ILIR MYZMIR	ILIR MYZMIR	SADA	TIRANE	ELISABETA	XHEMAL	BAJRAMI	ELBASAN
AHMET	SULEJMAN	KOKONOZI	TIRANE	DHURATA	DHURATA	RAMKAJ	TIRANE	LEDRI	GANI	KARROÇI	TIRANE
SABIA	ISMAIL	QAZIM	ELBASAN	ARBEJA	ARBEJA	ELBASAN	ELBASAN	MYRIJE	MYRIJE	PETRELA	TIRANE
NEXHMLIJE	MUHAMREM	LAËCJA	ELBASAN	SHKELQIM	XHEMAL	BURUSHI	ELBASAN	ISMAIL	HYSEN	XHURA	TIRANE
ARNALDO	RESUL	HAXHIRAJ	VLORE	TONUZI	TONUZI	DURRES	ELBASAN	ROLAND	PELLUMB	SHARRA	VLORE
ARBEN	BARSHYL	HAXHIRAJ	VLORE	BASHKIM	MEHMET	MECJA	DURRES	AJDLIJE	YMER	BISHA	TIRANE
ARBEN	ARDYLL	MIRAKU	ELBASAN	ISMAIL	HYSEN	XHURA	TIRANE	LEDRI	SHYQYRI	HYSKJA	ELBASAN
ALBION	SULEJMAN	ELBASAN	DURRES	BLENDI	RRAP	KUBURI	TIRANE	ILIR REFIK	CULLHAJ	TIRANE	TIRANE
ALBION	SULEJMAN	INGRID	DURRES	KOL	TRAJANI	TRAJANI	ELBASAN	NINFA	SKENDER	ZIU	VLORE
ALBION	SULEJMAN	HARASANI	DURRES	YLLI MUSTAFA	HARASANI	TRAJANI	TIRANE	BESHNIK	OSMAN	YMERAJ	TIRANE
ALBION	SULEJMAN	MEREME	DURRES	MEREME	EDMOND	KASHI	TIRANE	BUJAJ	QERIM	DEMNERI	TIRANE
ALBION	SULEJMAN	DIANA	DURRES	DIANA	BASHKIM	HARASANI	TIRANE	OSMAN	OSMAN	DEMNERI	TIRANE
ALBION	SULEJMAN	ZENEL	DURRES	MIT-HAT	ZENEL	SINOUJERI	TIRANE	ILIR QERIM	ALLUSHI	TIRANE	TIRANE
KASIM	MUSTAFA	DASHAMIR	DURRES	DASHAMIR	SELMAN	HIDAJ	TIRANE	HIQMET	ABDYRRAHMAN	KADRI	TIRANE
MEVLUDE	HASAN	GEÇI	ELBASAN	GEÇI	PELLUMB	KONDO	TIRANE	DASHAMIR	ALI	TOSKA	TIRANE
MEVLUDE	HASAN	DIMCE	ELBASAN	NAUM	ELBASAN	MARKU	TIRANE	ALI	ALI	TOSKA	TIRANE
ARBË DASHAMIR	AGALLIU	ARBEN	ELBASAN	ARBEN	VATUKA	MEJAJ	DURRES	GEZIM	HYSEN	GRORI	TIRANE
PELLUMB	MURAT	FEJZI	TIRANE	FEJZI	VATUKA	TIRANE	DURRES	FATIME	BEDRI	MANSAKU	TIRANE
ZINAIDA	NASI	HOXHA	TIRANE	HOXHA	VATUKA	FIER	TIRANE	NADA	ALI	SKIKULI	ELBASAN
PELLUMB	MURAT	HOXHA	TIRANE	HOXHA	VATUKA	FIER	TIRANE	FATMIR	BESHIM	MURTHI	TIRANE
FRIZUE	TASIM	DERVISH	TIRANE	DERVISH	ABAZI	ABAZI	TIRANE	FATMIR	BESHIM	MURTHI	TIRANE
ILIR JONUZ	LLACI	YMER	ELBASAN	YMER	NOSI	NOSI	TIRANE	JEMINE	MEHMET	KORÇA	TIRANE
VALBONA	BEKHET	HAXHI	TIRANE	HAXHI	CULLHAJ	CULLHAJ	TIRANE	FIGURETE	HIDER	MURTHI	TIRANE
FLUTURA	HAKIK	SELM	ELBASAN	SELM	HOXHA	HOXHA	TIRANE	MERRITA	PETRIT	KARAJ	ELBASAN
MIMOZA	RAMAZAN	XHEMILE	TIRANE	XHEMILE	MALIQ	MALIQ	TIRANE	ZYHDI	MEHMET	SARACI	TIRANE
HAMIT	SYMIR	VELI SELIM	TIRANE	VELI SELIM	ABAZI	ABAZI	TIRANE	IBRAHIM	ALI	TOSKA	TIRANE
JULJAN	SEFJAN	MUSA	ELBASAN	MUSA	HAXHI	HAXHI	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
JULJAN	SEFJAN	HARIZ	ELBASAN	HARIZ	HAXHI	HAXHI	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ANDI YLLI	RESULI	OSMAN	ELBASAN	OSMAN	PASHA	PASHA	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
KOSTA	JONUZ	PASHA	TIRANE	PASHA	ABDYLL	BAKALLI	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
SKENDER	GAMIL	KUJTIM	TIRANE	KUJTIM	ABDYLL	BAKALLI	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
SKENDER	GAMIL	ILJAZMAKSUT	TIRANE	ILJAZMAKSUT	RAUPI	RAUPI	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ARBË DASHAMIR	AGALLIU	HATIXHE	TIRANE	HATIXHE	SELM	SELM	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ROBERT	ADEM	SHEFQET	TIRANE	SHEFQET	HOXHA	HOXHA	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ERVIN	NJAZI	MIRELA	KORCE	MIRELA	MECJA	MECJA	DURRES	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ERVIN	NJAZI	ERVIN	TIRANE	ERVIN	FATBARDH	FATBARDH	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ERVIN	NJAZI	LIRIJE	TIRANE	LIRIJE	MEHMET	MEHMET	DURRES	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
RAMIE	ADEM	BASHKIM	TIRANE	BASHKIM	MEHMET	MEHMET	DURRES	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
THIMJO	GJK	AGRON	DURRES	AGRON	TEKI	TEKI	DURRES	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ARBEN	XHEMAL	ARTUR	DURRES	ARTUR	TAHSIM	TAHSIM	DURRES	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
NATASHA	SEFER	NAUM	DURRES	NAUM	AGIM	AGIM	DURRES	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
KASTRIOT	SEFER	DIMCE	TIRANE	DIMCE	NAUM	NAUM	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
MIMOZA	PETRIT	SHEFQET	TIRANE	SHEFQET	NAUM	NAUM	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ELDA	SEFEDIN	SEFQET	ELBASAN	SEFQET	NAUM	NAUM	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ELIDA	SEFEDIN	SEFQET	ELBASAN	SEFQET	NAUM	NAUM	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ELIDA	SEFEDIN	SEFQET	ELBASAN	SEFQET	NAUM	NAUM	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
HENRIETA	SEFEDIN	SEFQET	ELBASAN	SEFQET	NAUM	NAUM	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ENGJELIUSHE	SEFEDIN	SEFQET	ELBASAN	SEFQET	NAUM	NAUM	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
HENRIETA	SEFEDIN	SEFQET	ELBASAN	SEFQET	NAUM	NAUM	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ENGJELIUSHE	SEFEDIN	SEFQET	ELBASAN	SEFQET	NAUM	NAUM	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ARIAN	ASTRIT	KADILLI	ELBASAN	KADILLI	NAUM	NAUM	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE
ARIAN	ASTRIT	KADILLI	ELBASAN	KADILLI	NAUM	NAUM	TIRANE	OLTTON	REFIK	HASALLU	TIRANE

Paga minimale, mujore në BE nga 600 euro deri 1 400 euro

Eurostat: Shqipëria, me pagën minimale më të ulët në Europë

Paga minimale mujore në Shqipëri është më ulëta në të gjithë Europën. Punonjësit shqiptarë deri në fund të vitit 2018 paguheshin minimalisht me 210 euro në muaj, që është më e ulëta në Europë. Sipas një studimi të Eurostat, mësohet se paga minimale në Shqipëri arrin deri në 210 euro, ndërkohë që paga minimale mujore në vendet e BE-së është nën 600 euro në lindje dhe mbi 1 400 euro në veriperëndim. Ndonëse në rritje vit pas viti, paga minimale e punonjësve shqiptarë mbetet sërisht më e ulëta. Në Serbi ajo është 308 euro. Mungojnë të dhënat për Maqedoninë dhe Malin

e Zi. Për Maqedoninë, por sipas të dhënave nga Ministria e Punës dhe Politikave Sociale të Maqedonisë, paga më e ulët bruto është 17,370.00 MKD (rreth 282,00 euro). Edhe për Malin e Zi, sipas burimeve zyrtare, paga minimale është rreth 288 euro, duke e bërë Shqipërinë vendin me paga më të ulët për shtetasat vulnerabil. Sipas njoftimit të Eurostat, që nga 1 janari 2019, 22 nga 28 vendet anëtare të Bashkimit

Evropian (BE) kanë paga minimale kombëtare vetëm Danimarka, Italia, Qiproja, Austria, Finlanda dhe Suedia nuk kanë një pagë minimale. 22 shtetet anëtare të BE-së që kanë paga minimale kombëtare mund të ndahen në tri grupe kryesore bazuar në nivelin në euro. Në janar 2019, Bullgaria kishte pagën minimale më të ulët, përkatësisht 286 euro, nga të gjitha shtetet e BE-së. Nëntë shtete anëtare, të gjitha të vendosura

ra në lindje të BE-së, ndiqnin Bullgarinë me paga minimale midis 400 dhe 600 euro në muaj, përkatësisht: Letonia (430 euro), Rumania (446 euro), Hungaria (464 euro), Kroacia (506 euro), Çekia (519 euro), Sllovakia (520 euro), Polonia (523 euro), Estonia (540 euro) dhe Lituania (555 euro). Në pesë shtete të tjera anëtare, të vendosura në jug të BE-së, pagat minimale shkonin në mes 650 dhe pak më shumë se 1 000 euro në muaj:



Greqia (684 euro), Portugalia (700 euro), Malta (762 euro), Sllovenia (887 euro) dhe Spanja (1,050 euro). Në shtatë vendet e tjera anëtare, të gjitha të vendosura në perëndim dhe në veri të BE, pagat minimale ishin mbi 1 450 euro në muaj: Britania e Madhe (1 453 euro), Franca (1 521 euro), Gjermania (1 557 euro), Belgjikë (1 594 euro), Holanda (1 616 euro), Irlanda (1 656 euro) dhe Luksemburgu (2 071 euro). Për krahasim, paga minimale federale në Shtetet e Bashkuara ishte 1 098 euro në muaj në janar 2019.

Anulohet tenderi për ndërtimin e segmentit sheshi "Shqiponja"-Pallati me Shigjeta

Unaza e Madhe/ Qato: Ofertat u skualifikuan, nuk plotësonin kriteret

Operatorët u njoftuan nga ARRSH-ja

Dr. rejtuesja e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Sonila Qato, deklaroi anulimin e tenderit për ndërtimin e segmentit të Unazës së Madhe, sheshi "Shqiponja"-Pallati me Shigjeta". Në daljen për mediat, Qato tha se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar çdo ofertë të paraqitur, duke i konsideruar se nuk ishin në përputhje me kërkesat. "Ofertuesit janë të drejtën e ankimit", tha Qato ndërsa konfirmoi se projekti i Unazës së Madhe mbetet projekt prioritar për kryeqytetin. "Komisioni i Vlerësimit të Ofertave u ka ofruar të gjitha kompanive skualifikimin e ofertave të paraqitura, pasi nuk plotësojnë kriteret. Sot do i paraqes ministres Baluku një proces transparent. Kompanitë janë partnere të ARRSH dhe dialogu dhe transparenca do jetë parësore. Kompanitë kanë të drejtën të animojnë. Në lotët e tjera të projektit do vijojnë punimet dhe shpronësimet, pasi ky projekt do të realizohet", - tha Qato.




Dr. rejtuesja e Autoritetit Rrugor Shqiptar Sonila Qato

tojtë lotin prej 18 milionë euro të tenderit për rindërtimin e Unazës së Madhe, duke krijuar imazhin e rremë se kjo është një kompani 20-vjeçare dhe me eksperiencë në projektet e infrastrukturës. E vërteta është se kjo kompani është themeluar në 25 qershor 2018, vetëm dy muaj përpara zhvillimit të tenderit.

Kompanitë Në 14 janar, Autoriteti Rrugor Shqiptar publikoi listën e kompanive garuese për ndërtimin e lotit të parë të Unazës së Madhe, pas anulimit të procedurës së mëparshme për shkak të dokumentacionit të falsifikuar nga kompania që kishte fituar më parë tenderin. Pas skadimit të këtij afati, Autoriteti Rrugor Shqiptar bën me dije se kanë dorëzuar oferta 6 operatorë, ose bashkime operatorësh ekonomik.


shpronësimet, pasi ky projekt do të realizohet", - tha Qato. Kujtojmë se pas zbulimit të skandalit nga emisioni "Të Paekspozuarit", në "News 24", ARRSH pezulloi ndërtimin në lotin e parë tek Unaza e Re. Ky falsifikim e ka ndihmuar kompaninë "Dunëll Haberman", të fi-



Reshjet/ARRSH: Akset ku duhet të qarkullohet me zinxhirë

Në të gjithë vendin gjatë ditës së sotme priten reshje. Autoriteti Rrugor Shqiptar njofton se të gjithë kontraktorët për mirëmbajtjen e rrugëve kanë qenë dhe janë në gatishmëri për t'iu përgjigjur problematikave që mund të vijnë. Ndërkohë, Autoriteti Rrugor Shqiptar bën të ditur se cila është situata e akseve rrugore. Referuar ARRSH, në rajonin jugor Gjirokastër: Në Qarkun e Korçës, rreth orës 4 të mëngjesit të ditës së djeshme kanë filluar reshje bore me intensitet. Trashësia e borës shkon 5-15 cm. Po punohet pa ndërprerje nga kontraktorët e mirëmbajtjes për pastrimin e akseve. Në qarkun Gjirokastër, qarkullimi kryhet normalisht në të gjitha akset. Vetëm në pjesën fundore të rrugës Erind-Çajup, rreth 5 km, rekomandohet përdorimi i zinxhirëve. Në qarkun e Korçës qarkullohet me zinxhirë në: K.Boboshticë-Dardhë, Voskopojë-Voskopojë, Qafë Qarri-Ersekë, zona e Qafës së Qarrit. Në rajonin qendror, Tiranë: Ka reshje shiu në të gjithë Rajonin. Në lartësi ka pasur reshje bore, si në Sarisalltik, Qafë Priskë, Gjinar, Steblevë. Rekomandohet përdorimi i zinxhirëve vetëm në pjesën fundore të rrugës Krujë-Sarisalltik. Në rajonin verior Shkodër: Gjatë natës ka pasur reshje shiu në të gjithë rajonin dhe në lartësi ka pasur reshje bore. Kontraktorët kanë vazhduar punën për pastrimin e akseve dhe po mbajnë në monitorim të vazhdueshëm segmentet, ku ka prezencë ngricash. ARRSH rekomandon përdoruesit e rrugës, që të bëjnë kujdes në lëvizje, sidomos gjatë orëve të para të mëngjesit dhe gjatë natës për shkak të lagështisë në rrugë, të respektojnë sinjalistikën dhe udhëzimet e Policisë Rrugore.

Anketa/ Rreth 60% e shqiptarëve, pa sigurime



Më shumë se gjysma e qytetarëve shqiptarë nuk kanë asnjë formë të sigurimit shëndetësor. Sipas anketës së bërë nga INSTAT dhe ISHP, konkretisht 62% e femrave dhe 64% e meshkujve raportojnë se nuk kanë asnjë lloj sigurim shëndetësor. Në mesin e grave 15-49 vjeç, 32% janë të mbuluara nga sigurimi shëndetësor shtetëror dhe 14% janë të mbuluara nga programi i sigurimeve shoqërore. Mes meshkujve në të njëjtën moshë mbulimi është më i ulët, konkretisht: 29% mbulohen nga fondet shtetërore dhe 9% nga programi i sigurimeve shoqërore. Ekzistojnë dallime të mëdha gjeografike në mbulimin e sigurime shëndetësore midis meshkujve dhe femrave. Kështu, vetëm 13% e burrave dhe grave në prefekturën e Kukësit mbulohen nga sigurimet shëndetësore shtetërore, ose nga kontributet shoqërore e shëndetësore, ndërsa në Tiranë 68% e grave dhe 50% e meshkujve gëzojnë mbulim të tillë shëndetësor. Sigurimi shëndetësor i sponsorizuar nga shteti përcaktohet fuqishëm nga arsimit dhe të ardhurat. Vetëm 17% e meshkujve dhe femrave me arsim fillor 4-vjeçar ose më pak janë të siguruar; krahasuar me 84% të grave dhe 69% të meshkujve me universitet ose arsim pasuniversitar.

LOTARIA AMERIKANE FAZAT

Departamenti Amerikan i Shtetit: Kujdes, ja rastet kur kandidatët skualifikohen

Lotaria Amerikane, si të verifikoni nëse jeni fitues, hapat e mëtejshëm Dokumentacioni që nevojitet para intervistës

Të gjithë ata që kanë aplikuar për lotarinë amerikane, tashmë kanë mundësinë të njihen me dokumentacionin që duhet të dorëzojnë nëpërmjet adresës elektronike. Ambasada Amerikane në Tiranë, ditën e djeshme, ka bërë një njoftim për të gjithë të interesuarit në faqen e saj zyrtare. "Jeni i përzgjedhur i programit të Lotarisë DV2019? KCC do t'ju kërkojë t'i dërgoni me email një listë të dokumenteve tuaja", thekson ambasada.

PËRZGJEDHJA

Anëtarët e përzgjedhur inkurajohen që të plotësojnë aplikacionin online DS-260 menjëherë për të caktuar një takim interviste në ambasadën ose konsullatën e duhur të SHBA. "Nëse merrni njoftim përmes faqes elektronike të vizës së diversitetit elektronik (E-DV) që ju jeni përzgjedhur për fazat e mëtejshme në programin e vizave të emigrantëve të diversitetit (DV), duhet të përfundoni me sukses hapat në faqet në vijim përpara se të planifikoni një intervistë konsullore për të përcaktuar nëse do të merrni një vizë. Ju duhet të plotësoni këto hapa sa më shpejt të jetë e mundur", bën me dije Departamenti Amerikan i Shtetit. Më tej ky i fundit nënvizon se nëse aplikanti merr njoftim nëpërmjet faqes së internetit të E-DV-së se është përzgjedhur për më tej në Programin e DV-së dhe është fizikisht i pranishëm në Shtetet e Bashkuara, mund të ketë të drejtë të përshtatë statusin për të marrë qëndrim të përhershëm përmes Programit të DV-së. Ndërkohë përzgjedhja nëpërmjet lotarisë, nuk garanton sigurimin e vizës, pasi duhen kaluar edhe fazat e tjera. Për të marrë një DV për të emigruar në Shtetet e Bashkuara, zgjedhësit duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e përshtatshme sipas ligjit të SHBA. Pjesëmarrësit në programin e diversitetit Visa 2020 mund të kontrollojnë statusin e hyrjeve të tyre në faqen e internetit të E-DV nga 7 maj 2019 deri më 30 shtator 2020.

KONFIRMIMI I KUALIFIKIMEVE

Programi i Diversitetit të Vizave Emigruese (DV) kërkon që aplikanti kryesor i DV të ketë një arsim të mesëm, ose ekuivalentin e tij, ose dy vjet përvojë pune kualifikuese siç



KRITERET

"Nëse nuk keni arsimin e kërkuar ose përvoja kualifikuese në punë, nuk jeni të kualifikuar për t'u lëshuar një vizë diversiteti. Ju nuk duhet të vazhdoni me aplikimin tuaj të DV nëse nuk plotësoni kërkesat e kualifikimit ose të përvojës për punë. Ju nuk do të lëshohet vizë, dhe çdo pagesë që ju paguani nuk do të kthehet", bën me dije Departamenti Amerikan i Shtetit.

përcaktohet me dispozitat e ligjit të SHBA. "Nëse nuk keni arsimin e kërkuar ose përvoja kualifikuese në punë, nuk jeni të kualifikuar për t'u lëshuar një vizë diversiteti. (Vetëm ju, si aplikanti kryesor, duhet të përmbushni këtë kërkesë. Bashkëshorti juaj dhe fëmijët nuk duhet të plotësojnë këtë kërkesë.) Ju nuk duhet të vazhdoni me aplikimin tuaj të DV nëse nuk plotësoni kërkesat e kualifikimit ose të përvojës për punë. Ju nuk do të lëshohet vizë, dhe çdo pagesë që ju paguani nuk do të kthehet", bën me dije departamenti amerikan i shtetit. Kualifikimi nënkupton përfundimin e shkollës së mesme, pra kryerjen me sukses të një kursi formal të arsimit fillor dhe të mesëm i krahasueshëm me përfundimin e kursit 12-vjeçar në Shtetet e Bashkuara. Nëse aplikanti do të përzgjidhet në

bazë të përvojës së punës ai duhet të ketë dy vjet përvojë në pesë vitet e fundit, në një profesion, i cili sipas përkufizimeve të Departamentit të Punës së SHBA kërkon të paktën dy vjet trajnim ose përvojë të caktuar si Job Zona 4 ose 5, e klasifikuar në një Vlerësim të Përgatitur Profesional (SVP) prej 7,0 ose më lartë. "Përsëri, ju nuk duhet të vazhdoni me aplikimin tuaj të DV nëse nuk plotësoni kërkesat e kualifikimit ose të përvojës së punës të shpjeguara më sipër. Ju nuk do të lëshohet vizë, dhe çdo pagesë që ju paguani nuk do të kthehet", thekson Departamenti Amerikan i Shtetit.

FORMULARI DS-260

Aplikanti kryesor dhe të gjithë anëtarët e familjes që aplikojnë për një vizë diversiteti në programin DV-2019 duhet të plotësojnë Formu-

larin DS-260. Ata duhet të shkruajnë numrin e rastit të DV në formularin online të DS-260 për të aksesuar dhe përditësuar informacionin për veten dhe familjen që kanë përfshirë në regjistrimin e tyre të DV. "Nëse do të kishit një bashkëshort ose fëmijë para se të paraqitni hyrjen tuaj origjinale, por nuk i keni përfshirë ato në formën origjinale të hyrjes, atëherë rasti juaj do të diskualifikohet në kohën e intervistës tuaj për vizë. As ju, as ndonjë nga anëtarët e familjes tuaj nuk do të merrni vizë. Për më shumë informacion, shihni Udhëzimet e DV", bën me dije ambasada. Pas dorëzimit të Formularit DS-260 në internet, aplikantët duhet të hapin faqen e konfirmimit. Aplikanti dhe secili anëtar i familjes që do të shoqërojë aplikantin në Shtetet e Bashkuara do të duhet të dorëzojë kopjet e skanuara dhe çdo përkthim të kërkuar të dokumenteve origjinale ose kopjeve të vërtetuara të dokumenteve të listuara më poshtë nga një zyre, autoritet ose subjekt lëshues i duhur në vendin e origjinës. "KCC do të dërgojë instruksione që shpjegojnë se si të skanoni dhe dërgoni email dokumentet dhe përkthimet e kërkuara pasi të keni dorëzuar një aplikim të vlefshëm DS-260 për ju dhe për të gjithë anëtarët e tjerë të familjes. Data juaj e intervistës për vizë nuk do të caktohet derisa KCC të ketë pranuar dhe rishikuar të gjitha dokumentet e nevojshme mbështetëse. Ju do të merrni dokumentet origjinale me vete në intervistën tuaj në një ambasadë ose konsullatë të SHBA. Mos dërgoni asnjë nga këto dokumente në Qendërën Konsullore Kentucky. Të gjitha dokumentet ose korrespondenca e postuar në OEk do të shkatërrohen", thekson Departamenti Amerikan i Shtetit.

DOKUMENTACIONI

- > **Certifikata duhet të përmbajë:**
 - Data e lindjes së personit;
 - Vendi i lindjes së personit;
 - Emrat e të dy prindërve;
 - > **Certifikatat e papërfillshme të lindjes në rastet kur:**
 - Lindja e aplikantit nuk u regjistrua zyrtarisht.
 - Të dhënat e lindjes së aplikantit janë shkatërruar.
 - Autoriteti përkatës qeveritar nuk do të lëshojë një.
 - Në këto raste, ju lutemi të m'errni një deklaratë të vërtetuar nga autoriteti përkatës qeveritar duke deklaruar arsyen se nuk është i disponueshëm rekordi i lindjes së aplikantit. Me deklaratën e vërtetuar aplikanti duhet të paraqesë dëshmi sekondare.
 - Një dekret adoptimi për një fëmijë të adoptuar.
 - Një deklaratë nga një i afërt, mundësisht nëna, duke treguar datën dhe vendin e lindjes, emrat e të dy prindërve dhe emri i vajzërisë së nënës.
 - > **Të dënuarit**
 - Aplikantët, të cilët kanë qenë të dënuar për një krim duhet të dorëzojnë një kopje të vërtetuar të çdo procesverballi gjykimi dhe çdo regjistri burgu, pavarësisht faktit se ai ose ajo mund të ketë përfutur më pas nga një amnistie, fajje ose ndonjë akt tjetër i mëshirës.
 - > **Të dhënat e gjatës duhet të përfshijnë:**
 - Informata të plota lidhur me rrethanat që rrethojnë krimin për të cilin kërkuesi ishte dënuar
 - Disponimi i çështjes, duke përfshirë dënimin ose dënimin tjetër ose gjobën e shqiptuar.
 - Personat që kanë shërbyer në forcat ushtarake të çdo vendi duhet të dorëzojnë një kopje të procesverballit të tyre ushtarak.
 - > **Cilët aplikantë duhet të dorëzojnë certifikatën e policisë**
 - Çdo aplikant i moshës 16 vjeç ose më shumë duhet të paraqesë të gjitha certifikatat e kërkuara të policisë.
 - Çfarë bën Parashtruesi i Kërkesës
 - Aplikuesit duhet të paraqesë certifikatat e policisë që plotësojnë udhëzimet e mëposhtme.
 - **Certifikata e policisë duhet:**
 - Mbulojë gjithë periudhën e banimit të aplikantit në atë zonë.
 - Lëshohet nga autoriteti përkatës policor.
 - Përfshini të gjitha arrestimet, arsyen e arrestimit (arrestimeve), dhe disponimin e secilit rast prej të cilit ka një regjistër.
- Përcaktimi nga cilat vende kërkuesi kërkohet të marrë certifikatat e policisë. Tabela më poshtë do të ndihmojë në përcaktimin nga ku një aplikant duhet të marrë certifikatat e policisë. Shënim: Prindërit dhe ish banorët e Shteteve të Bashkuara nuk duhet të marrin certifikatat e policisë që mbulojnë vendbanimin e tyre në Shtetet e Bashkuara. Kontaktoni autoritetet e duhura policore. Përzgjedhja e vendit të duhur nga faqja e reciprocitetit sipas vendeve do t'ju ofrojë informacion shtesë se si të merrni një certifikatë policie.
- NJOFTIMI I RËNDËSISHËM PËR CERTIFIKATAT E POLICISË:**
- Faqet e reciprocitetit nga vendi do të tregojnë nëse autoritetet e policisë së një vendi kërkojnë dorëzimin e një formulari të posaçëm të Kërkesës së Certifikatës së Policisë. Disa vende mund të kërkojnë paraqitjen e formularëve të veçantë të Kërkesës së Certifikatave të Policisë për të kërkuar dhe marrë të gjitha certifikatat e Policisë së zbatueshme. Certifikatat e policisë nga disa vende nuk janë të disponueshme. Informata më specifike mund të gjenden në internet në web faqen tonë të reciprocitetit nga vendi.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoa, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 25.02.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shpëtim e pasurisë së paluajtshme, Arë me sip.1,500 m² me nr. 179/87, vol. 8, fq. 19 zk. 2326, në Kuman, Fier në pronësi të Z. Arben Refat Ramizi me vlerë fillestare në ankand 378,000 (Treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë. **Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoa, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 27.02.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shpëtim e pasurisë së paluajtshme. Trull me sipërfaqe totale 112 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Durres me Nr.pasurie 16116, Vol.6, Fq.122, Zk.8516 në pronësi të Shoqëria "ADBRATKA BËTOW" Sh.P.K., me adresë Durres, me vlerë fillestare në ankand 7,338.6 (Shtatë mijë e treqind e tetë pikë gjashtë) EURO. Dhe Pasuri e paluajtshme. Trull me sipërfaqe totale 1260 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Durres me Nr.pasurie 161235, Vol.7, Fq.236, Zk.8516 në pronësi të Shoqëria "ADBRATKA BËTOW" Sh.P.K., me adresë Durres, me vlerë fillestare në ankand 82,555 (Tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) EURO. **Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoa, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 01.03.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I-rë për shpëtim e pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr 5/229 / ZK. 8250, me sipërfaqe 137 m² me adresë Tiranë, në pronësi Z.Bujar Musa Kajazi me vlerë fillestare në ankand 98,800 (Nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) EURO. **Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 4 22 31 888.**

"Nëse është vrarë vërtet im vëlla, Kreshniku, të gjendet trupi"

E masakroi shoku me çekiç në kokë, vëllai i viktimës: Kemi dyshime të reja

Donjet Beqiraj: S'është bërë analiza e AND-së

FIER

Ndonëse kanë kaluar afro 2 vjet nga vrasja e 36-vjeçarit Kreshnik Beqiraj në Fier, vëllai i tij nuk rresht së kërkuari zbardhjen e plotë të ngjarjes. Donjet Beqiraj ka telefonuar në "News 24" duke kërkuar të flasë mbi faktet që ka për vrasjen e të vëllait. Përmes një lidhjeje me "Skype", ai ka shprehur dyshimet se vëllai i tij nuk është vrarë nga një person i vetëm, por në bashkëpunim. Vëllai i 36-vjeçarit Kreshnik Beqiraj, pretendon gjithashtu se trupi i gjetur dy vjet më parë në një valixhe të hedhur në kanal pranë fshatit Daullas nuk është i vëllait të tij, pasi analiza e AND-së nuk e ka përcaktuar. "Pas afatit kohor që ka kaluar dhe në këtë drejtim që ka marrë çështja, bëhet fjalë që personi i akuzuar është bashkëpunëtor. Është folur se është gjetur një trup i copëtuar, vrarë në mënyrë makabre, por familjes nuk i janë paraqitur prova. I bëj apel familjes së të arrestuarit që të bashkëpunojë të zbardhet e vërteta dhe të mos vazhdojë kjo torturë në këtë gradë. Ndërkohë që nga shteti shqiptar nuk po marrim asnjë përgjigje", është shprehur vëllai i viktimës. Ndërkaq, Donjet Beqiraj tha se, "familjarët akoma nuk kanë marrë asnjë përgjigje apo provë



Donjet Beqiraj, duke folur për "News 24" dhe "GSH"



Viktima Kreshnik Beqiraj



I arrestuari për vrasjen, Albert Zekaj

konkrete përsa i përket Kreshnik Beqirajt, vëllait tim dhe pas lutjeve që u kemi bërë autoriteteve më të larta shqiptare, sidomos Prokurorisë së Përgjithshme, kemi marrë një përgjigje. Kurse familjarët nuk kanë marrë asnjë informacion apo përgjigje nga

Prokuroria e Fierit që në qoftë se ka vdekur vërtet vëllai im, të dimë se ku është trupi, pasi analiza e AND-së nuk është bërë".

VRASJA

Kreshnik Beqiraj u vra në qershor të vitit 2017 nga shoku i tij, Albert Zeka. Ky i

fundit pasi e masakroi me çekiç, e vendosi trupin në një valixhe dhe e hodhi në një kanal pranë fshatit Daullas në Fier. Motivi i ngjarjes mendohet të ketë qenë mosshlyerja e detyrimeve të qirasë nga Albert Zeka, gjë për të cilën Kreshnik Beqiraj i kishte

kërkuar të largohej nga banesa, të cilën e ndanin prej 2 vitesh në Fier. Por pavarësisht pretendimeve të Donjetit, në atë kohë policia dhe prokuroria pohuan se kanë arritur të zbardhnin vrasjen e 36-vjeçarit Kreshnik Beqiraj nga Fieri si edhe të zbulojnë

autorin e kësaj ngjarjeje makabre, Albert Zekajn nga Kopluku i Shkodrës. Pas disa muaj hetimesh, Zekaj pranoi krimin dhe rrefeu para hetuesve se mbremjen e 22 qershorit të vitit të kaluar, kur ishte kthyer në shtëpi kishte qëlluar me çekiç në kokë Kreshnikun.

Sekuestrohen 5 kg heroinë në Tiranë, përfundojnë në pranga 4 persona

DURRËS - Policia e Durrësit ka goditur një grup që trafikonte droga të forta, ndërsa ka vënë në pranga 4 persona. Në kuadër të operacionit të koduar "Vollga" janë sekuestruar 5 kg të dysuar heroinë, një sasi monetare, 3 automjete e disa telefona. Sipas bluve, janë arrestuar në flagrancë shtetasit: B.D., A.T dhe N.M. si dhe është ekzekutuar urdhri i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për ndalimin e shtetasit A.R. "Specialistët për Hetimin e Narkotikëve në DVP Durrës, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale në PSH, pas ndjekjes dhe mbajtjes nën vëzhgim, kapën në flagrancë në Tiranë 3 shtetasit me rreth 5 kg të dysuar heroinë, si dhe sasi monetare, 3 automjete e disa telefona. Vijon puna për dokumentimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet kriminal. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprime të mëtejshme për veprën penale 'Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kryer në bashkëpunim', thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë së qytetit bregdetar.

This project is funded by the European Union

Terre des hommes

Albanian National Training and Technical Assistance Resource Center

2ND ROUND CALL FOR PROPOSALS

Terre des hommes Albania (Tdh) in partnership with the Albanian National Training and Technical Assistance Resource Centre (ANTTARC) are jointly implementing the project: **"Strengthening Civil Society to Prevent and Protect Children from Abuse and Violence in Albania"**, financed by the European Union.

The overall objective of this EU project funded under the European Instrument for Democracy and Human Rights is:

- Strengthen child rights civil society organizations (CSOs) capacities and their role in child protection and family strengthening through structured capacity building programmes and technical assistance.
- Empower child rights CSOs to be drivers of change through development and advocacy of child protection and family strengthening models and good practices through a sub-grants scheme, networking, establishing a network of CSO trainers, monitoring and advocacy.

In this framework the 2nd Round of Call for Proposal under the Sub-Granting Scheme is publicized and effective **January 7th, 2019** until **February 7th, 2019**.

The overall amount made available under this Call for Proposals is **98,000 EUR**. Tdh Albania aims to award around **7 (seven)** projects, which must fall between the following minimum and maximum amounts:

- Medium size sub-grants (10,000 -14,000 EUR) (up to 7);

The deadline for the submission of applications is **February 7th, 2019** at **17:00 hrs**.

The application package and related information must be found to the following links: www.childhub.org; www.tdh.ch; www.eeas.europa.eu/delegations/albania; www.anttarc.org; Terre des hommes Albania and Terre des hommes Europe Facebook profiles.

Arrestohet drejtori i ARM, Kreshnik Lilaj, përplasi me makinë 10 mjete të parkuara

VLORE - Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit në Vlorë, Kreshnik Lilaj është arrestuar nga policia, pasi ka shkakuar një aksident të frikshëm duke përplasar 11 makina të parkuara. Mësohet se 31-vjeçari Lilaj ishte në gjendje të dehur. Ngjarja që i ngjan si një sekuenca filmi ka ndodhur në rrugën Transballkanike. Automjeti tip "Benz" me targa AA 272 RB që drejtohej nga Kreshnik Lilaj ka humbur kontrollin duke dalë nga rruga. Kamerat e sigurisë së objekteve aty pranë kanë filmuar momentin kur makina fluturon në ajër dhe rrotullohet disa herë duke marrë para 10 mjete të parkuara në zonë. Bilanci mund të ishte fatal, por në fakt i vetmi i dëmtuar është drejtuesi i mjetit, i cili ka përfunduar në spital. Fatmirësisht pas dhënies së ndihmës së parë mjekësore, Lilaj ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Sipas policisë, makina e 31-vjeçarit është shkatërruar totalisht, ndërsa ai ka shpëtuar prej mrekulli. Kreu i 'Mjedisit' në Vlorë është vënë në pranga, ndërsa akuzohet për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Sipas informacioneve nga blutë, Lilaj ka qenë nën efektin e alkoolit në normën 0.7 nga 0.2 që duhet të jetë normalja.

AKSIDENTI
Ngjarja që i ngjan si një sekuenca filmi ka ndodhur në rrugën Transballkanike. Automjeti tip "Benz" me targa AA 272 RB që drejtohej nga Kreshnik Lilaj ka humbur kontrollin duke dalë nga rruga.

Rrëfhet balerina: Sikleti në spektaklin e Marina Vjollcës, ja si e kapërceva

Ana Jonuzi:

Në balet nuk them kurrë "Stop", Albi Nako kërkon perfeksion

"Puna pasion, në skenë jap maksimumin tim"

Egla Xhemali

Me të takohemi në performanca plot shkëlqim dhe drita. Një nga vajzat më të dashura për publikun, pjesë e trupës së baletit të Albi Nakos, e njohur për pozitivitetin dhe energjinë e saj. E kemi fjalën për Ana Jonuzin. Bukuroshja rrëfen për "Gazeta shqiptare" përjetimet në skenë, momentin më të sikletshëm në spektaklin e Marina Vjollcës, në të cilin është duartrokatur shumë, pasionin e madh që ka për modelingun si dhe dhuratën më të shtrenjtë që i ka bërë Zoti. Ana ndan me ne copëza nga gjithë emocionet që i fal skena duke na thënë se e do fort atë që bën. Më tej, Jonuzi thotë se të punosh me Albi Nakon është fat. "Maestroja është shumë korrekt dhe do perfeksion" pohon ajo. Një ditë e zakonshme me të nuk ka kuptim, nëse do mungonte aparati fotografik. Përtej bukurisë që ofron ekranin, balerina ka zgjedhur të jetë po ajo e bukur në përditshmëri.

Cfarë e bën baletin të veçantë?

Baleti është ajo gjini artistike, e cila i shpreh ndjesitë e saj përmes lëvizjeve të shoqëruara me muzikë shfaqje skeniko-muzikore e trupës vallëzuese. Gjithash-tu, baleti e ka vallëzimin dhe lëvizjet skenike si formë shprehëse të krijimit dhe kjo gjë e bën më të veçantë atë pasi përcjell mesazhe tek publiku nëpërmjet lëvizjeve skenike që ne krijojmë.

Kërcimi që duket se të ngjan me natyrën?

Nuk mund të përcaktoj një kërcim specifik që e përfaqëson natyrën pasi kërcimi në vetvetë është i bukur, i ndier, i lirshëm ka jetë, ashtu si ne kemi dhe natyrën. Pra, nëse je pjesë e kërcimit je pjesë e ndjenjave të mëdha.

Je pjesë e trupës së baletit të Albi Nakos. Sa e vështirë është të punosh



me të?

Para se të tregoj se çfarë vështirësie është të punosh me maestron e madh Albi Nako, si fillim dua ta falënderoj shumë për mbështetjen dhe mundësinë që më dha për t'u bërë pjesë e trupës së tij të baletit. Për këtë gjë i jam shumë mirë-

johëse dhe e falënderoj shumë. Për pjesën e "vështirësisë" së punuarit me të unë do të cilësoja korrektësinë që ai ka në punë dhe çdo gjë e kërkon në perfeksion. Kjo gjë na bën ndonjëherë ta quajmë "vështirësi" nga kritikant që kemi marrë, por kur realizojmë një krijim të



bukur ajo nuk quhet më vështirësi, por arritje.

Përjetimet kur je në skenë duke performuar?

Mua më ndodh që kur jemi në prova para transmetimit të kem shumë emociione gjë që më bën të mendoj: "A do mundem ta realizoj numrin deri në fund", por

sa ngjitem në skenë çdo emociion nga unë zhduket dhe mendoj që gjithë skena është imja dhe mendohem të jap maksimumin tim në atë numër që po performoj.

Momenti më i sikletshëm i një koreografie që është duartrokatur shumë?

Moment të sikletshëm

mund të quaj natën e parë të hapjes së spektaklit "Cest la vie" të drejtuar nga Marina Vjollca, pasi u bën disa ndryshime të vogla në koreografi në momentin e fundit kur ne po dilnim në skenë dhe unë nuk arrita t'i dëgjoja çfarë ndryshimesh ishin. Kur kam performuar kam qenë gjithë siklet, por ia dola dhe numri doli shumë i suksesshëm dhe është duartrokatur shumë nga publiku.

Përpos baletit, si është një ditë me Anën?

Përpos baletit një ditë me Anën është së bashku me aparatit fotografik, pasi përveç baletit unë merrem dhe me modeling. Kjo gjë më bën të kem një humor shumë të mirë, pasi pozimi është një tjetër pasion për mua që më bën të ndihem mirë.

Nëse një koktejl do mbante emrin tënd me çfarë shije do ishte?

Unë jam shumë e dhënë pas frutave ekzotike kështu që edhe koteili im do ishte i tillë.

Aventura më e rrezikshme që ke kaluar?

Deri në këtë moment nuk kam kaluar asnjë aventura të rrezikshme kështu që uroj, as mos të kaloj në vijim.

Për çfarë nuk thua kurrë "Stop"?

Unë jam tip që çdo gjë që marrë përsipër e çoj deri në fund dhe nuk them kurrë "stop" duke punuar dhe duke pasur ego për të ecur para. Unë e dashuroj punën madje them se është e vetmja gjë që më mban gjithmonë në humor, është pika ime kyç për të ecur aty ku dua.


Dhurata më e shtrenjtë që të është bërë?

Dhurata materiale ne marrim shpesh, por unë nuk po rendis asnjë nga ato të shtrenjtat në krahasim me atë dhuratë që kam marrë nga zoti. Vitin që kaloj kam kaluar një situatë shumë të vështirë me motrën, ku ajo po luftonte me jetën dhe fatmirësisht zoti na ndihmoi dhe ajo ia doli. Tani është në krahët e mi. Rrezikonte jetën megjithatë çdo gjë rezultoi e suksesshme ndaj e quaj dhuratën më të shtrenjtë që më është bërë dhe që mund të më bëhej ndonjëherë në jetë.



Pas ndarjes Seldi ironizon Mimosën, zbuloni postimin që u fshi

Pas ndarjes, Seldi realizoi një këngë me vajzën e Sabianit, Keisin, këngë të cilën e titulluan "S'ka dashni" dhe ashtu siç u tha që kënga "Mu ma le fajin" e Mimoza Shkodrës është dedikim, ashtu u tha edhe për këtë këngë të Seldit. Por, së fundmi Mimoza ka njoftuar se do të publikojë një këngë me Irlenc Hykën që po pritet me padurim nga publiku. Pas këtij postimi Seldi ka reaguar me një postim në 'Instastory' ku ironizon ish-të fejuarin dhe këngëtarin. "Fiona dhe Shreku së shpejti", shkruan Seldi në postimin që tashmë është fshirë. Këngëtarin ka publikuar një foto tjetër dhe një fanse e pyet "prapë single". Mirëpo një tjetër fanse ia kthen: "Pse kur ka qenë ndonjëherë i lidhur ky".



Dhe këtu nuk mund të mos reagojë Seldi, i cili shkroi me ironi me siguri: "Sa e lezetshme".



Marina Vjollca reagon për vajzën që i "vodhi" zemrën Getoarit

Getoar tërhoqi vëmendjen e të gjithëve ditën e djeshme me një foto ku shfaqej me mbesën e Marinës, Jorin për të cilën shkruante se është më e bukura. Fakti që Getoar i zgjodhi Jorin si më të bukurën e familjes Vjollca dhe jo Marinën, i bëri të gjithë kuriozë si ka reaguar moderatori. Kjo e fundit ka postuar gjithashtu një foto me mbesën dhe mesa duket ndan të njëjtin mendim me bashkëshortin. "Pafund dashuri për Lolin tim. Mbesa ime e bukur", shkruan Marina.



Ish-bashkëshortja e Stines flet për herë të parë për raportin me këngëtarin

Stine dhe Graciela Pashaj nuk janë më bashkë prej një vit. Këngëtarin në atë kohë zgjodhi që lajmin e ndarjes ta bënte publik në "Instagram" duke falënderuar Gracielen, për çdo moment të dhuruar dhe për ndihmën në kohët e vështira. Në këtë mënyrë të gjithë ishin të sigurtë se ndarja ishte me mirëkuptim nga të dyja palët. Ata së bashku kanë edhe një vajzë të vogël, të quajtur Estia. Graciela ka qenë e ftuar në "Da'Sara Show" ka vendosur të flase për marrëdhënien e saj me Stinen. Në një moment gazetarja Dasara e pyeti duke qeshur Gracielen nëse është ish-bashkëshortja, apo është pajtuar prapë me Stinen, dhe pa hezitim ajo iu përgjigj: "Jo, jo, jo, jam ish-bashkëshortja!" Gjithashtu, Graciela është shprehur se pavarësisht asaj që ka ndodhur nuk janë armiq me njëri-tjetrin, sepse janë prindër të një vajze.



"U zhduk" nga rrjetet sociale, ja rikthimi i bujshëm i Ledion Liços

Prej kohësh Ledion Liço nuk ka qenë aktiv në jetën publike dhe atë profesionale. Ai hoqi dorë nga moderimi i "The Voice" dhe, gjithashtu, mbylli të gjitha rrjetet sociale. Me siguri të gjithëve ju ka munguar moderatori shumë i dashur për publikun, por pas një kohe të gjatë më në fund ai është rikthyer. Ka qenë bashkëshortja e tij Sara ajo që ka postuar një foto të Ledionit në "Instastory". Ledioni mesa duket do të rikthehet me shumë energji pas këtij "pushimi" dhe me plot projekte të reja. Për t'i zbuluar të gjitha këto na ngelet vetëm të presim.



A humbet Kosova veriun e Mitrovicës? Deklarata e fortë e Thaçit

Presidenti Hashim Thaçi, ka qenë i ftuar në emisionin "Të Paekspozuarit", ku është pyetur nga analisti Fatos Lubonja, se përse nuk ka transparencë në lidhje me marrëveshjen e mundshme Kosovë-Serbi. Lubonja e pyeti presidentin, se cilat do të jenë humbjet e Kosovës, sepse deri sot ai në publik ka folur vetëm për njohjen e Kosovës nga Serbia dhe bashkimin e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit me Kosovën, pra vetëm për përfitime nga marrëveshja.

Presidenti Thaçi, u përgjigj duke thënë se në asnjë rrethanë Gazivoda,

veriu i Mitrovicës dhe Trepça, nuk do të shkëputen nga Kosova në asnjë rrethanë, deklarata e kjo mjaft e fortë.

Fatos Lubonja: Për mendimin tim, dhimbja që do t'i transmetojë Vuçiçi, serbëve, është ideja që ne do ta njohim Kosovën që deri tani nuk e kanë njohur. Por, ideja është që ky nuk heq dot dorë, pa patur diçka, që të paktën t'ua shesë atyre politikisht, që është shkëputja e pjesës së Mitrovicës, zonës së banuar nga Serbët. Nëse çështja do të ishte deri atje ku thotë zoti Thaçi, domethënë thjesht ne do

marrim Preshevën dhe Bujanovcin, nuk ka as shqiptarë dhe as ndërkombëtar në botë, që mund të mendojë se mund të arrihet një marrëveshje me këtë gjë.

Domethënë, Vuçiçi, jo vetëm njeh Kosovën, por të jep edhe Preshevën dhe Bujanovcin. Kjo nuk qëndron, që të jemi të sigurtë me publikun. Atëherë, publikut shqiptar i duhet thënë, ne kemi dhimbjen tonë, që është shkëputja, e një zone, e një harte, që ju nuk e keni njohur kur ua kanë paraqitur.

Hashim Thaçi: As Gazivoda, as veriu i Mitro-

vicës, e as Trepça, në asnjë rrethanë, në asnjë moment, kurrë nuk do të jenë pjesë e ndonjë kompromisi në raport me Serbinë. Është e përmbullur për mua.

Fatos Lubonja: Si mund të hyjë Serbia në këtë marrëveshje?

Hashim Thaçi: Mos e kërko përgjigjen në emër të Beogradit nga unë. Unë prezantoj pozicionin tim. Gazivodë, veriu i Mitrovicës, Trepça, në asnjë rrethanë as në tavolinë nuk do të vijmë, nuk do të jenë kurrë në tavolinë për arrijtjen e një marrëveshje. Janë dhe do të mbeten pjesë të Kosovës.



Media ruse: S'ka presion të SHBA-ve mbi Kosovën, është i gjithi skenar

Tensionohen marrëdhëniet, ambasadori i SHBA përplas derën pas takimit me Kosovën

Politika kosovare në krizë, qeveria rrezikon rënien

Ditën e djeshme medi dat kosovare kanë raportuar se ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Philip Kosnett, ka lënë takimin me liderët vendës, duke shfaqur nervozizëm nga refuzimi i kryeministrit Ramush Haradinaj për pezullimin e taksës dhe rifillimin e dialogut. Burime të RTK-së thonë se ambasadori Philip Kosnett është ngritur demonstrativisht dhe ka përplasur derën, teksa është larguar nga takimi që kishte për qëllim diskutimin për zgjidhjen e kësaj çështje. Kjo është edhe arsyeja pse liderët kosovarë dje mbeten më gjatë në takim, e nuk dolën përnjëherë me ambasadorin e SHBA-ve. Në këtë takim me presidentin Hashim Thaçi, kryeparlamentarin Kadri Veseli dhe kryeministrin Ramush Haradinaj, siç mësohet ambasadori Kosnett ka bërë të qartë se ekzistojnë vetëm dy rrugë. E para, pezullimi i taksës, që nënkupton qëndrimin e SHBA-ve përkrah Kosovës deri në fund. E dyta, vendosja e menjëhershme e sanksioneve të SHBA-ve për Kosovën, që nënkupton dëmtimin serioz të raporteve mes dy vendeve. Qeveria e Kosovës më 21 nëntor ka vendosur taksë 100% për mallrat nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina. Që nga ajo ditë, Kosova është duke u përballur me presionin e SHBA-ve dhe BE-së për pezullimin e taksës dhe shfrytëzimin e mundësisë për arrijtjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse mes Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes këtyre dy vendeve. "Pezullimi 120-ditor për taksat e mallrave që vijnë nga Serbia dhe



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Philip Kosnett

Bosnja e Hercegovina është një opsion i mundshëm edhe nëse qeveria bie, siç njoftoi Haradinaj", kështu fillon shkrimin media ruse "Sputnik". Kriza në dukje e ashpër e politikës po trondit Kosovën dhe dëshmia e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj tregon se qeveria mund të bjerë këtë javë. Sipas mediave të Kosovës, këto ditë ka pasur një çarje të mprehtë midis presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministrit Ramush Haradinaj. Haradinaj e hodhi poshtë propozimin e partnerit të koalicionit, Kadri Veseli për pezullimin e taksës për mallrat nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina për 120 ditë dhe në vend të kësaj sugjeroi që SHBA-të

dhe BE të iniciojnë mbajtjen e një konference ndërkombëtare, që do të arrijë një marrëveshje gjithëpërfshirëse midis Beogradit dhe Prishtinës, e cila do të nënkuptonte njohjen reciproke, shkruan "Sputnik". Një politikan nga Graçanica, Stefan Filipović, tregon për "Sputnik" se në qoftë se do të ketë rënie të qeverisë, atëherë ky është një skenar i paracaktuar dhe deklarata e Haradinajt do të ishte vetëm për gatitje e terrenit për një gjë të tillë. Sipas tij, vetëm njerëzit naivë mund të besojnë se ekziston presioni nga SHBA-të ose vendet e kuittit për Kosovën, sepse vetë Haradinaj në mënyrë të përsëritur ka thënë se "politika e jashtme e Kosovës është

jasthtë Kosovës". "Natyrisht që ka një lloj mosmarrëveshjeje midis Haradinajt dhe Thaçit, që është një faktor kyç politik në Kosovë. Ai që injoron dhe nënvlerëson Thaçin apo atë që ai e kupton për dinamiken politike në Kosovë, ai nuk do të jetë në gjendje të parashikojë asgjë. Kujtojmë se një javë më parë ishte një periudhë e heshtjes mediatike të Thaçit dhe papritmas u shfaq me tezhën se taksat duhet të bien. Veseli po luan një lojë në mes", tha Filipović. Filipović tha se një pezullim 120-ditor mbi taksat e mallrave të Serbisë dhe BEH është një opsion i mundshëm. Ai ka theksuar se nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit në vitin 2013, proceset zgjed-

hore në Beograd dhe Prishtinë varen reciprokisht dhe sa herë që zgjedhjet mbahen në Serbi ose Kosovë, gjitha negociatat vazhdojnë. Filipović thotë se nuk ka presion nga SHBA-të në Kosovë, sepse nëse SHBA vendosin se diçka do të ndodhë në Kosovë, ajo do të ndodhë dhe kjo nuk vlen vetëm për Kosovën, por edhe për Maqedoninë. Sputnik ka shkruar gjithashtu se lojëra të tilla të vendeve të kuittit nuk janë asgjë e re, por këto lojëra nuk duhet të ndikojnë në stabilitetin ekzistencial dhe sigurinë fizike të qytetarëve të Kosovës. Filipović beson se ideja e një konference ndërkombëtare, siç Haradinaj pretendon, që është pa forca ndërkombëtare që janë të favorshme për Serbinë, nuk është realiste. "Dhe nëse tani do të mbajmë një konferencë për të marrë pjesë edhe Rusia dhe Kina, ne e dimë se ata do të mbajnë anën e Serbisë, përsëri nuk do të ketë zgjidhje". Filipović tha se pavarësisht se Kosovës nuk është temë dhe kujton se Edi Rama ofroi karrige ministrorë në qeverinë e Shqipërisë për një djalë nga Kosova, gjë që sipas tij tregon se e vërtetë është tema e Shqipërisë së madhe. Prandaj nuk përjashtohet që në të ardhmen e parashikueshme, qeveria e Shqipërisë të ketë ministra nga Maqedonia, por edhe nga Mali i Zi.

Maqedonia: Shqipëria ska bashkëpunuar për Gruevskin

Vijon hetimi për ar ratisjen e ish-kryeministrit Gruevski në Maqedoni. Prokurorja për ndjekje penale të krimtë organizuar dhe korrupsionit, Vilma Ruskoska, në një deklaratë për media u shpreh që nuk ishte e qartë pse Shqipëria nuk i ka dorëzuar pamjet e kamerave të sigurisë nga arratisja e ish-kryeministrit maqedonas, Nikola Gruevski. "Dua të theksoj për publikun se ndihma ligjore ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë është kërkuar në të njëjtën kohë kur është kërkuar ndihmë edhe nga Republika e Malit të Zi. Kolegët nga Mali i Zi kanë dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara, ndërsa nuk e kam të qartë se për çfarë arsye përgjegjësi nga Republika e Shqipërisë nuk kanë ndërmarrë masat e duhura", tha Ruskoska. Prokurorja konfirmoi se në pamjet e siguruar nga Mali i Zi ka parë Gruevskin, ashtu edhe siç u raportua, në një makinë me dy diplomate hungarezë.

Kallkan në Europë, temperaturat arrijnë në -40 gradë celsius

Të paktën 12 viktima nga ngricat dhe i ftohti në SHBA, vorbulla polare përfshin Çikagon

Janë të paktën dhjetë viktima nga moti i keq që ka goditur këto ditë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Rajoni i Midwest në brigjet lindore është përfshirë nga temperatura ekstreme -40 gradë. Në Nju Jork dhe Uashington termometri ka arritur -14 gradë celsius dhe ajo që ka rritur më shumë të ftohtin ka qenë era e ftohtë dhe korrentet polare. Shumë probleme janë krijuar në transportin rrugor dhe atë ajror. Shumë fluturime janë anuluar. I ftohti poliar ka mbërthyer edhe Çikagon, ku termometri ka zbritur në -27

SHBA
Një vorbull polare ka mbërthyer pjesën qendrore të SHBA-ve, duke shkaktuar temperatura jashtëzakonisht të ulëta, që mund të theyjnë rekorde, ndërkohë që Çikago do të jetë një nga zonat më të ftohta. Parashikohen që temperaturat do të ulen në nivel rekord shkruan "The Chicago Tribune".

gradë, duke detyruar drejtuesit e hekurudhave të ndërpresin transportin hekurudhor për shkak të binarëve të ngrirë. Një vorbull polare ka mbërthyer pjesën qendrore të SHBA-ve, duke shkaktuar temper-

atura jashtëzakonisht të ulëta, që mund të theyjnë rekorde, ndërkohë që Çikago do të jetë një nga zonat më të ftohta. Parashikohen që temperaturat do të ulen në nivel rekord shkruan "The Chicago Tribune".

Për ta vënë atë në perspektivë, Çikago do të jetë më e ftohtë se Antarktida dhe Siberia. Qindra fluturime janë anuluar dhe disa organizata joqeveritare po hapin strehimore shtesë për të pastrehët. Edhe kopshtin zoologjik Brookfield do të mbyllet me qëllim të sigurimit të kafshëve. Ndërkaq, nata e të mërkurës ka qenë më e ftohta në shumë vende të Europës Veriore. Shërbimi suedez i motit regjistroi në veri të vendit, në Nikkaluokta, Lapland, temper-

aturën minus 39,5 gradë celsius. Temperatura të ngjashme kanë ndodhur edhe në veri të Norvegjisë dhe Finlandës. Megjithatë, shërbimi specifikon se mesatarisht në Suedi, muaji janar ishte më i ngrohtë se normalja". Agjencia suedeze TT shton se temperatura më e ulët e regjistruar ndonjëherë në vend ka qenë në vitin 1966, po në Lapland, me minus 52,6 gradë selsius. I ftohti intensiv ka mbërthyer edhe në Britaninë e Madhe, ku ekspertët regjistruan natën më të ftohtë deri tani këtë dimër, me temperatura që në Skoci kanë prekur minus 11 gradë celsius.

PE/vendeve anëtare të BE: "Akreditoni" të dërguarin e emëruar nga opozita

Bashkimi European hedh hapin e parë drejt njohjes së Huan Guaidos si president legjitim të përkohshëm të Venezuelës. Në seancën e së enjtes në Bruksel, eurodeputetët miratuan një rezolutë, ku i kërkohej shefes së diplomacisë europiane, Federika Mogherini të nisë bisedimet me vendet anëtare të për të njohur Guaidon si president legjitim. Në rezolutë Brukseli shprehet njëzëri kundër shtypjes me dhunë të protestave popullore nga presidenti majtist, Nikolas Maduro. Disa vende europiane si Gjermania, Franca, Britania e Madhe e Spanja e kanë njohur Guaidon. Lideri propërdimor venezuelian tha një intervistë për "New York Times" se kishte kërkuar mbështetjen e ushtrisë për të rrëzuar Maduron. "Kemi pasur takime klandestine me pjesëtarë të Forcave të Armatosura dhe ata të Sigurisë. Tërheqja e mbështetjes së ushtrisë për Maduron është thelbësore për të mundësuar ndryshimin e qeverisë. Shumë prej ushtarakeve janë dakord që trazirat më të fundit janë të pashmangshme". Ndërsa Nikolas Maduro paralajmëroi se ndërhyrja ushtarake amerikane në Venezuelë do t'u shkaktojë atyre humbje më të rënda se në Vietnam. Ndërsa në Karakas, manifestimet masive opozitare vazhdojnë. Nga ana tjetër, Parlamenti European votoi për të njohur udhëheqësin e opozitës Juan Guaido si president i përkohshëm legjitim të Venezuelës dhe u kërkoj vendeve anëtare të BE të bëjnë të njëjtën gjë. Rezoluta e votuar të enjten u bëri thirrje udhëheqjes së BE-së të miratojë "një qëndrim të fortë dhe të unifikuar" dhe ta njohë Guaidon si presidentin e vetëm të ligjshëm të kombit të Amerikës së Jugut, derisa të mbahen zgjedhje të reja për "rividrosjen e demokracisë". Parlamentarët gjithashtu prematuan "mbështetje të

Bashkimi European njeher presidentin e ri në Venezuelë

Guaido: Bëmë një hap të madh në luftën tonë për demokraci



Presidenti i vetëshpallur në Venezuelë, Huan Guaido

HUAN GUIDO
"Kemi pasur takime klandestine me pjesëtarë të Forcave të Armatosura dhe të Sigurisë. Tërheqja e mbështetjes së ushtrisë për Maduron është thelbësore për të mundësuar ndryshimin e qeverisë. Shumë prej ushtarakeve janë dakord që trazirat më të fundit janë të pashmangshme".

plotë" për parlamentin e kontrolluar nga opozita, Asamblenë Kombëtare, duke i kërkuar vendeve të BE të "akreditojnë" të dërguarin e emëruar nga opozita. Dokumenti u miratua me 439 vota, me 88 abstenime të deputetëve. Guaido falënderoi Parlamentin Evropian për votimin. "Bëmë një hap të madh në luftën tonë për demokraci", shkroi ai në "Twitter". Federica Mogheri-

ni kishte premtuar më parë "mbështetje të plotë" për Asamblenë Kombëtare. Ndërkaq, Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump dhe Presidenti i vetëshpallur i Venezuelës, Juan Guaido kanë rënë dakord gjatë një bisede telefonike për të mbajtur komunikim të vazhdueshëm, ka njoftuar Shtëpia e Bardhë. Trump ka treguar edhe një herë "mbështetje të fuqishme për



"Ngrin" Amerika! Me këtë titull janë hapur sot shumica e mediave botërore dhe me foto që duket se vijnë nga një botë tjetër, pavarësisht se bëhet fjalë për pamje reale. Vala e të ftohtit që ka mbërthyer këtë vend dhe temperaturat ekstreme kanë shkaktuar të paktën 12 të vdekur. Temperaturat u ulën në Park Rapids, Minnesota dhe -31F në Fargo, Dakota e Veriut.

luftën që po bën Venezuela për të rikthyer demokracinë", ka thënë zëdhënësjja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders përmes një deklarate më 30 janar. Shtetet e Bashkuara kanë njohur Guaidon, lider opozitar dhe kryesues i Asamblesë Kombëtare të Venezuelës, si president të këtij shteti. Shtetet tjera, duke përfshirë Rusinë, e mbështesin presidentin e kontestuar, Nicolas Maduro. Diskutimet e

Trump me Guaidon kanë ardhur pasi Gjykata Supreme e Venezuelës i ka ndaluar udhëtimin liderit opozitar, si dhe i ka bllokuar llogaritë bankare. Guaido nuk mund të largohet nga shteti derisa të kompletohet një hetim preliminar meqë ai "ka shkaktuar dëm në paqen e republikës", ka thënë gjyqtari, Maikel Moreno, më 29 janar. Guaido e ka shpallur veten president të përkohshëm javën e kaluar.

SHKURT

E frikshme! Gjyshërit pijanecë djegin foshnjën në sobë

Maxim Sagalakov, një mbebe 11-muajshe, ka vdekur i karbonizuar, pasi gjyshërit e tij e kishin hedhur sipër sobës së shtëpisë. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në Khakassia, në Rusi. Nëna e vogëlushit, Viktoria Sagalakova, 20 vjeç, e kishte lënë djalin e saj 42 dhe 47 vjeç dhe kur është kthyer në shtëpi e ka gjetur djalin e saj pa jetë. Mesa duket, gjyshërit e saj ishin të dehur dhe i kishin treguar policisë që nuk e duronin dot djalin teksa qante. Viktoria ka shprehur të gjithë dhimbjen e saj në rrjetet sociale. "U prehsh në paqe, djali im i dashur", shkruan ajo në "Facebook". "Jam akoma e shokuar. Ata gjithmonë janë kujdesur për të. Fëmijët e mi luani me të, nuk e kuptoj se si ka ndodhur e gjitha kjo". Për vdekjen e të voglit Maxim, të dy gjyshërit vrezikojnë burgim të përjetshëm.

Braktiset nga partneri, nëna e re vret dy binjakët në banjë

Një krim makabër ka ndodhur para dy ditësh në Zvicër, ku një nënë e re vrau binjakët e saj dhe më pas fshihu trupat e tyre në shtëpi. Pas zbulimit të krim-it, ajo është burgosur për një vit. Gruaja serbe, Jelica S., ishte braktisur nga partneri. Ajo nuk kishte mundësi të bënte një abort dhe lindi e vetme në një shtëpi në Luzern, Zvicër. Një gjykatë në qytetin zvicëran të Luzernit tha se 23-vjeçarja kishte shkruar në punë deri në muajin e 7 të shtatzënisë dhe më pas ishte larguar. Ajo ka treguar se ishte e vetme dhe nuk dinte sesi t'i lindte fëmijët e saj. Në momentin që kanë filluar kontraktimet, ajo ka marrë laptopin dhe ka hapur video në "YouTube" për të parë sesi mund të kryente lindje në shtëpi dhe më pas ka hyrë në një vaskë me ujë. "Nuk e dija se si lindet një fëmijë. Mbusha vaskën me ujë dhe hapa laptopin për të parë në internet se çfarë mund të bëja". Jelica S., tha para gjykatës së nuk e dinte sesi të vepronte, pasi foshnja e parë nuk po reagoonte dhe nuk po qante, sikurse duhet të bëjë fëmija dhe më pas e mori dhe e çoi në tek lavamanit dhe e goditi dy herë derisa e hodhi në tokë. Foshnja pësoi thyerja të shumta të kokcave dhe dëmtim të trurit dhe ndërroi jetë. E reja e mori foshnjën dhe e futi në një arush dhe më pas e hodhi. Ndërsa me djalin e dytë e mbajti rreth 31 orë në banjë, ku dhe ai ndërroi jetë. Edhe foshnjën e dytë e mblodhi me një peshqir dhe e fshiu në kuzhinë. Jelica S., e cila jetonte në Luzern, është shpallur fajtorë për vrasjen me dashje për njërin nga djemtë e saj binjakë, ndërsa foshnja i dytë vdiq nga neglizhencia. Prokurorët thanë se 23-vjeçarja nuk ishte në gjendje të paguante për një abort.

Opinion i Ditës

Më shumë nga Konsujt e Nderit

Nga Jorgji KOTE

Shqipëria ka 85 Konsujt Nderi në 49 shtete të botës, veç 44 të tjerëve që përfaqësojnë vendet e tyre në Tiranë. Konsujt tanë kanë dhe Shoqatën e tyre aktive të kryesuar në gjashtë vitet e fundit nga zoti Ylli Ndroqi, tani Kryetar Nderi dhe nga qershori 2018 nga zoti Gentian Sula. Kujdes se konsujt e nderit nuk duhen ngatërruar me konsujt profesionistë ose të karrierës, të cilët emërohen dhe paguhen nga ministrinë e Jashtme të çdo vendi për të shërbyer me kohë të plotë në Tiranë dhe në vende të ndryshme, si pjesë përbërëse të ambasadave. Ndërsa Konsujt e Nderit caktohen vetëm për vendin ku ata jetojnë/punojnë; ata nuk shpërblehen për punën e tyre, e cila është vullnetare dhe me kohë të pjesshme; në fakt, nuk kryejnë, me ndonjë përjashtim, veprime zyrtare konsullore si lëshim dokumentesh, etj. Ndryshe nga konsujt profesionistë, ata nuk gëzojnë status/imunitet diplomatik, as lehtësi dhe përjashtime nga taksat dhe tatime, veç blerjes së artikujve që u duhen në veprimtarinë si konsuj, për pritje, etj.; së fundi, ata përballojnë vetë shpenzimet dhe për zyrat e tyre të punës.

Konsull Nderi nuk mund të zgjidhet kushdo, çfarëdo konkursi apo testi të kalojë, por kryesisht personalitete të politikës, komunitetit afarist, kulturor, të arteve, shoqërisë civile dhe modës, me ndikim, imazh dhe reputacion të padiskutueshëm, me njohje dhe lidhje të shumta dhe me median/televizionin, etj. Ata caktohen nga autoritetet përkatëse të çdo vendi pas miratimit të palës tjetër mbi bazën e Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963 dhe mbi këtë bazë të ligjeve të çdo vendi.

Mbi të gjitha, të jesh Konsull (e) Nderi ka qenë dhe mbetet çështje dashamirësie ndaj vendit përkatës, por dhe e statusit social, emrit dhe reputacionit të vetë Konsullit.

Në këto për vendet e tjera sidomos ato të mëdha, Konsujt e Nderit janë më tepër ceremonialë, honorifikë ose "luks diplomatik". Puna e tyre konsiston kryesisht në praninë në veprimtari të ndryshme kushtuar vendit përkatës, duke ndikuar në imazhin e vendit që përfaqësojnë dhe shtimin e lidhjeve të tij në fusha të ndryshme.

Kurse për vendin tonë, ata janë e duhet të jenë shumë më tepër se ajo. Kjo për shkak të mungesave tona në personelin diplomatik/konsullor dhe në mbulimin e mangët gjeografik të rajoneve të ndryshme në botë, si bie fjala, Ukraina, Korea e Jugut, Meksika, Argjentina, Indonezia, etj. nga diplomacia jonë; por, mbi të gjitha nisur nga nevojat dhe synimet madhore të politikës sonë të jashtëme, sidomos nxitja e dimensioneve ekonomike, kulturore, parlamentare, publike dhe qytetare të saj.

Për më tepër se dhe në vendet ku kemi përfaqësi diplomatike, ato kanë personel shumë të vogël,



kryesisht me 2-3 vetë, me përjashtim të ambasadave pak më të mëdha në Greqi, Itali, Gjermani, Bruksel e ndonjë tjetër. Megjithatë dhe këto të fundit e kanë të vështirë që të ndjekin sistematikisht veprimtarinë në qytete të tjera dhe në vendet ku janë rezidentë, le më pastaj për shtete të tjera jashtë juridiksionit të tyre e që nuk janë pak.

Vërtet që dhe ambasada të vendeve të rajonit nuk kanë ndonjë personel më të madh; por, ato mbështeten të paktën nga një zyrë përfaqësimi jashtë vendit - e Dhomës së Tregtisë, Agjencisë së Investimeve, Turistikë dhe qendrave kulturore në metropolet e ndryshme; kurse në rastin tonë nuk kemi kurrkund asnjë prej këtyre zyrave përfaqësimi, me gjithë premtimet e shumta që vazhdojnë të bëhen.

Në këto kushte, sidomos në vendet e largëta, të cilave herë pas here u kërkojmë mbështetjen veçanërisht në planin shumëpalësh, si votimet në organizmat ndërkombëtare, njohjen dhe aderimin në to të Kosovës, puna dhe aktiviteti i Konsujve të Nderit jashtë vendit është i vetmi kanal i vërtetë për një punë sistematike dhe efektive.

Ndaj, sidomos në rastin e Shqipërisë, ndonëse "Nderi" në emër, këta konsuj janë e mund të kthehen shumë më tepër në institucione me aktivitet dinamik, duke plotësuar dhe zgjeruar më tej punën dhe gjeografinë e përfaqësive tona diplomatike.

Pa dashur të hyjmë në analiza, por duke i njohur nga afër disa konsullata nderi, mendoj se është momenti për një rivlerësim më të drejtë të tyre, duke filluar nga miratimi i një ligji të veçantë, caktimi, monitorimi i vazhdueshëm dhe vijueshmëria e aktivitetit të tyre, bashkëpunimi me ambasadat, mbështetje më të madhe nga qendra, duke filluar nga takimet me ta dhe pajisja me materiale të ndryshme promovimi mbi vendin

tonë që janë tejet deficitare.

Vërtet që janë ambasadat pranë tyre që janë ngarkuar për bashkëpunim me to; gjithsesi, përvoja ndërkombëtare dëshmon se roli dhe aktivizimi i konsujve të nderit jashtë vendit, sidomos atyre në kontinente të largëta mbetet një aspekt që kërkon përpunim, vëmendje dhe vizibilitet më të madh dhe nga qendra, që ata, por dhe të tjerë të mos mbeten ceremonialë, sa për emër apo dhe të abuzojnë me këtë status, madje dhe pas përfundimit të tij, siç ka ndodhur në ndonjë rast.

Për këtë qëllim, sidomos në fazën përzgjedhëse, kjo kërkon dëgjimin më të mirë të opinionit dhe vërejtjeve dhe të kryesive të shoqatave tona jashtë vendit; ato kanë krijuar përvojë, lidhje dhe kontakte të shumta dhe tejet cilësore me elitat politike, parlamentare, afariste dhe kulturore në vendet e tyre që janë pikë e pazëvendësueshme referuese dhe për zgjedhjen e Konsujve të Nderit.

Ky rivlerësim mund të fillojë qysh me përmirësimin e shpërndarjes gjeografike të Konsujve tanë të Nderit jashtë vendit. Veç disa vendeve të tjera, ky përfaqësim është normal në Itali me shtatë, në Turqi me katër, në Brazil me tre dhe në SHBA me pesë Konsujt Nderi, ndërmjet të cilëve i mirënjohuri Ekrem Bardha.

Nga ana tjetër, në vende të mëdha si Japoni, Meksikë, Argjentinë dhe Indonezi kemi ende vetëm nga një Konsull Nderi. Një raport i zhdrejtë ekziston ndërmjet Austrisë së vogël ku kemi pesë konsuj nderi ndërmjet të cilëve i mirënjohuri Robert Rogner, Francëz dhe Gjermanisë me vetëm dy, aq sa Finlanda, kur deri para disa vitesh kishim katër të gjithë. Duke njohur vështirësitë e tillë dhe caktimit të tyre, kjo gjendje mund të ndryshojë me më shumë përpjekje; apo kur kemi vetëm një Konsull Nderi në Holandë e në Kroaci dhe tre në Kosovë!

Eshtë padyshim dukuri pozitive që shumë vende kanë emëruar konsuj nderi në vendin tonë emra të njohur të biznesit dhe nga fusha të tjera. Duke njohur vështirësitë e distancave gjeografike dhe hapat e ndërmarrë, sidomos me Japoninë, Meksikën, Korenë e Jugut, etj., le ta themi se mundësitë janë shumë më të mëdha për prezantimin e vlerave tona më të mira kulturore me ato dhe të tjera vende. Për më tepër që si liderë biznesi, konsujt e tyre të nderit në Tiranë kanë më shumë mundësi, përfshi ato financiare për nxitjen e shkëmbimeve tregtare, por dhe të atyre kulturore, artistike, letrare dhe njerëzore. Sepse afaristët tanë në këtë rast nuk janë përfaqësues ekonomikë apo tregtarë, por Konsujt Nderi, me një reze veprimi shumë më të gjerë se biznesi.

Për ta bërë më të qartë për lexuesin veprimtarinë e tyre, me respekt për të gjithë konsujt e nderit, më poshtë përmenden shkurt vetëm pesë shembuj pozitivë, që gjatë 20 viteve të fundit si diplomat i kam njohur nga afër gjatë bashkëpunimit me ta, me bindjen se ka dhe shumë raste të tjera të ngjashme.

Nga viti 2006 e deri tani në SHBA është Konsulli i Nderit për Atlanta, Ambasadori veteran Theodore R. Britton. Personalitet mjaft i njohur, i nderuar me shumë çmime dhe dekorata dhe Ambasador i Paqes në disa vende, mjaft dinamik me organizimin e një sërë takimesh dhe vizitash dhe dashamirës ndaj vendit tonë. Krahas të tjerash, ka ndihmuar dhe mbështetur krijimin e Shoqatës qytetare të mirënjohur "People to People International" në Shqipëri dhe së fundi vendosjen e bashkëpunimit të ngushtë të Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë me homologen e mirënjohur amerikane.

Në Gjermani, Konsulli i Nderit në Landin Baden Württemberg,

Rezzo Schlauch, është personalitet i njohur i të Gjelbërve gjermanë, për një kohë të gjatë deputet i Bundestagut dhe në vitet 1998 - 2005 Sekretar Federal Shteti për Ekonominë dhe Financat. Duke qenë i lidhur dhe me një bashkëatdhetare, ai ka kohë që është bërë dhe shqiptar. Të gjithë në atë superministri e vlerësonin këtë fakt dhe sa herë shkonim për punë nga Ambasada në Berlin, dyert na hapeshin menjëherë me simpati. Ndonëse ka vite që nuk është më në qeverinë federale, fjala e tij ka peshën dhe pushtetin që të jep emri dhe reputacionin.

Kurse në Nord Rhein Westphalia, landi më i madh gjerman me 18 milionë banorë është prej mbi 10 vjet Konsulle Nderi bashkëatdhetarja jonë Anduena Stephan (Sopiqoti)

Anduena ka kaluar një qerek shekulli në Atdhe dhe po aq në Gjermani ku ka krijuar dhe familjen shqiptaro-gjermane; ka kualifikim të lartë biznesi, me përvojë si ish-drejtor në kompaninë gjigande gjermane "Hochtief" që ndërtoi Aeroportin e Rinasit dhe me biznesin e saj privat të konsullencës.

Anduena i ka kapërcyer në kuptimin më të mirë të fjalës kufijtë e një Konsulle Nderi me punë, projekte dhe veprimtari të shumta e të larmishme në të gjitha fushat, në Düsseldorf, Tiranë, Shkup, Prishtinë dhe gjetkë, me lidhje dhe njohje deri në nivelet më të larta të politikës dhe ekonomisë gjermane.

Duke u ngjitur më në veri, në Danimarkë, kemi dy Konsujt Nderi, të dy afaristë të shpikatur, dashamirës të kahershëm të vendit tonë. Hans George Niesen mbulon Rajonin Gentofte dhe muajt e fundit është promovuar si President i Federatës së Danez të Bizneseve të Vogla dhe të Mesme. Është promovues i shkëlqyer i vlerave tona më të mira kulturore dhe turizmit. Krahas kontakteve të shumta dhe ndihmës për bashkëatdhetarë, Niesen boton çdo muaj një bulletin mjaft interesant lajmesh në anglisht mbi zhvillimet më të rëndësishme në vendin tonë që u shkon ambasadorëve, liderëve të biznesit dhe agjencive kulturore daneze. Falë dhe ndihmesës së tij, vera shqiptare është futur me sukses në tregun danez.

Konsulli tjetër i Nderit në Ebeltoft, Anders Byriell është President i "Kvadrat" kompani lider ndërkombëtar në fushën e tekstileve cilësore, marketingut, dizjenos, etj.

Ndërmjet të punësuarve te ajo kompani, ka dhe të rinj shqiptarë që ai i ka ndihmuar për t'u sistemuar dhe integruar atje. Pranë Ebeltoftit, në qytetën Ronde, gjatë 20 viteve të fundit kanë shkruar për kurse të ndryshme trajnuese rreth 100 shqiptarë disa prej të cilëve kanë krijuar familje dhe punojnë kryesisht në zonën ku zoti Anders është Konsull Nderi. Krahas meritave të veta, reputacioni dhe vlerësimi pozitiv për bashkëatdhetarët tanë në ato dy zona dhe më tej i dedikohet dhe ndihmesës së zotërinjve Nielsen dhe Anders.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



BOTIMI

LEKA BUNGO:

Luftova dhëmb për dhëmb me armiqtë e vendit, por nuk më mori plumbi...


Fatmira Nikolli

Shokë të 'Qiriut të pashuar', shënimet në blloqe, fletore dhe copëra letrash i kam ruajtur për vite me radhë në valixhen time të vjetër dhe do t'i hedh në faqet e këtij "Testamenti", pa u hequr asnjë presje. Pas botimit dhe sidomos pas përkthimit në gjuhë të huaja, ju garantoj se as Europa dhe as Amerika nuk do të flasin përçart për gjoja 'krime' e komunizmit". Që në hyrje të librit shënohet: Leka Bungo, "Testamenti" i mitomanit, kapriçio në prozë" dhe gjithë ç'vijon ka të njëjtën frymë, shkruar përmes një stili të veçantë e njëherësh tërheqës.

Në një shkrim që vjen në vend të hyrjes për lexuesin regjisorit e skenaristit Leka Bungo thotë se "njerëzit bëhen shkrimtarë nga dëshira për t'u bërë të famshëm, nga makutëria për të fituar para, ose të frymëzuar nga ideale të larta. Unë nuk hyj as te të parët, as te të dytët! Mirëpo veprat e njerëzve si puna ime që nuk kanë bërë emër në fushën e letrave, zënë pluhur në vitrinat e librarive, sepse nuk i njeh njeri". Sipas tij, kjo është arsyeja që vendosi të bëjë atë që nuk arriti ta bënte pesëdhjetë vjet më parë. "Luftova dhëmb për dhëmb me armiqtë e këtij vendi, por nuk ish thënë që plumbi të më merrte në lule të ballit, të bija në fushën e betejës bashkë me njerëzit e tetë mijë të tjerët që edhe trupi im të prehej në tokë me ta në kodrat e Tiranës, pranë monumentit "Nënë Shqipëri", thotë ai, ju pa ironi.

Shton në të njëjtën frymë: "Shokë të 'Qiriut të pashuar'. Duke lënë modestinë mënjane, ju siguroj se

Regjisorin boton "Testamentin" me "UETPress", kujtimet e një jete përmes një ironie të hollë



PROMOVIMI ORGANIZOHET DITËN E ENJTE, DATË 31 JANAR 2019, ORA 18:00, NË HOLLIN E UET

Rikard Ljarja: Kur na jepte mësim Fatos Arapi, linte ekonominë politike e fliste për poezinë

botimi i 'Testamentit' nuk do të jetë vetëm sukses i autorit. Ai do ta bëjë emrin e shtëpisë suaj botuese të njohur edhe përtej kufijve të Shqipërisë. Në krye të herës më duhet t'ju kërkoj ndjesë, sepse do ta kem të pamundur t'ju sjell veprën në redaksi. Kjo thjesht ngaqë do të kem vdekur, ose me fjalë të tjera do të kem vuarë veten. Në ditët tona vrasjet janë bërë të zakonshme dhe s'bëjnë përshypje te njerëzit, ndërse vetëvrasjet bëjnë bujë, sepse janë më të rralla". Duke ironizuar dukuritë shoqërore, transmetimet televizive dhe veten, ai jep arsytet pse valixhja e tij e vjetër është gënjë më e shtrenjtë që ka. "Brenda saj jam unë, fëmijët, gratë, është populli, brenda valixhes sime të vjetër është atdheu dhe historia e tij e lavdishme. Ndaj edhe kam vendosur që "Testamentin", i cili është e vetmja pronë që kam, mos t'ua lë trashëgim as fëmijëve, as nipërve, as të afërmeve, as miqve, por popullit...".

Libri u pormovua dje pasdite, Alda Bardhyli, drejtore e Botimeve "UETPress", tha se: "A jo çfarë e ka karakterizuar veprën e Leka Bungo është satira e hollë, mënyra sesi është përpjekur t'u flasë problemeve të ndryshme shoqërore përmes artit. Kjo satirë nuk mungon as në këtë sprovë letrare, ose kapriçio siç e quan Leka".

Më poshtë po botojmë parathënien që aktori i njohur Rikard Ljarja i bën librit të mikut të tij.

një. Dhe një dhe një bëjnë dy. Shi... Dy gjemba kureshtar thërresin: Nënë. Ecim. Shkojmë drejt sheshit. Ajo më thotë rrëzë veshit: I dashur sa del rrënja e treshit... Ecim. Ecim drejt fidanishtes, ulemi nën hije. Kush rri nën dardhë i ha kokrrat. Ëndrrat tona flenë nën sgetullën e një kalit të hazdisur... (Këtu autori aludon për masat e drejta që mori Pushteti Popullor për shtetëzimim e kafshëve shtëpiake). A e ke pa një pelë m'at anë. Me të vëlanë. Ha, ha, ha, (qesh)". Këtu protagonistin i poemës merr vesh vdekjen e të dashurës... dhe pëson krizë. Ky është thelbi i stilit tallës e ironik i Lekës. Po gjatë këtyre pesëdhjetë viteve Leka ka shkruar dhjetëra drama, radiodrama, i ka vënë në skenë, i ka regjistruar në radio... Tradicionale. Po këtë radhë ka bërë diçka të jashtëzakonshme. Në stilin që e kishte brenda vetes po e kishte harruar (!) rrugës. Libri që unë e lexova në printshkrim më befasoi. Është një libër me një fantazi të çmendur që shkon deri në absurd. Testament-shkruesi me emrin Luftar apo Tar për shkurt, i ka humb kontaktet me botën reale, fantazia e tij është e pazakontë, groteske, madhështore, absurde, idioteske... "Shpesh një të panjohur, i cili nuk ka asnjë meritë, vetëvrasja e bën të njohur, madje të famshëm. Një plak rreth të tetëdhjetave u gjet i varur në kuzhinën e apartamentit. Poshtë fanellës së leshit kishte fshehur "Testamentin" e shkruar me laps kopjatit, në faqet e të cilit është i fshehur edhe misteri i vetëvrasjes". M'u kujtua Don Kishoti. M'u kujtua edhe Baroni Mulchausen. Dhe e bukura është se të gjithë të çmendurit e Luftarit apo Tarit janë të besueshëm, rrjedhin natyrshëm paçka se janë idioteskë e të çmendur. Ironi dhe sarkazëm ka nga kreu e deri në fund. Është një libër i veçantë nga ana stilistike, ndryshe çfarë jemi mësuar të lexojmë. Kur e lexon të vjen të qeshësh me budallallëqet e Luftarit, po nganjëherë edhe të dhimbset, gynah i shkreti si është katandisë... Ej, Rikard-o, paske rrjedh, paske lajthitë... e ke shok prandaj shkruan kështu. Ç'punë ka Leka Bungo me Don Kishotin, me Baronin Munchausen? E? Sikur nuk e dimë se sa i vlen lëkurë Lekës! Mendoj se mbasi të lexoni librin "Testamenti", mund të ndërroni mendim. Ka shumë mendësi të mendoni si unë. Ose mos të leni gjë pa sharë meqë e paska shkruar njëfarë Leke dhe e lëvdoka ky i rrjedhuri.

LEKA BUNGO SIPAS NJE MIKU

Picikato

Nga Rikard Ljarja

Në vitin 1961 ne ishim djem të rinj dhe ishim në vitin e parë të shkollës për aktor "A. Moisiu". Ishim nja njerëz vetë apo më shumë, po me kalimin e kohës firmuam. Në fund fare mbetëm rreth tetëmbëdhjetë. Shkolla kishte program të ngjeshur. Përveç lëndëve profesionale, bënim edhe gjithe programin e Fakultetit Gjuhë-Letërsi. Pra, të letërsisë. Kur vinte e diela vraponim për të marrë gazetën "Drita", lexonim me etje tërë poezitë që ishin botuar dhe i komentonim. Nganjëherë bënim edhe ndonjë hile. Psh., profesori i ekonomisë politike ishte poet, sa futej në klasë, mbas dy-tri fjalive për leksionin e radhës, dikush,

kur ai bënte ndonjë pauzë, një nga studentët pyeste: "Profesor e lexuat 'Dritën' dje?". Kaq ishte. Profesori harronte leksionin e ekonomisë politike dhe fillonte e bënte komente për të gjitha poezitë që ishin botuar te "Drita". Profesori kishte një temperament të jashtëzakonshëm, ndoshta edhe nga krahina nga vinte, Vlora. Ai ishte Fatos Harapi. Në atë kohë letërsia, po kryesisht poezia kishte ndërruar formë. Poezia kishte lënë mbra-pa format arkaikë dhe luante me mjete të papara ndonjëherë në poezi. Vargu i ishte larguar kanonëve të vjetruara. Ishte i lirë. Poezia e asaj periudhe po ngrinte krye me forcë. Dëshmonte se ishte një etapë të re. Në këtë "revolucion", shpesh kalohej edhe masa

për hir të modernitetit. Me këtë kalimin e masës u mor Leka. I talentuari Jani Riza së bashku me Lekën bënin një çift të përkryer humorit. Leka e kishte brenda vetes batutën inteligjente. E kishte të lindur. Leka ishte herë tallës, herë cinik fantazist, e herë... Një ditë aso koha Leka bëri një parodi të poezive "moderne" që botoheshin me shumicë. Kanë kaluar kaq vite dhe poezia ishte harruar (se shumica jonë e kishim mësuar përmendësh). Po gjithë këto vite Leka e kishte harruar dhuntinë e tij. Ose nuk e dinte që e kishte, o nuk e kuptonte me sa vlerë ishte kjo karakteristikë e tij. Me që mua mu desh mbas kaq vitesh ajo "poemë", u kujtuam se vetëm Haxhi Rama, Xhixhi pra duhet ta mbante mend.

Se Xhixhi katër vjet në bankë të parë me mua, shkroi poezi shumë të bukura për dashurinë (për Letën), disa prej të cilave u bënë këngë që u përhapën dhe u kënduan fort nga e gjithë rinia dhe jo vetëm rinia... "Lemza" për shembull... Kërciti telefoni. Dhe Xhixhi fantastik më tha se mbante mend disa vargje. M'i nisi me SMS. Mbas ca ditësh më nisi disa vargje të tjera. Ca iu kujtuam Lekës (autorit) e ca mua. Dhe kështu erdhi një pjesë e vogël e "poemës" së Lekës. E parodisë së Lekës. Ja disa vargje që kanë mbetur diku thellë në mendjet tona: "Zhurma hesht. Poemë e thepisur. Shi... Lata mesash që mendohen rëndë. I ulur mbi vargun e poemës sime mendoj për ty. Për mu. Se ti dhe unë bëjmë

DEBATI



ovolis dhe Eko Mendje në një mision në kuqish burgosurve në kushte çnjerëzore në S



vish, bëj si në, merr një pishë me vete a apo dhjetë ...



Spaci ka nevojë sot për gjelbërim, për je

"Pishat në burgun e Spaçit cenojnë dramacitetin"

Fatmira Nikolli

Reagime pas nismës për të mbjellë 504 pisha për 504 të dënuar, "e denatyrizojnë, e kthen në peizazh idilik"

Cili është ndryshimi mes idesë dhe projektit të çiparisave në kampin e Tepelenës dhe mbjelljes pa miratuar në burgun famëkeq

Ka ardhur një tjetër reagim pas nismës së 'Ekomendje' ("Eko mendje", një OJF me qëllime ambientaliste e sociale) për të mbjellë në Spaç 504 pisha për 504 njerëz që u burgosën nga diktatura. Pas Institutit për Demokraci, Media & Kulturë dhe ka reaguar edhe MEMO, një organizim që merret me përkujtimin e viktimave, e ka kundërshtuar mbjelljen e pishave në Spaç. Por teksa e bën, sqaron edhe pse mbjellja e pishave në Spaç nuk është njësoj me memorialin me çiparisa për fëmijët e vdekur në kampin e Tepelenës.

Në një postim në faqen e vet në rrjetin social "Facebook", "Eko mendje" shkruante se "Në Spaç kupton se sa shumë vlen liria dhe sa shumë ia vlen të luftosh për të. 504 pisha për 504 njerëz, të cilëve diktatura iu burgosi trupin, por jo shpirtin. Nëse ende nuk ke qenë në Spaç, ka ardhur dita që ta vizitosh. Të hysh brenda qelive të vogla e të ftohta, të cilat për ironi të ofrojnë një nga peizazhet më të bukura që mund të shohësh syri. Të ndiesh dhimbjen dhe forcën e atyre që lanë jetën aty apo atyre që ia dolën. E kur të shkoni atje, bëni si ne, merrni një pishë me vete apo dy, apo dhjetë. Spaçi ka nevojë sot për gjelbërim, për jetë. #vizitospaçin #njëpishëpërspaçin #ecovolis #ekomendje".

Burgu dhe kampi i Spaçit është zonë e mbrojtur nga Ministria e Kulturës si vend kujtese. Si i tillë, çdo ndërhyrje në të, duhet bërë me leje përkatëse dhe me miratim nga Ministria e Kulturës dhe Institutit i Monumenteve të Kulturës. Ligji i ri i trashëgimisë i miratuar më 2018 mbrohet edhe peizazhin historik të objekteve monument kulture. Ndërkaq, prej vitesh qarkullojnë ideja e një muzeu që do të kujtonte të dënuarit që jetuan e humbën jetën atje. Ai ishte një prej burgjeve, ku



u dërguan intelektualët e vendit gjatë regjimit komunist.

REAGIMI I PLOTË

Nuk mjafton vetëm me dashtë, duhet edhe me ditë!

Angazhimi i MEMO në ndërtimin e Memorialit të Fëmijëve të vdekur në Kampin e Internimit Tepelenë, nuk është rastësor, spontan apo dëshirë e momentit e një grupi aktivistësh (term shumë i (keq) përdorur së fundmi. MEMO është një iniciativë individësh që kanë dhënë e vazhdojnë të japin kontributin e tyre në shumë fusha të shoqërisë, si profesioniste e qytetarë të ndjeshëm ndaj problemeve të shoqërisë sonë, ndaj krijimi i një organizate dedikuar kujtesës, krijimit të një "zëri" me shumë

kundër dhunës, padrejtësive sociale, ishte kreu i natyrshëm. Memoriali i Fëmijëve të Vdekur në Kampin e Internimit të Tepelenës është një iniciativë e AIDSSH e 3 viteve më parë. Ky memorial është pjesë e iniciativës për muzealizimin e hapësirave të kujtesës historike.

Arkitekti Gjon Radovani, gjithashtu edhe themelues i MEMO, ka konceptuar projektin e këtij memoriali, projekt, i prezantuar përpara të gjithë grupeve të interesit me dhjetëra herë dhe i shqyrtuar dhe miratuar nga institucionet përgjegjëse. Kujtojmë këtu aprovimin nga Bordi i AIDSSH, Këshilli Bashkiak Tepelenë, nga Institutit i Monumenteve të Kulturës, etj.. Projekti bazohet në një

filozofi të qartë dhe ka një fuqi të madhe narrative duke evituar njëkohësisht çdo patetizëm dhe protagonizëm vanitoz. Empatia dhe eleganca e trajtimit të kësaj historie konkrete gjen pre në çdo element të memorialit pa "shqetësuat", "zbukuruar" apo "interferuar" në misionin muzeal të kompleksit përreth. Në gusht të këtij viti, si vazhde e përpjekjeve të AIDSSH për ndërtimin e Memorialit, MEMO u ofrua të japë kontributin e vet konkret. Në këtë rrugë u bashkuan shumë qytetarë, institucione, organizata e biznese.

Slogani "300 fëmije - 300 emra - 300 çiparisa" është motoja e fushatës, që gjeti mbështetjen tuaj dhe bëri të mundur realizimin e disa fazave të memorialit, për të cilat

jeni informuar në kohë reale në faqen tonë. Për herë të parë në Shqipëri, po ndërtohet një vepër mbi kujtesën historike me kontributin e qytetarëve.

Ne jemi të bindur se pjesëmarrja e sa shumë kontribuuesve (deri tani 267) është një aksion, që kalon kufijtë e realizimit të një veprë, pasi e kthen këtë të fundit në një rrugëtim personal ndërgjegjësimit e përkatësisë në raport me të kaluarën, është një mënyrë për të dialoguar me të në mënyrë personale. "300 fëmije - 300 emra - 300 çiparisa" është një filozofi veprimi për të qenë pjesë e qenësishme e historisë sonë të afërt e pazane.

Pas kaq vitesh heshtje e mospërfillje sociale, ne jemi të lumtur që veprat konkrete të MEMO kanë shërbyer si shtysë për njohjen e të kaluarës dhe zgjimin e interesit për hapësirat e kujtesës.

E ndjeshmë veten të detyruar për të dhënë këtë shpjegim duke marrë shkak nga një ndërhyrje në dukje e ngjashme në burgun e Spaçit para një javë, por me përmbytje tepër sipërfaqësore. Burgu i Spaçit, një tjetër sit tepër i rëndësishëm i kujtesës historike të kombit shqiptar, pozicionohet në rrethana krejt të ndryshme si për sa i përket peizazhit ashtu edhe për sa i përket historisë së tij. Nisma për të mbjellë 500 pisha në kodrën e burgut pa asnjë studim të mirëfilltë arkitekturor e denatyrizojnë atë duke rrezikuar ta kthejë në një peizazh idilik dhe duke cenuar rëndë dramacitetin e tij. Nuk po thellohem këtu në procedurat administrative të detyrueshme por po apelojmë në sensibilitetin e çdonjërit, që të paktën me dhimbjen e viktimave nuk dëshiron të bëjë protagonizëm.

Opinion

i Ditës

Grahmat e një kryeministri

Nga Bardh Spahia

(vijon nga faqja 1)

...n'qejf", është një nga "mallkimet" e urta shkodrane, që përdoret gjerësisht ngado, të cilën Edi Rama e ka asimiluar organikisht, që në 1998, kur Fatos Nano nuk e mori seriozisht ambicien e tij të sëmurë, për të shkruar shumë larg përmes politikës. Dhe ai ka arritur në majë, duke i shkelur me radhë me këmbë të gjithë ata që i hapën rrugën, e dhanë mundësitë të avanconte në hierarkinë e politikës. Prej gjashtë vitesh qeveris i vetëm, e ka kapur çdo pushtet të mundshëm të vendit, publik e jo publik. E megjithatë dje në Kuvend, ripamë Edi Ramën e kandidimit të parë për Bashkinë e Tiranës, i dalë nga kontrolli gjatë mitingut elektorale në kryeqytet që thirrjet kundër Sali Berishës, i pasoi me të qeshurën hysterike prej personi të çekuilibruar. Në atë kohë ishte dora e Ilir Metës, në të njëjtin miting, që e tërhoqi pas xhakete, për ta rikthyer në normalitet. Por dje në Kuvend, nuk kishte njeri ta frenonte, në asnjë lloj forme Edi Ramën. Të vetëm, më të afërmit, ia njohin në vetë të parë atë lloj shfaqimi, dhe e dinë që është mirë t'i qëndrosh larg, pasi vetëm një këmbëshe forcë mund t'i bënte punë. Të tjerë mes të vetëve, e shijuan fort atë shfaqje vetëdënuarëse, nën mllëfin e pakapërcyret të shkarkimit të papritur nga postet ministore, e në transmetim të drejtpërdrejt televiziv. Arsyeja e atij degradimi kishte vetëm një emër: përgjimet e reja të publikuara një ditë më parë nga Zëri i Amerikës, të struktura tëllë sirtarëve të prokurorisë, nën presion të fortë politik. Edi Rama nuk do i ketë besuar syve e veshëve, kur e ka parë të risjellë atë çështje, që mendoi se ishte varrosur prej tre muajsh, kur doli në media. E nën logon e medias që financohet nga Kongresi Amerikan, paraqitja "lakuriq", siç do t'i pëlqente kryeministrit, e mënyrës se si i ka siguruar votat për të ardhur në pushtet, ishte sinjali i pangatërrueshëm, se vizita të cilën po shpreson të realizojë në Shtëpinë e Bardhë, si shpërblim për debimin e diplomatëve iranianë nga Tirana, një akt i drejtë, e jo meritë personale, mund të kthehet në një zhgëndërr. Vetëpërmbytja, me gjasë e imponuar, për të mos reaguuar publikisht pas kronikës së VOA-s, nuk zgjati shumë, e vendimi për t'u shfaqur në seancën plenare, dukej kishte vetëm synimin të mos shfaqej i dobët para fshikullimit djegës, që i kishte ardhur nga SHBA. Por karta "Saliu", e rrënoi paraqitjen e paramenduar, e jo vetëm deputetët e mediat në seancë, por të gjithë shqiptarët konstatuan gjendjen e rënduar të një kryeministri, që tashmë ilegjitimiteti i pushtetit, po i kthehet kundër: Tundja e kartës tjetër: "komunikimit me Shtëpinë e Bardhë", pra ankthi pranë telefonit, në pritje të një bisede tele-



fonike me këshilltarin e Trump, u duk rezultati maksimal i një lobimi të fortë, i realizuar bashkë me Hashim Thaçin, për të çuar para axhendën e errët të shkëmbimit të kufijve mes Kosovës e Serbisë. Të mendosh se këtë lloj kombinimi makabër, të një politikani që bashkohet me krimin për të siguruar karrigen, siç po del nga përgjimet e dosjes së famshme 339, e që për ta mbuluar, synon faktorizimin, duke vënë në pikëpyetje kufijtë, që SHBA të parat, i kanë njohur Kosovës, apo edhe kufijtë e vendit të vet me Greqinë, duhet një dopio dozë, edhe deliri, për ta imagjinuar si mundësi për mbijetesë politike, e jo më

faktorizim ndërkombëtar. Të gjithë e mbajnë mend hysterinë e dhunshme denigruese që ky kryeministër, derdhte pas çdo denoncimi të Partisë Demokratike, se po përdorte kriminelët për të blerë vota me paratë e drogës. Në një farë mënyre, Zëri i Amerikës, një lloj si media shqiptare më herët, ka thënë të njëjtën gjë, fatmirësisht tashmë të dokumentuar me përgjimet e prokurorisë, pasi vetë Partia Demokratike bëri padi në 2016. Tre muaj nga dalja e përgjimeve, prokuroria nuk guxon ta marrë në pyetje kryebashkiakun e Durrësit, që u rrëfye në media mbi komunikimet me bandën e Avdyllajve. Më

flagrante se kaq, kapja e prokurorisë nuk mund të ishte e ky kryeministër qëndron se askush nuk do e lexojë qartë këtë fakt! Tashmë tironieri i Shqipërisë ka ngecur keq në llumin e zullumeve të tij, e kambanat po bien fort, si nga brenda, ashtu edhe nga jashtë vendit. E lexon mirë ai këtë, prandaj e tmerruan studentët, siç bënë në fillim të vitit kuksianët, siç po e tmerronjë edhe banorët e Unazës së re, me protestën e përnatshme. Edi Rama e lexon mirë se një gazetë si "The Independent", nuk boton rastësisht një shkrim investigativ me konkluzionin, se Shqipëria është një narko-shtet e Kolumbi e Europës,

pak muaj para Opinioni të BE mbi hapjen e negociatave. E padyshim që vula që iu vu, përmes investigimit të "Zërit të Amerikës", se pushteti i tij është krejt ilegjitim, ishte pika që i derdhi gotën e ëndrrës, se dyert që nuk po i hapen më në Europë, mund të hapeshin si dritare në SHBA. Me këtë bilanc të qartë të jashtëm, e me pozicionin zvarritës në atë të brendshëm, e bëri me studentët, me kuksianët, e nga pak edhe me banorët e Unazës së re, ky kryeministër që shmang edhe detyrimin kushtetues të firmosjes së vendimeve të errëta në këshillin e ministrave, duke ia deleguar zëvendëskryeministrit të radhës, e ka tejet të madh hallin e vet. Njeriu që prej gjashtë vitesh qeveris me një vullnet të vjedhur qytetar, kërkoi strehë tek përplasja me paraardhësin e vet Berisha, që ka po gjashtë vjet që nuk merr më vendime për shqiptarët. Një kryeministër i mjerë, e i degraduar nga zullumi që i është kthyer kundër, nuk i fshihet dot më zhgënjimit qytetar, të parët, atyre që i besuan votën e pritshmëritë. Zemërimi do derdhet së shpejti në shesh, për ta fshirë të keqen, që u ka bllokuar të ardhmen, e i detyron të marrin rrugën e kurbetit, për shkak të babëzisë së një kryeministri, që nuk ka të ngopur me paratë e asetet publike, e guxon të luajë edhe me të ardhmen e të rinjve, studentëve. Për të gjithë ata, për të gjithë qytetarët, ne do jemi në shesh në 16 Shkurt, për t'i thënë "boll më" këtij kryeministrit! Boll luajte me jetët e njerëzve, si me skicat e qeramikat, që i quan art! Thirrja që nuk arrita t'ua drejtoja kolegëve socialistë në Kuvend është: Një pjesë prej jush e kuptoni situatën. Mendojeni mirë nëse ia vlen të vetësakrifikoheni për hallin e një njeriu, e të injoroni qytetarët, edhe ata që ju kanë zgjedhur!

Opinion

i Ditës

Qeveria eksperimentale "Rama 3"

Ilir Kalemaj

Qeveri rioshe apo e përkohshme? Dilema që veritare të kryetarit të vendit, që mediton mbi fatin e mbramë të një ekonomie që nuk po lulëzon, të një përplasjeje shogërore që po bëhet gjithnjë dhe më e thepisur, të një qeverisjeje që po duket gjithnjë e më tepër e gremisur.

Kaleidoskopi i ministrave përfshin nga ata që kanë fjetur socialistë dhe janë gdhirë rilindas, ish-menaxherë të dështuar shërbimesh publike, deri të elif-matratë delirantë që marrin barrë përtej supeve të tyre të

brishta. Drejtorë që ashtu siç vijnë, ikin, më të pasur vetë, por me kokën në torbë dhe zero objektiva të realizuara dhe zero rezultate. Arrogantë, kokëbosh dhe të paafte përfaqësojnë kakistokracinë në shfaqjen e saj empirike më të qashtë.

Kjo lloj qeverisjeje që flet me shenja fasadiste dhe përdor retorikë populiste, flirton nga ana tjetër me politika mbështetëse ndaj oligarkëve, duke thelluar pa-barazinë në vend. Nga koncesionet e pakërkua, te partneritetet pirat-plaçkistëse; nga mungesa e një vizioni apo filozofie në arsim te rrumpallë-shëndetësia goja falas, kjo qeveri fle mbi dafinat e push-tet-shpërdorimit, e përqendruar

vetëm te teknikat më rishitare të spin-it manipulues në formën e një propagandë bajate. Ka pak apo aspak ndjeshmëri për qytetar-mavrinë, të cilit i ngelen pak zgjidhje. Ose të ikë nga sytë këmbët përtej detit, ose të protestojë, ose të ngrohë vezët në pritje të lajmeve përherë dhe më të tharta.

Ulet papunësia - kumton ministri në ikje, ndërkohë që mbi 300 mijë shqiptarë kanë çarë ferrën për përtej detit këto 5 vitet e fundit, shumica dërrmuese e të cilëve moshë e re, të talentuar, profesionistë, apo të sapodiplomuar me mundësi zero që iu ofron ky vend. Ky vend me barkderra të fryrë nga krimi dhe korrupsioni, ku sipas

renditjeve të fundit lamë pas Gambia dhe Zambia, me të panginjur që kanë stivosur miliona euro nëpër pararesa fiskale, të ruajtura kushtedi, ndoshta për ditët e qoftëlargut.

Kiameti nuk po vjen përnjëherë, por dalëngadalë, torturues dhe sfidues. Rrethuar me servilë dhe delirantë, në kullën e fildishtë, paria mendon pak për fatin e mbramë të theqafjes së vendit, të cilit prej gjashtë vjetësh nuk po i çelen as kapitujt e integritimit, duke ndenjur në vendnumëro, por si të shpëtojnë nga zullumet e kryera e të dalin pa lagur nga kënetat e politikës shqiptare.

Opinioni / i Ditës

Dhimbjet e shpirtit pas 20 vitesh emigrimi në SHBA

Aneta Mihali Xhiku

(vijon nga faqja 1)

... emocional, shëndetësor, familjar, profesional e shoqëror që duhet paguar për komoditetin ekonomik. Në 4-5 vjet, pjesa dërrmuese e emigrantëve shqiptarë blejnë shtëpi e makina, fëmijët mësojnë në shkollë të mira, ku ambicia e trashëguar nga prindërit, dalë nga një vend pa mundësi, i nxjerr në krye të klasës. Nëse ke genë profesionist në Shqipëri, synon të arrish të paktën në po atë nivel, por kjo kërkon përpjekje titane që shpejt kthehen në stres. Mundësitë të joshin të punosh më shumë, hyn në borxh që të blesh me të mirën, por e mira s'ka fund dhe njeriu e gjen veten në qerthull ku harron të ushqejë shpirtin e vet. Ardhur nga një vend ku si terapist shërben komshia, kushëriri, shoqja e punës apo e shkollës, emigranti shqiptar ndodhet në boshllëk - nuk gjen njeri të zbrazet, nuk gjen njeri ta mbushë. Dhimbjet e shpirtit kthehen në sëmundje, stresi paralizon muskujt, shkatërron trupin, fillojnë ilaçet që ndreqin një gjë e prishin dy, por ti vazhdon të vraposh, derisa ngec e jeta merr tatëpjetë...

Familjen e kisha aty me rrënjë e degë, por më mungonte shoqëria, gjuha e folur në rrugë, peizazhi. Nënvetëdija kish shtresëzuar nevojën për të parë malet, kodrat, lumin, por mungesa fatale qe deti. Ju ka ndodhur që një herë në ca vjet të shihni të njëjtën endërr makthi? Imja qe kjo: shkoja në Sarandë për dy javë, me qejfin që "do kënaqem në det"! Por, vinte dita e fundit dhe s'kisha mundur të kridhesha as edhe një herë në ujë. Nga ballkoni i motrës sime shihja një copëz blu, blu, blu... "Obobo, nesër do iki!". Zgjohesha e tronditur, me faqe të lagura - kisha qarë në gjumë.

Mendjen e kisha të mbledhur, ndoshta, ndoshta kthehesha në Shqipëri pas pensionit. Fëmijët kishin dalë në jetë, qe koha ta merrnim shtruar e të gëzonim të mirat e punës në atë vend të begatë, por njeriu kurrë nuk e di si i vijnë kartat në jetë. Vendimin për t'u kthyer e mori im shoq. Erdha këmbëzvarrë e me kokën pas, por u befasona nga energjia, mundësitë e shumta për biznes, ngrohtësia e njerëzve këtu. "Erdhe, mirë se erdhe, sa do rrish"? "Përgjithmonë!" Në fytyrë shfaqet mosbesimi, pastaj kënaqësia "kjo që rri, diçka di". Pasi kalon entuziazmi i parë, zënë e fusin hundët në punët e tua, nisin ankesat pafund... ti bie në tokë e zë të ndesh dëshpërimin e thellë të shoqërisë shqiptare. "Ka marrë fund, nuk ka më shpresë këtu", - është refreni që dëgjoj përditë. Në qytetin tim ka mundësi të jashtëzakonshme, por të papunët nuk i shohin - rrinë në kafene dhe përsërisin "ky vend nuk



bëhet!". Si pengon askush të pastrojnë rrugicën para shtëpisë, të mbjellin lule e pemë midis pallateve, të lyejnë murin a shkallët, të punojnë apartamentet bosh të komshinive që kanë ikur, të lidhen me fshatarët për të sjellë prodhimet e tyre në qytet, të organizojnë një kor apo një ekskursion me fëmijët e mëhallës, të ndihmojnë dikë në hall, por jo - janë tepër të zënë me telenovelat, fejsbukun, filxhanin e kafesë nën shatëllungat e duhanit... Në Sarandë vijmë të huaj me trumba, shesin shtëpitë në vendet e tyre dhe bum! Blejnë apartamente e hapin biznese - kurse ne e kemi mendjen të ikim, të ikim një orë e më parë! Në arrati shkërmoqim familjen, lëmë pas prindër që plaken të vetmuar, fëmijë që nuk ndjejnë përkëdheljen e gjyshërve, ëndrra profesionale të paarrira, e pëlhura e shpirtit dobësohet fill pas filli...

Nga një studim mbi faktorët që përcaktojnë jetëgjatësinë e njeriut, del se njëshi është komuniteti, jeta e rrugës; 2. familja dhe miqtë e ngushtë; 7. duhani. Emigranti ka 7 herë më shumë gjasa të vdesë nga vetmia se sa nga pirja e duhanit. Keni dëgjuar donjë fushatë kundër emigracionit? Shihni film-

in dokumentar "Babushkat e Chernobilit" (<https://thebabushkasofchernobyl.com/>) - pas katastrofës nukleare në Chernobyl, banorët u shpërngulën për fare në Moskë. Zona u rrethua me tela, por disa të moshuar u kthyen fshehurazi në shtëpitë e tyre, ku zunë të jetonin me prodhimet e tokës që mbartte vdekjen. Doli fjala e u nis një ekip (me kokë në trastë) që të vëzhgoje se si ishte e mundur jeta në një vend të tillë. Studimi konkludoi se vdekshmëria e të moshuarve të shpërngulur në Moskë ishte 10 herë më e madhe se vdekshmëria e babushkave të kthyer në zonën e vdekjes. Punët e shpirtit...

Pas 20 muajsh këtu, jam e vetëdijshme për plagët e thella të shoqërisë shqiptare, e kuptoj sa e vështirë është të rrisësh fëmijë e të ngresh profesion në një vend ku qeveria punon vetëm për xhepin e vet, duke shkatërruar mundësitë për njeriut që ka nevojë e qejf të punojë. Por bota ka ndryshuar: në perëndim emigrantet nuk i pret më njeri krahëhapur, vetë perëndimoret nuk po gjejnë rehat (miqtë e mi të rinj Shawn Simons and Kyle Drevlo shitën gjithçka kishin në Kaliforni dhe po ndërtojnë një fer-

më në Finiç; të shtunën pres Lucy Ivanoff që mbërrin në port vetëm me dy valixhe pasi shiti apartamentin në Washington D.C.; Natasha Wolf po i lan duart nga shtëpia në Long Island, ndërkaq që në mars e pret foleja e re në mëhallën time.) Kemi fatin e madh të jetojmë në një vend me klimë, pasuri, ushqim, histori, inteligjencë emocionale etj., që i bën të huajt të mos mendohen dy herë e të ngulen këtu. Shqipëria ka ecur përpara në disa drejtime, mbrapsht në disa të tjera, por teknologjia dhe media sociale na kanë hequr çdo justifikim për të humbur kohë. Nëse bëjmë më të mirën që mundemi vetë, gjejmë e vlerësojmë më të zotët mes nesh dhe i nxjerrim në krye, mbështesim kurajën qytetare për t'u kërkuar llogari atyre që na udhëheqim, ndjej që shpresat janë reale. Ditët i harxhoj me njerëz që thonë "këtu mund të bëjmë diçka" dhe si dikush që i ka jetuar të dy realitetet, u them: "Aty isha e kënaqur; këtu jam e lumtur".

p.s. (Njoh shumë emigrantë që nuk ndajnë të njëjtin mendim me mua dhe janë të lumtur në emigrim, por kjo është shkruar për ata që ndjehen si unë).

HOROSKOPI

DASHI

Tregohuni të vëmendshëm ndaj çdo situatë. Ka gjasa të përballeni me telashe në biznes ose karrierë. Në pjesën më të madhe të rasteve do të keni mbështetjen absolute të partnerit/partneres suaj. Mund të përjetoni një eksperiencë të 'çmendur' këtë të premte.

DEMI

Disa Dema do ta kenë të vështirë të kuptojnë të afërmit e tyre. Njëri prej tyre mund të keqkuptojë idetë e tua dhe do t'ju kritikojë. Përpuni të ruani qetësinë, edhe nëse ju ofendojnë. Fati do t'u buzëqeshë Demave beqarë.

BINJAKET

Kjo e premte do të jetë e mbushur plot aventura. Rezultatet në punë do të jenë pozitive. Ka gjasa të gjeni zgjidhjen e një çështje që ju ka munduar prej kohësh. Do të kaloni një mbrëmje romantike, ku do të befasoheni nga një surprizë.

GAFORJA

Sot keni shanse të arrini qëllimet që dëshironi, por do të përballeni me vështirësi. Në aspektin profesional do të kryeni disa negociata të rëndësishme. Ndërsa sa i përket aspektit personal, disa çështje do të mbeten nën hije.

LUANI

Luanët do të arrijnë disa fitore sot, mbi të gjitha në aspektin profesional. Ka gjasa që t'ju rritet rroga, ose të vlerësoheni me një çmim. Mendoni se si mund të kaloni një mbrëmje argëtuese, e cila do t'ju sillte shumë emocione.

VIRGJERESHA

Do të shënonin sukses në aspektin personal. Do të jetë dita me fat për ata që kërkojnë të nisin një lidhje të re romantike. Personat e kësaj shenje që janë familjarë, duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje partnerit/partneres.

PESHORJA

Disa Peshore do të jenë në qendër të vëmendjes. Madje mund t'ju vijë një dhuratë shumë e këndshme. Do të kaloni disa momente romantike, që do t'ju bëjnë të ndiheni mjaft mirë. Edhe në aspektin financiar, fati do t'ju buzëqeshë.

AKREPI

Do të ishte mirë që të zgjeroni kontaktet e afërta. Mos lejoni të tjerët të ndërhyjnë në marrëdhëniet tuaj të dashurisë. Akrepat beqarë ka gjasa të flirtojnë me dikë. Mos ndërmerrni detyra, të cilat nuk do të mund t'i realizoni.

SHIGJETARI

Shigjetarët do të kalojnë një ditë të mirë. Besojini intuitës dhe duhet të keni më shumë besim në vetvete. Do të jetë dita juaj me fat si në aspektin personal, ashtu edhe profesional. Bëni gjithçka mundeni për të evituar stresin.

BRICJAPI

Do të ndiheni shumë mirë emocionalisht. Do të zhvillonit një bisedë të rëndësishme me partnerin/partneren tuaj. Suprizat në dashuri nuk përjashtohen. Në mbrëmje do të argëtoheni pafund.

UJORI

Kjo ditë do të kalojë me një rezultat pozitiv. Rekomandohet të gjeni mbështetës si në aspektin personal ashtu edhe profesional. Duke vepruar si skuadër, ka gjasa të arrini qëllimet tuaja. Bëni kujdes me sjelljen ndaj më të moshuarve dhe më të vegjëlve.

PESHQIT

E premija do të jetë një ditë e lodhshme për disa persona të kësaj shenje. Do të përmblyllni shumë detyra në punë. Në dashuri do të ndiheni mjaft mirë. Në aspektin financiar do të keni një deficit.

ZHVILLIMET TE PARTIZANI

Partizani duket se i ka programuar goditjet e tij të merkatos në orët e fundit. Pas zyrtarizoi në fillim të muajit janar Hysenin, Jusufin, Dukën dhe Rexhepin, drejtuesit e kuq kishin lënë gjithçka tjetër për në dy ditët e fundit të merkatos. Kështu pas zyrtarizimit të mbrojtësit të djathtë të Kamzës, Hektor Idrizajt, ditën e djeshme, klubi i kuq ka njoftuar pak




Vjen finlandezi Mombilo, largohet Jusufi

çaste më parë arrijten e marrëveshjes me 25-vjeçarin Kevin Mombilo. Mombilo, me origjinë keniane, është aktivizuar me moshat e përfaqësueses së Finlandës, ndërsa në kampionat e vendit nordik, ka një eksperiencë të gjatë me ekipet kryesore të tij, teksa në klubin e kuq erdhi nëpërmjet

menaxherët Denis Cani. "Klubi njofton arrijten e marrëveshjes me Kevin Mombilo. Mesfushori i djathtë ka nënshkruar sot kontratën me drejtuesit, e cila do të jetë e vlefshme deri në 2020. 25 vjeçari me origjinë nga Kongo dhe pasaportë finlandeze mbërrin tek të kuqtë pas eksperiencave

pozitive në kampionatin finlandez ku është aktivizuar te ekipet Inter Turku, PK-35 Vanta, Honka dhe së fundmi PS Kemi. Gjithashtu, Mombilo ka qenë edhe kontingjent i ekipeve kombëtare të moshave të Finlandës", shkruan klubi i kuq në njoftimin e tij, që pak më vonë do të njoftonte dhe prishjen e kontratës me Patjon Jusufin, një nga afrimet e fillimit të janarit.

MBROJTËSI



Alba ngrin Barcelonën: Nuk kam rinovuar

Zhordi Alba ngrin Barçën: S'është e vërtetë që kam rinovuar Anësori i majtë i Barcelonës, Zhordi Alba, u përfol gjatë ditës së djeshme se kishte arritur akordin për të shtyrë qëndrimin e tij në "Camp Nou" dhe për një sezon tjetër pas vitit 2020. Por vetë mbrojtësi i Kombëtares së Spanjës, ka hedhur poshtë të gjithë zërat që e shikonin atë të "zgjaste" martesën e tij në Barcelonë. "Nuk është e vërtetë që kam gjetur akordin me klubin, situata është gjithmonë e njëjta. Nuk kam rinovuar kontratën me Barcelonën", është shprehur Alba. Alba është prodhim i kanterës katalanase dhe pas pesë sezoneve aktivizim të Valencia, u rikthye në Barcelonë në vitin 2012. Që atëherë, Zhordi Alba ka luajtur 275 takime dhe ka shënuar 14 gola.



Jeton Selimi

Te Kukësi kanë bërë dhe një goditje last-minute, teksa kanë nënshkruar me portierin e SPAL-it, Gomis

Rama: Te Kukësi për të treguar vlerat dhe për titullin kampion

Mesfushori ka firmosur për 9 mijë euro në muaj

Valdet Rama firmosi ditën e djeshme me skuadrën e Kukësit, duke nisur një aventurë të re në futbollin shqiptar. Ish-mesfushori i Kombëtares, do të jetë pjesë e verilindorëve për 6 muaj me të drejtë rinovimi edhe për 1 vit tjetër. Rama do të përfitojë 9 mijë euro në muaj pa përfshirë bonuset. Në prononcimin e tij për mediat, 31-vjeçari u shpreh: "Për afro 5 muaj u stërvita rregullisht me Shalken. Normalisht pas aventurës në Kinë, dëshiroja të ktheja në Gjermani. Kam qenë në bisedime me disa ekipe, por nuk arritëm të gjenin gjuhën e përbashkët. Në kampionatin shqiptar e ndiej veten si në shtëpi. Kam luajtur për Kombëtaren dhe nuk kam pasur asnjë frikë të vij këtu. Arrita marrëveshjen dhe e ndjeva veten mirë. Vendosa me familjen që të nënshkruaj kontratën. Jam i lumtur që u realizua. Falënderoj Kukësin që më dha mundësinë të vija këtu dhe do bëj maksimumin për këtë skuadër. Kukësi ka qenë gjithmonë lart në klasifikim. Shpresoj që të arrijmë qëllimin që ka



gatshëm të jam maksimumin për këtë skuadër. Kukësi ka qenë gjithmonë lart në klasifikim. Shpresoj që të arrijmë qëllimin që ka

klubi dhe të geshim në fund të sezonit. Rikthimi në Kombëtare? Me trajnerin Panuçi nuk kam patur asnjë kontakt. Kam ardhur të

tregoj veten, të kem sukses. Për të tjerat nuk e kam menduar, çfarë do të vijë, le të vijë. Nuk e kam mendjen për momentin te Kombëtarja", u

shpreh Valdet Rama. **VJEN GOMIS** Mahnit Kukësi në merkato! Merr portier nga Serbia A Safet Gjici e ka mbushur Kukësin e tij me vje. Në dispozicion të Armando Cungut nga java e ardhshme veç Eduard Rrocës, Vasil Shkurtajt e Faton Xhemailit, do të jenë në dispozicion dhe Olsi Teqja e Valdet Rama, të dy të zyrtarizuar në ditën e sotme. Por kur kishin mbetur dhe pak orë deri në mbylljen zyrtare të merkatos dimërore, Gjici ka bërë dhe një sforc tjetër. Me verilindorët do të bashkohet 21-vjeçari Moris Gomis, që është pjesë e skuadrës së SPAL-it, e cila militon në Serinë A të Italisë. Senegalezi Gomis vjen në formën e huazimit dhe do të jetë pjesë e Kukësit deri në përfundim të këtij edicioni futbollistik.

TRAJNERI I TIRANËS

Viti 2019 duket se ka nisi në mënyrën më të mirë për Tiranën. Dy fitore mes Kupës dhe Superligës kanë kthyer bardheblutë në rrugën e duhur, ndërsa i kanë rritur ndjeshëm kuotat e tyre në misionin për të shpëtuar sezonin. Por trajneri Ardi Mema nuk pushtohet nga euforia dhe mban skuadrën e tij me këmbë në tokë. Sipas tij asgjë nuk do të kishte vlerë, nëse mungon vazhdimësia, duke nisur nga sida e së premtes kundër Teutës. "Na duhet vazhdimësi dhe t'i marrim ndeshjet hap pas hapi. Duhet të rritemi si ekip, pasi është më rëndësia të fitojmë dhe të kemi një objektivi tjetër:

Mema thumbon Kukësin: Nuk marr lojtarë që s'luajnë prej 1 viti



që është ngjitja sipër, apo largimi nga zona e ftohtë", ka thënë trajneri i Tiranës. Në prag të ndeshjes kundër

Teutës, Mema duhet t'i bëjë llogaritë me mungesën të shumta për shkak të dëmtimeve dhe pezullimeve. "Më shqetësojnë të gjithë lojtarët janë në terapi e sipër. Nga stafi më kanë thënë se do jenë gati, jo të gjithë. Kërçiku nuk do të jetë gati. Më shqetëson fakti që kur ekipi nis të luan mirë, nëse lojtar nuk mund të aktivizohet, dhe kjo pengon rritjen e ekipit dhe të individëve", ka vijuar tekniku bardheblu. Dalja në konferencën për mediat në ditën e fundit të merkatos së dimrit e ka bërë të paevitueshëm ko-


mentin e Memës për këtë temë. Trajneri flet për trativat me sulmuesin e Partizanit, Mensah dhe nuk haron të thumbojë rivalët. "Lojtarët që vijnë në ekip duhet të bëjnë diferencën. S'kemi pasur këtë fat që të na vijë dikush. Kam dëgjuar një ekip ka marrë një lojtar që nuk luan prej 1 viti. Unë nuk mund ta marr, nuk më shkon. Secili ka objektivat e tij, katërshja e parë lufton për titull. Një lojtar që ka qenë i Partizanit, nuk është se kemi negociuar klub me klub, por vetë lojtari ka shprehur dëshirën për t'u larguar. Unë e pëlqeva dhe mendova të negocioj. Them se është e mbyllur", -ka bërë të ditur Mema.

ISH-TRAJNERI I JUVENTUSIT

Konte në selinë e Interit, tifozët ëndërrojnë, Spaletti dridhet

Ish-trajneri i Juventusit, kampioni i trefishtë në Serinë A, ka qenë ditën e sotme në selinë e Interit. Lajmi është përhapur me shpejtësinë e dritës dhe ka sjellë shumë reagime në opinionin zikaltër dhe më gjerë. Antonio Conte është një nga më të pëlqyerit e Marotës, që e solli në Torino trajnerin i cili u shndërrua arkitekti i tre titujve të parë kampion në vitet e fundit dhe që i hapën rrugën dominimit absolut të bardhezinjve në Apenine. Rezultatet e Interit nën drejtimin e Luçano Spaletit kanë qenë zhgënjyese. Eliminimi i parakohshëm nga Liga e Kampioneve dhe dalja e shpejtë nga lufta për titullin me zikalteerit që janë 19 pikë larg Juventusit kryesues, kanë tronditur besimin e drejtuesve të Spaletit. Antonio Conte në dalje të selisë zikalteerë në Milano nuk u është përgjigjur interesit të gazetarëve, duke thënë vetëm një "no comment", por ndërkohë fantazia e tifozëve të Interit ka arritur kulmin.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Një pije freskuese.
- Graf ish tenisiste.
- Dada, ish-diktator i Ugandës.
- Është pasuri e investuar.
- Mund të jenë fetare.
- Një pjesë e relacionit.
- Fillojnë ambalazhimin.
- Një vegël.
- Qe harkëtar i famshëm i akejve.
- Fillojnë hetimin.
- Një atentator vëtvërasës.
- Kështu janë takimet zyrtare.
- Është anije me dy skafe.
- Fundi i Turandot.
- Iniciale e Reitman regjisor.
- Farrell regjisor.
- Schneider që qe aktore.
- Mund të jetë e lirë për hartim.
- Emri i Pasternak.

- Ekberg e La dolce vita.
- Dikur quhej Mediolanum.
- Ruajnë pa ujë.
- Një mund të jetë kalendarik.
- Një është meskini, shpirtingushti.
- Një hidrokarbur.
- Mund të jetë franceskan.

VERTIKAL

- Jessica Parker aktore.
- Zola shkrimtar.
- Janë dritë të tilla me parsec.
- Mund të jenë gjaku.
- United Kingdom.
- Është njeri me principe.
- Një polimer për kirurgji estetike.
- Kufizojnë takimet.
- Diftong teatral.
- Fillojnë fluturimin.
- Makina Uno.
- Është shpend lagune.
- Është operator që bën zoom.
- Është i pashpirt.
- Parashtesë për një.
- Pak enigmatike
- Një pjesë e Toskërisë.
- Agustini ish-bomber.
- Kufizojnë njën princip.
- Miku i Batman.
- Tapeti për judo.
- Janë stadet në videogame.
- Bëhet një kundër vendimit.
- Janë me blerim mbuluar në një film
- Është shtet aziatik.
- Papavrami violinist
- Fadili komik
- Përsëhendetja e Jul Qezarit.
- Mbyllin fushatat.
- Me të bëjnë një ketër.
- Mbyllin një takimin.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- Një pemë gjigante.
- Janë për të kërcyer.
- Është shkollë e Aristotelit
- Një thirrje me emra.
- Gjysmë rivale.
- Një pjesë e narkotikëve.
- Një tis... megjulje
- E famshme ajo e Keopsit
- Mbyllin një sirtar
- Është ngjyrë e... fytyrës.
- Fillojnë lejen.
- Janë aktorë kryesorë.
- Janë kompozime të kënduara.
- Hudson aktore.
- Satelit i Uranit.
- Fillojnë tatëpjepën.
- Mbetur në fund.
- Sapo fillojnë.
- Kastile janë në fund.
- Kufij takimi.


- Ekstremet e tokës.
- Iniciale e Einstein.
- Qendër mësimi.
- Kështu thirrëj Marco Pantani.
- Pak irredentizëm
- Fundi i një filmi.
- Populllojë qytetin.
- Janë gojë vulkanesh
- Është edhe ai Persik.

VERTIKAL


- Mund të jetë sekrete në derë.
- Makina Agila.
- Ami i Maupassant.
- Mbyllin një sirtar.
- Rrëzohen me strike
- Luciano tenor i paharruar.
- Mbyllin këndet
- Është borxh.
- Mbyllin portat.
- Hagen rockstar.
- Një pjesë e akademisë.
- Bien me ballë.
- Një barkë lëkurëkuqsh.
- Atje ku shkron progresisti
- Pallati i Dalai Lamas në Lhasa
- Një pjesë e minoritetit.
- Është fluturues në ufo.
- Do të bëhen mace të tilla.
- Fletë pa kufij.
- I ka tek rendi.
- Kreshniku i volejbolit.
- Një det që është liqen në fakt.
- As unë, as ai.
- Në mes të King edhe Cole të muzikës.
- Një parashtesë zmadhuese.
- Është lon papagalli.
- Titulli i Sean Connery.
- Fillojnë panikun.
- Gjysma e rojave.
- Fitim pa kufij.
- Mbyllin një sherr.
- Fillojnë një metodë.
- Kufizojnë botimet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

7	2			6	1		
6			1				4
8		9		3			5
			4				
			8	5	2		7
5							
					5	3	
2		6	3		4		
			2			7	9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	1	7	5	9	2	6	8	4
9	5	6	3	4	8	7	1	2
8	2	4	6	7	1	9	3	5
7	9	3	4	5	6	8	2	1
5	6	1	2	8	7	4	9	3
2	4	8	9	1	3	5	6	7
4	3	2	7	6	9	1	5	8
1	7	9	8	3	5	2	4	6
6	8	5	1	2	4	3	7	9

Argëtim filozofik

- Nancy Astor: "Zotëri, sikur ju të ishit bashkëshorti im, unë do t'ju jepja helm". Churchill: "Sikur të isha bashkëshorti juaj do ta pija".
 - Gënjeshtra ka bërë gjysmën e rrugës rreth e qark botës, kur e vërteta sapo është nisur.
 - Ndonjëherë ju do të pengoheni tek e vërteta, por pjesa më e madhe prej nesh ngrihen dhe vazhdojnë përpara sikur s'ka ndodhur asgjë.
 - Nëse jeni nisur drejt ferrit, vazhdoni.
 - Është diçka e mirë për një njeri të paarsimuar të lexojë libra me citime. Citimet, kur gahenden në kujtesë, të japin mendime të mira. Ato gjithashtu të nxisin të lexosh autorët dhe të kërkosh të tjera.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	I	11	16		7	5	15	8			3	8	I	R	S	E	R	B	B	I	D	E	T		
1	Z	8	13	8	6		6	8			4	3	8	12	B	E	L	A	M	I	S		R	N	I	
2	I	7		10	8	9	2			15	2	11	3	2	I	I	H	I	P	O	T	E	Z	A	T	
9	L		14	8	12	17	12	3	7	9	9	2			Z	P	A	R	A	K	A	L	I	M	E	T
4	8	6	5	2	15	8			7	15		10	7		A	N	E	T	A	R	E	T	L	A	A	
7	5	7		12	7	15		6	11	6	8	15			A	T	E	E	M	T	A	I	R	O		
5	6	4	7		5	2	18	2			11	19	7		K	E	N	E	T	E	I	T	A	K	A	
5	4	11	6	19				9	8		4	8	6		T	K	D		T	E	A	N	T	A		
9	11	15		1	7	5	8			19	8	1	8		U	N	I	O	N	M	R		T	K		
7	6	2	14		14	7		16	11	15	7				A	I	M	I	S	I	O	N	A	R	E	T
5	7	8	4		8	9	3	8	15	7	5				L	K	S		T	U	R	I	S	T	E	T

PËRÇJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	R	I	E	K	O	H	A	R	K	
F	I	L	L	I	D	O	M	A	T	E	R
R	A	F	A	T	I	M	I	M	R	S	
A	A	P	E	R	I	P	A	T	I	M	
N	H	P	A	K	E	T	I	M	E	T	
Z	E	M	E	R	A	K	E	T	S	T	
F	I	D	A	N	E	T	V	E	T	E	
S	E	N	A	T	I	I	B	E	R	I	K
S	E	N	E	K	A	L	L	A	P	A	T
T	R	E	E	L	S	A	T	T			
L	I	V	E	T	A	K	A	A	E	D	
N	A	A	R	N	J	E	A	P	E	L	
D	A	L	A	I	V	A	K	A	N	T	E
E	D	E	N	P	N	A	D	I	A	M	
R	R	E	M	I	R	E	T	T	R	I	O
T	E	S	T	R	T	A	T	E	O	L	
S	M	N	O	T	A	R	E	T	N	L	
K	A	A	M	E	R	I	K	A	N	E	
E	H	P	A	M	A	D	S	H			
K	O	L	O	N	A	O	T	E	C	E	
T	U	N	E	L	E	T	P	E	R	O	S
O	R	A	I	T	K	E	S	T	I	A	
K	A	N	A	I	S	A	R	A	H	E	P
E	L	J	A	C	I	T	A	T	E	T	I

Argëtim filozofik

Thënie të mençura

- Keni armiq? Mirë. Kjo do të thotë se keni luftuar për diçka, në një fazë të jetës suaj.
- Nëse keni dhjetë mijë rregulla, ju shkatërroni gjithë respektin për ligjin.
- Gjithmonë mund t'i besoni amerikanëve për të bërë gjënë e duhur, pasi të kenë provuar gjithçka tjetër.
- Historia do të jetë e sjellsme me mua, pasi...
- kam ndër mend ta shkruaj.
- Sa më larg të shikoni prapa, aq më larg përpara ka gjasa që të shihni.
- Jam gati të takoj Krijuesin tim. A është i përgatitur Krijuesi im për provën e rëndë të takimit me mua, kjo është një çështje tjetër.

